



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDITMAR PËR AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË
NË “ALBCONTROL SHA”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËRPUTHSHMËRIE
NË
“ALBCONTROL SHA”

TIRANË, Korrik 2024

PËRMBAJTJE		
Nr.		
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	6
II.	HYRJA	9
1	Objektivat dhe Qëllimi i auditimit	9
2	Identifikimi çështjes	9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9
5	Kriteret e vlerësimit	10
6	Standardet e auditimit	10
7	Metodat e auditimit	10
8	Dokumentimi i auditimit	10
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1	1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	11
2	2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	11
2.1	Pika 1: <i>Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm</i>	11
2.2	Pika 2: <i>Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese të Albcontrol sh.a, bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimi i tyre</i>	15
2.3	Pika 3: <i>Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiar në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet eprorë, si dhe realizimi i tij</i>	27
2.4	Pika 4: <i>Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat dhe shpërblimet e punonjësve. Zbatimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin. Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës dhe efektet financiare të rrjedhura prej tyre</i>	41
2.5	Pika 5: <i>Auditimi i veprimtarisë financiare të institucionit. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni nëpërmjet arkës dhe bankës si dhe për blerjet me vlerë të vogël. Saktësimi dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë. Inventarizimi i pasurisë së institucionit</i>	43
2.6	Pika 6: <i>Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e proceduarve të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve</i>	48
2.7	Pika 7: <i>Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit, i Menaxhimit të riskut, i Aktivitetit të Kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi</i>	86
2.8	Pika 8: <i>Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm të Njësisë</i>	88
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	90
1	Masa Organizative	91
2	Masa shpërblim dëmi	99
3	Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficence dhe Efektivitet të Fondeve Publike	100
V.	ANEKSE	103

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit me nr. 1045/1 Prot., datë 29.12.2023, i ndryshuar me nr. 1045/2 Prot., datë 05.03.2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u zhvillua auditimi mbi përputhshmërinë në “Albcontrol sh.a”.

I.2. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve

- Gjatë vitit 2022, ashtu si edhe gjatë vitit 2021, shoqëria nuk ka arkëtuar asnjë të ardhur nga shërbimi en route dhe terminal charge si pasojë e një vendimi të gjykatës së shkallës së parë të Brukselit, për ngrirjen e llogarive të Albcontrol sh.a pranë organizatës Eurocontrol. Për përballimin e situatës së krijuar mbi mos arkëtimin e të ardhurave, Albcontrol sh.a ka lidhur 3 marrëveshje për hua financiare si më poshtë:
 - 1-Vlera prej 5 milion Euro, nga Autoriteti Portual i Durrësit, nëpërmjet vendimit nr.5, datë 23.02.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 686 Prot., datë 03.03.2022.
 - 2-Vlera prej 936,000,000 lekë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet vendimit nr.16 datë 17.08.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 2178 Prot., datë 24.08.2022.
 - 3-Vlera prej 2,000,000,000 lekë, nga Autoriteti i Aviacionit Civil, nëpërmjet vendimit nr. 24, datë 22.12.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 3078 Prot., datë 27.12.2022.
 - 4-Vlera prej 2,000,000,000 lekë, nga Korporata Shqiptare e Investimeve, nëpërmjet vendimit nr. 24, datë 21.11.2023 dhe me Kontratë Huaje nr. 2570 Prot., datë 24.11.2023.
 - 5- Vlera prej 3,000,000,000 lekë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Kontratë Huaje nr. 2857 Prot., datë 27.12.2023.Në kontratat e mësipërme janë përcaktuar dhe detyrimet e huamarrësit dhe huadhënësve si dhe normat përkatëse të interesit të huave.

Grupi i auditimit konstatoi që vendimi i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës i kalon kompetencat e saj. Kjo për shkak se shoqëria aksionare përcakton tarifat e saj ose të ardhurat në bazë të kostos së institucionit dhe në këto momente mbetet e paqartë nëse llogaria që vijon të mbetet e bllokuar ose në rastin më të keq që llogaria në fjalë të mos arkëtohet, si do vijohet me shlyerjen e huave dhe si do regjistrohen veprimet kontabël duke e sjellë që shoqëria të vijojë operimin me humbje dhe drejt falimentimit të saj. Sa më sipër u la rekomandimi që Këshilli Mbikëqyrës, duke u nisur nga natyra dhe lloji i institucionit që përfaqësojnë, institucion i cili nuk është fitimprurës, ku të ardhurat përcaktohen në bazë të kostove vjetore (TR=TC), të ndërpresë praktikën e marrjes së huave e cila shoqërohet me kosto shtesë (interesi), si dhe burimin e financimit ta kërkojnë nëpërmjet aksionarit duke qenë se dhe bllokimi i llogarive ka ndodhur për llogari të shtetit shqiptar.
- Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Shpenzime mirëmbajtje sistem finance, prokurimi, buxheti dhe e-ticket” për vitin 2022, për përmbushjen e qëllimit të procedurës së prokurimit, nevojitet dhe autorizimi nga ana e Oracle për O.E. pjesëmarrës në garë, i cili nga analizimi i dokumentacionit të sjellë, rezultojnë që ka autorizim të vlefshëm deri më datë 15 Janar 2024, si dhe nga hulumtimet e grupit të auditimit në faqen zyrtare të Oracle, nuk rezultojnë që O.E. D. L. sh.p.k. të ketë autorizim aktiv. Kjo situatë sjell që shërbimi të mbulohet pa një licenca aktive nga O.E. D. L. sh.p.k.

Në lidhje me përcaktimin e fondit limit dhe ofertave të dhëna, mungojnë detaje thelbësore mbi përcaktimin e saktë të vlerës së shërbimit, si numri i licencave (userave), pasi dhe në faqe zyrtare

të oracle, tarifat e shërbimit përcaktohen nga numri i kërkuar i licencave (userave) që do të përdorin shërbimin. Sa më sipër në mospërputhje Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Sa më sipër u la rekomandimi që personat përgjegjës, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit, të përfshijnë detaje të cilat janë të rëndësishme dhe themelore për përcaktimin e drejtë të kostos dhe vlerës së procedurës së prokurimit. Gjithashtu titullari i institucionit të ngrëjë një grup pune për verifikimin e afateve të licencave të OE fitues i cili mbulon këtë shërbim, dhe në rast të mos ekzistencës së tyre të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e situatës.

- Gjatë auditimit të procedurës me objekt: “Trajnimi për ATCO AFIS Kukës” për vitin 2022, për përlllogaritjen e fondit limit është bërë studimi i tregut duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

1.“A.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 25.500.000 lekë pa TVSH.

2.“R.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 26.400.000 lekë pa TVSH.

3.“E.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 28.100.000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me studimin e tregut u konstatua në lidhje me ofertat e marra në treg, dy nga tre OE që është marrë oferta nuk e kanë për objekt fushën e trajnimit të personelit, duke e mos kryer një analizë të saktë mbi përcaktimin e fondit limit. Sa më sipër në mospërputhje me Nenin 76 shkronja *b* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik" , neni 2 i ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 dhe Nenin 2 shkronja *b* të ligjit nr. 162 , datë 23.12.2020. Sa më sipër u la rekomandimi që personat përgjegjës gjatë përlllogaritjes së fondit limit në të ardhmen, në lidhje me procedurat e prokurimit që kanë të bëjnë me trajnimet për punonjësit e Albcontrol SHA, në rastin kur përdoret studimi i tregut për përcaktimin e fondit limit, të përzgjidhen OE të cilët e kanë për objekt fushën e trajnimit të personelit sipas objektit të caktuar nga Albcontrol SHA

- Gjatë auditimit të NjAB grupi i auditimit ka konstatuar se: NjAB për vitin 2021 ka funksionuar më 2 punonjës deri në 31.10.2021. Nga 31 Tetor 2021 deri në fund të vitit NjAB ka funksionuar vetëm me një auditues.

Për vitin 2022 NjAB ka funksionuar vetëm me znj. E.P si Shef, Sektori i Auditit të Brendshëm deri në datë 30.09.2022 kur znj. E.P është larguar nga ky funksion. Në periudhën nga data 30.09.2022-21.11.2022 nuk ka pasur asnjë punonjës në strukturën e NjAB. Në 21 Nëntor 2022 është punësuar z. E.B me detyrë si Specialist i sektorit të auditimit të brendshëm. z. E.B. nuk ka qenë i pajisur me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik” të lëshuar nga Ministria e Financës.

NjAB për vitin 2023 ka funksionuar vetëm me z. E.B me detyrë si Specialist i sektorit të auditimit të brendshëm deri në datën 1 Nëntor 2023. E njëjta situatë paraqitet dhe për përrudhën nga data 1 Nëntor e në vazhdim ku në strukturën e NjAB nuk ka asnjë punonjës dhe nuk është funksionale. Sa më sipër në mospërputhje me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Miratimin e kriterëve të krijimit të njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, konkretisht pika 3. Sa më sipër u la rekomandimi që titullari i institucionit, Këshilli Drejtues të marrë masat përkatëse për kryerjen e ndryshimeve në Organigramën e shoqërisë për NjAB, duke vendosur minimum 3 punonjës përfshirë dhe drejtuesin (përgjegjës in e sektorit). Të bëjë ndryshimet e duhura në Rregulloren e Brendshme dhe në Kartën e Auditit të shoqërisë Albcontrol si dhe të marrë masat e menjëhershme për plotësimin e NjAB dhe vendosjen në funksionim.

- Nga auditimi u konstatua se shoqëria Albcontrol sh.a në vitin 2022 ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt Shërbim i pastrimit të ambienteve të Albcontrol sh.a”, me vlerë të kontratës 79,170,408 lekë, me afat 36 muaj. Edhe pse shoqëria ka në strukturën e vetë organizative

Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse dhe të Sigurisë, konstatohet se përpara zhvillimit të kësaj procedure nga AK nuk janë bërë analizë e detajuar kosto-përfitim, nëse duke krijuar struktura të reja me punonjës të këtij shërbimi, ky shërbim mund të kryhej me kosto më të ulëta nga kostot e llogaritura në procedurën me prokurim publik. Sa më sipër, në mospërputhje me Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” sa më sipër u la rekomandimi që titullari i institucionit, Këshilli Mbikëqyrës dhe departamentet përkatëse gjatë hartimit të planifikimeve buxhetore të shoqërisë, të marrin në konsideratë pozicionin financiar që ndodhet Albcontrol SHA, si dhe për çdo planifikim buxhetor të natyrës së shërbimeve të kryej një analizë kosto përfitim për mundësinë e kryerjes së shërbimit duke u mbështetur dhe në burimet e veta njerëzore.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA”, me fond limit 84,175,068 lekë pa TVSH me afat 36 muaj, u konstatua se në specifikimet teknike dhe preventiv, është përfshirë edhe zëri “Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim i mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim i mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)”.

Natyra e këtij shpenzimi lidhet me problematikën që ka krijuar në vend situata e COVID 19, situatë e cila nuk ekziston më për periudhën në të cilën është lidhur dhe zbatuar kontrata për të kryer shërbimet e mësipërme. Planifikimi i kohëzgjatjes së shërbimit që do të përfitohej nga zhvillimi i kësaj procedure, nga AK është bërë për 3 vite, një planifikim i pa arsyetuar, pasi data e përfundimit të kontratës është 22.04.2025. Autoriteti Kontraktor Albcontrol SHA, nuk duhet të kishte përfshirë në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA”, edhe shpenzimit të cilat lidhen me situatën COVID 19. Shpenzimet për situatën e pandemisë, duhet të ishin kryer me procedurë më vete, pasi kohëzgjatja e nevojës për pastrimin e ambienteve, nuk lidhet me kohëzgjatjen e nevojës për shpenzime në funksion të pandemisë. e cila është një nevojë që diktohet nga ecuria e situatës dhe kërkon zhvillim procedurash në afate të shkurtra kohore.

Për sa më sipër vlera e shpenzuar për shkak të situatës së pandemisë COVID 19, prej 1,951,680 lekë, nga lidhja e kontratës deri më 31.12.2023, konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa efektivitet, pasi nga shpenzimi i tyre autoriteti kontraktor nuk ka përfituar asnjë dobi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote”, Vendim nr. 285, Datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Sa më sipër u la rekomandimi që AK të marrë masa që në rastet e kontratave të cilat kanë natyra dhe kohëzgjatje të ndryshme, të bëjnë ndarjen e tyre në procedura më vete, me qëllim që kohëzgjatja e njërës natyrë procedurës të mos kushtëzohet nga kohëzgjatja e natyrës tjetër të procedurës.

- Nga auditim i preventivit të procedurës së prokurimit me objekt “Kontratë blerje pjesë ndërrimi, mirëmbajtje teknike, rinovim licencash për sistemin VIOP, Cisco, Wireless, Telekonference”, u konstatua se zëri 5 “Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonference, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1 vjeçare”, është vendosur dy herë, njëherë si zë më vete dhe njëherë si pjesë e zërave të veçuar të preventivit, e cila ka sjellë që për rritje fiktive të shpenzimeve të bëra nga AK dhe përfitim të padrejtë nga BOE "I. S. sh.p.k + I. SHPK të vlerës 4,317,204 lekë pa TVSH. Sa më sipër u la rekomandimi që nga ana e Albcontrol SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 4,317,204 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit "I. S. sh.p.k + I. SHPK.
- Me shkresën nr.9996/1, datë 07.06.2021 Vendimit të asamblesë së aksionarit nr.38 datë 07.06.2021, Për miratimin e vendimit nr.3, datë 03.06.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Albcontrol” SH.A “Mbi shembjen e objektit kullë në aeroportin e Kukësit”, aksionari vendosi

shembjen e objektit të vlerësuar në shumën 2,432,000 lekë, për ti hapur rrugë investimeve infrastrukturore në aeroportin e Kukësit. Objekti kullë është përjashtuar nga zmadhimi i kapitalit. Si pasojë e këtij vendimi, në mungesë të objektit kullë e pa lëvizshme, për periudhën 2022-2023 janë zhvilluar dy procedura prokurimi (nga një për secilin vit), për marrjen me qira të një kulle të lëvizshme, me objekt “Sigurimi i kullës së kontrollit mobile në Aeroportin e Kukësit me gjithë pajisjet e nevojshme”, në vlerën totale 117,164,333 lekë pa TVSH.

Nga Autoriteti Kontraktual nuk është kryer një analizë kosto përfitim për të vendosur në lidhje me ndërtimin apo marrjen me qera të Kullës së Kontrollit në aeroportin e Kukësit, pas vendimit për prishjen e saj, duke qenë se dhe numri i fluturimeve dhe të ardhurave në aeroportin e Kukësit është i ulët.

I.3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Albcontrol SHA, ku në përgjithësi është zbatuar kuadrin rregullator, por janë konstatuar edhe shmangie të cilat kanë ndikuar në performancën financiare të shoqërisë. Gjatë vitit 2022, ashtu si edhe gjatë vitit 2021, shoqëria nuk ka arkëtuar asnjë të ardhur nga shërbimi en route dhe terminal charge si pasojë e një vendimi të gjykatës së shkallës së parë të Brukselit, për ngrirjen e llogarive të Albcontrol SHA pranë organizatës Eurocontrol. Për përballimin e situatës së krijuar mbi mos arkëtimin e të ardhurave, Albcontrol SHA ka lidhur 3 marrëveshje për hua financiare si më poshtë:

1-Vlera prej 5 milion Euro, nga Autoriteti Portual i Durrësit, nëpërmjet vendimit nr.5, datë 23.02.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 686 Prot., datë 03.03.2022.

2-Vlera prej 936,000,000 lekë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet vendimit nr.16, datë 17.08.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 2178 Prot., datë 24.08.2022.

3-Vlera prej 2,000,000,000 lekë, nga Autoriteti i Aviacionit Civil, nëpërmjet vendimit nr. 24, datë 22.12.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 3078 Prot., datë 27.12.2022.

4-Vlera prej 2,000,000,000 lekë, nga Korporata Shqiptare e Investimeve, nëpërmjet vendimit nr. 24, datë 21.11.2023 dhe me Kontratë Huaje nr. 2570 Prot., datë 24.11.2023.

5- Vlera prej 3,000,000,000 lekë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Kontratë Huaje nr. 2857 Prot., datë 27.12.2023. Gjithashtu shpenzimet për pagat, u rritën nga viti 2021 në vitin 2022, referuar të dhënave të bilancit, në mënyrë të pashpjegueshme duke qenë se edhe largimet e punonjësve ishin më të larta se rekrutimet e tyre si dhe shpenzimet për shpërblime kanë pësuar rritje të lartë nga viti 2021 në vlerën prej 3,372,141 lekë, në vitin 2022 në vlerën prej 69,842,736 lekë, ndërsa shpenzimet për trajnime të stafit janë ulur nga viti 2021 në vlerën prej 71,957,451 lekë në vitin 2022 në vlerën prej 35,164,048 lekë. Në lidhje me zhvillimin e procedurave të auditimit u konstatuan problematika në lidhje me hartimin e kriteve të veçanta dhe specifikimeve teknike, si dhe në disa raste edhe me përlllogaritjen e fondit limit.

Opinion i Auditimit

I. Opinion për auditimin e përputshmërisë:

Ne audituam përputshmërinë e veprimtarisë së Albcontrol SHA, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Albcontrol SHA, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Albcontrol SHA, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputshmërisë.”

II. Baza për opinionin e përputshmërinë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Albcontrol SHA” në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet ISSAI-P1, “Deklarata e Limës”; ISSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputshmërisë”. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Albcontrol SHA dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, në besojmë së dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Gjithashtu shoqëria ka përdorur pa Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet Fondet Publike në shumën **125,299,246** lekë pa TVSH.

Gjatë realizimit të procedurave të auditimit janë konstatuar veprime me dëm ekonomik me vlerë **4,317,204** lekë pa TVSH.

III. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i Albcontrol SHA është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e buxhetit dhe të pasqyrave të llogaridhënies vjetore në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm efektiv, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

IV. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë *siguri të arsyeshme*, që veprimtaria e shoqërisë Albcontrol, në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*). Objektivi ynë lidhet me *dhënien e sigurisë së arsyeshme* mbi përputhshmërinë e aktivitetit të shoqërisë Albcontrol, me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në Raportin Përfundimtar të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH*”, në zbatim të programit të auditimit me nr. 1045/1 Prot., datë 29.12.2023, i ndryshuar me nr. 1045/2 Prot., datë 05.03.2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u zhvillua auditimi mbi përputhshmërinë në “Albcontrol SHA”, me grupin e auditimit me përbërje:

- E. K. (përgjegjës grupi)
- K. H.
- E. S.
- R. K.

1. Objektivat dhe qëllimi

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Albcontrol SHA, në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e proceseve dhe aktiviteteve të institucionit.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar mbi auditimin e përputhshmërisë të Albcontrol SHA, në kontekstin e vlerësimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me administrimin e fondeve, hierarkinë dhe transparencën e vendimmarrjeve të organeve drejtuese.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme

dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH-së janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

5. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; (ISSAI) të INTOSAI-t;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Baza Ligjore;

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;

Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar;

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti Përfundimtar i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme;
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikën më të mira të fushës.

7. Metodatat e auditimit

Audituesit e KLSH-së, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Albcontrol SHA, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

8. Dokumentimi i auditimit

Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

ANTA SHA u krijua si ndërmarrje shtetërore në vitin 1992. U transformua në shoqërinë aksionare Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror në datën 3 shkurt 1999. Kjo shoqëri menaxhon dhe kontrollon hapësirën ajrore Shqiptare (FIR) në përputhje me standardet ndërkombëtare të lundrimit ajror.

Albcontrol SHA është emërtimi i ri për të qenë sa më pranë identitetit shtetëror dhe kombëtar, për të përfaqësuar sa më mirë shërbimet që ofron, dhe për t'u përafuar me shoqëritë simotra evropiane, që nga data 15 nëntor 2013.

Albcontrol SHA është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, pronë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Albcontrol drejtohet nga një Këshilli Drejtues, që përbëhet nga 6 anëtarë të cilët emërohen nga Ministria përgjegjëse. Me drejtimin dhe administrimin e Albcontrol është i ngarkuar Drejtori i Përgjithshëm i cili njihet edhe në cilësinë e administratorit të shoqërisë.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Pika 1: Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm

Në zbatim të pikës nr. 1, të Programit të Auditimit nr. 1045/1 Prot., datë 29.12.2023, i ndryshuar, "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së" u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Planet e masave të ndërmarra nga Albcontrol SHA për zbatimin e rekomandimeve.

2. Dokumentacion plotësues dhe justifikues për zbatimin e rekomandimeve.
3. Kthim përgjigje mbi pyetësonin për zbatimin e rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 15, gërma “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Albcontrol SHA ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 2000/6 Prot., datë 12.12.2022, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 30, Pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Albcontrol SHA nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, duke mos respektuar kështu afatin 6 mujor të informimit në lidhje me ecurinë mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës “**Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me “Rostering System” – Faza III**”, viti 2019, u konstatua se kërkesa Nr. 228, dt. 25.01.2019, për iniciimin e realizimit të procedurës së prokurimit nuk përmban asnjë argument të nevojës së Albcontrol SHA, për realizimin e këtij prokurimi, dhe 43 nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për iniciimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.

-Kriteri për punimet e ngjashme konsiderohet i paargumentuar pasi sistemi i akses control dhe sistemi i evakuimit në raste alarmi nuk lidhen me aviacionin civil, por janë sisteme që funksionojë në mënyrë universale dhe kanë të njëjtët parime dhe standarde pune pavarësisht fushës ku aplikohen.

- Kriteret për zotërim të certifikatës **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit”, të certifikatës PAS 99:2012 për Sistemin e Integruar të Menaxhimit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kësaj certifikate ose ekuivalentë me to, të certifikatës për sistemin e menaxhimit të energjisë ISO 50001:2011. Certifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kësaj certifikate. Ose ekuivalentë me to, të certifikatës për sistemin e menaxhimit të përgjegjshmërisë sociale SA 8000:2014. Certifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kësaj certifikate. Ose ekuivalente me to në opinionin e grupit të auditimit, përcaktimi i tyre si kriter për kualifikimin e operatorëve ekonomikë nuk nxit operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në këtë procedurë dhe konsiderohen si kritere që nuk lidhen me realizimin e

objektit të procedurës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 178-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës sipas objektit të prokurimit për të hartuar një raport për domosdoshmërinë e çdo kriteri të veçantë të përcaktuar në këtë procedurë. Në varësi të rezultateve të raportit të hartuar nga specialistët e fushës, sipas përgjegjësive përkatëse të merren masa administrative përkatëse nga ana e shoqërisë.

Komente mbi zbatimin

Nuk u paraqit dokumentacion shtesë justifikues.

Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës gjatë vitit 2019, lidhur me ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, janë marrë ose një ditë para, ose brenda të njëjtës ditë, me atë kur është miratuar relacioni përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm që i propozonte. Referuar materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, konstatohet se miratimet e ndryshimeve me Vendimet nr. 19 dhe nr. 22 e Këshillit Mbikëqyrës, janë marrë brenda të njëjtës ditë me relacionet përkatëse të Drejtorit të Përgjithshëm, për ndryshimin e programit të zhvillimit ekonomik. Veç të tjerash, propozimet e përfshira në relacionet shpjeguese kanë qenë në të dyja rastet të shumta dhe koha brenda të cilës janë marrë vendimet nga Këshilli Mbikëqyrës, ka qenë e pamjaftueshme për anëtarët e tij, për të marrë informacion, për të bërë vlerësime dhe për të marrë vendime të kujdesshme në interes të aktivitetit të shoqërisë, duke anashkaluar parimin e përgjithshëm mbi ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, në shoqëritë tregtare të cilat menaxhohen nga një sistem administrimi me dy nivele, ku ndarja e funksioneve, ai i hartimit të politikave, i ushtruar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe ai i zbatimit të politikave, i ushtruar nga Drejtori i Përgjithshëm, mbetet detyrim i cili duhet respektuar në thelb. Konstatohet se, relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm japin një përshkrim të shkurtër të propozimeve, pa një analizë të hollësishme mbi domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve, në shtesa apo pakësimi të zërave të shpenzimeve, ndërsa nga procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës rezulton mospjesëmarrje e përfaqësuesve të Divizioneve që kanë lidhje me çështjet, objekt propozimi për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të cilët do të duhej të prezantonin materialin për pjesën teknike, e po kështu dhe mungesa e nënshkrimeve në relacionet propozuesve për ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 163, neni 164, neni 166, të Statutit të shoqërisë “ALBCONTROL” SHA, neni 21 dhe me Rregulloren e Brendshme të “ALBCONTROL” SHA, miratuar me Vendimin nr. 9, datë 26.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, Kreu IV “Funksionimi i shoqërisë”, nenet 21, 37, 38, 39 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 43-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për ushtrimin e kompetencave të tij për miratimin e propozimeve të ndryshimeve të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, vetëm pasi të jetë paraqitur nga shoqëria i gjithë dokumentacioni shpjegues për nevojën e këtyre ndryshimeve, duke marrë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe njohur relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm e duke shmangur vendimmarrjen e përshpejtuar. Titullari i Albcontrol SHA dhe Departamentet e shoqërisë të marrin masa të hartojnë dhe administrojnë propozimet për

ndryshimet e mundshme të ardhmen të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, shoqëruar me relacione të hollësishme teknike dhe financiare.

Komente mbi zbatimin

Nga auditimi i materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës gjatë viteve 2022-2023, lidhur me ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, u konstatua se është rritur periudha kohore, me atë kur është miratuar relacioni përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm që i propozonte.

Gjithashtu referuar materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, konstatohet se relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm japin një përshkrim të zërave që janë propozuar për ndryshim, të detajuar në nën zërat përkatës dhe të argumentuar domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve.

Ndërsa nënshkrimet në relacionet propozuesve për ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik mungojnë në disa relacione.

1. Titulli i gjetjes: Ecuria e zbatim rekomandimeve

Situata: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lënë në auditimin e mëparshëm të kryer në Albcontrol SHA, konstatohet se KLSH në përfundim të auditimit ka dërguar në subjekt raportin përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes në të cilin janë dhënë 2 masa organizative të cilat janë pranuar por nuk janë zbatuar. Subjekti Albcontrol SHA nuk ka raportuar pranë KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, detyrë që duhet ta kryente brenda afatit 6 mujor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

Kriteri: Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Ndikimi/Efekti: Përmirësim i aktivitetit të institucionit

Shkaku: Neglizhencë nga personat përgjegjës

Rëndësia: E mesme

1.1 Rekomandimi: Bazuar në nenin 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si më poshtë:

1.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës sipas objektit të prokurimit për të hartuar një raport për domosdoshmërinë e çdo kriteri të veçantë të përcaktuar në këtë procedurë. Në varësi të rezultateve të raportit të hartuar nga specialistët e fushës, sipas përgjegjësive përkatëse të merren masa administrative përkatëse nga ana e shoqërisë;

2.1.Rekomandimi:Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për ushtrimin e kompetencave të tij për miratimin e propozimeve të ndryshimeve të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, vetëm pasi të jetë paraqitur nga shoqëria i gjithë dokumentacioni shpjegues për nevojën e këtyre ndryshimeve, duke marrë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe njohur relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm e duke shmangur vendimmarrjen e përshpejtuar. Titullari i Albcontrol SHA dhe Departamentet e shoqërisë të marrin masa të hartojnë dhe administrojnë propozimet për ndryshimet e mundshme të ardhmen të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, shoqëruar me relacione të hollësishme teknike dhe financiare.

- **Pika 2: Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese të Albcontrol SHA, bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimi i tyre.**

Në zbatim të Pikës 2 të Programit të Auditimit nr.1045/1 Prot. datë 29.12.2023, i ndryshuar, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese të Albcontrol SHA, besueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimi i tyre*”, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Albcontrol SHA.

Mbledhjet dhe vendimet e marra nga Këshilli Drejtues 2021-2023

ANTA SHA u krijua si ndërmarrje shtetërore në vitin 1992. U transformua në shoqërinë aksionare Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror në datën 3 shkurt 1999. Kjo shoqëri menaxhon dhe kontrollon hapësirën ajrore Shqiptare (FIR) në përputhje me standardet ndërkombëtare të lundrimit ajror.

Albcontrol SHA është emërtimi i ri për të qenë sa më pranë identitetit shtetëror dhe kombëtar, për të përfaqësuar sa më mirë shërbimet që ofron, dhe për t’u përafuar me shoqëritë simotra evropiane, që nga data 15 nëntor 2013.

Albcontrol SHA është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, pronë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Albcontrol SHA drejtohet nga një Këshilli Drejtues, që përbëhet nga 6 anëtarë të cilët emërohen nga Ministria përgjegjëse. Me drejtimin dhe administrimin e Albcontrol është i ngarkuar Drejtori i Përgjithshëm i cili njihet edhe në cilësinë e administratorit të shoqërisë.

Këshilli Drejtues i Albcontrol aktualisht përbëhet nga 6 anëtarë:

- Z. G. GJ. – Kryetar afati i emërimit 02/10/2023-02/10/2026
- Znj. V. H. – Anëtar afati i emërimit 16/05/2022-16/05/2025
- Z. B. K. – Anëtar afati i emërimit 25/11/2020-25/11/2024
- Z. I. Gj. – Anëtar afati i emërimit 06/01/2022-06/01/2025
- Znj. O. C. – Anëtar afati i emërimit 07/08/2023-07/08/2026
- Znj. M. G. – Anëtar afati i emërimit 25/10/2023-25/10/2026

Vendimet për Administratorin dhe Këshillin Mbikëqyrës 2021-2023

Vendimi datë 03.06.2021 ka sjellë ndryshimet e mëposhtme tek administratorët: është shtuar administratori z. H. B. nga data 07/06/2021-07/06/2024 është larguar administratori z. M. K.

Vendimi datë 07.07.2021 për ndryshim anëtari Këshilli Mbikëqyrës. Largimi i z. G. GJ. dhe emërimi i znj. K. N.. Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek Këshilli Mbikëqyrës: është shtuar anëtari znj. K. N. Nga data 07/07/2021 në datën 07/07/2024 është larguar anëtari z. G. Gj.

Vendimi datë 07.07.2021 ku është vendosur: Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës znj. L. O..

Vendimi i datës 21.07.2021 ku është vendosur: Emërimin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës znj. D. D.. Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek Këshilli Mbikëqyrës: është shtuar anëtari znj. D. D. nga data 21/07/2021-21/07/2024 është larguar anëtari znj. L. O..

Vendimi i aksionarit Nr. 85 Prot datë 06.01.2022 ku është vendosur: Lirimi nga detyra e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë “Albcontrol” SHA të: znj. D. D. dhe znj. K. M. (Ngjela) dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës znj. E. F., përfaqësuese e MFE-së dhe z. I. Gj., përfaqësues i MFE.

Vendimi datës 11.5.2022 për ndryshim administrator. Është shtuar administratori znj. L. O. nga data 11/05/2022 në datën 11/05/2025 është larguar administrator z. H. B.

Vendimet për ndryshimet e mëposhtme tek Këshilli Mbikëqyrës:

Vendimi datë 16.05.2022 ka ndryshuar të dhënat për anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës znj. V. H. , ishte 23/04/2019-16/05/2022, kohëzgjatja u bë 23/04/2022-16/05/2025.

Vendimi datë 26.05.2022 ndryshuar të dhënat për anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës znj. M. K. , ishte 20/10/2017-26/05/2021, kohëzgjatja u bë 20/10/2021-26/05/2025.

Vendimi datë 19.09.2022 ku është vendosur: Riemërimi Anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës znj. A. K., ishte 20/10/2017-19/09/2022, kohëzgjatja u bë 20/10/2021-19/09/2025.

Vendimi datë 16.02.2023 për lirim nga detyra si anëtare të znj. M. K. dhe znj. E. F. .

Vendimi datë 15.06.2023 për emërimin e znj.S. H. si anëtare e Këshillit Mbikëqyrës nga data 15/06/2023-15/06/2026.

Vendimi datë 07.08.2023 për emërimin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës znj.O. C. nga data 07/08/2023-07/08/2026.

Vendimi datë 08.09.2023 për lirim nga detyra si anëtare të Këshillit Mbikëqyrës znj. A. K..

Vendimi datë 02.10.2023 për emërimin në detyrë si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës z. G. Gj. me kohëzgjatje nga 02/10/2023-02/10/2026.

Vendimi datë 25.10.2023 për lirim nga detyra si anëtare të Këshillit Mbikëqyrës znj. S. H., dhe emërimin në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës znj. M. G. nga data 25/10/2023-25/10/2026.

Nga shqyrtimi i emërimeve të anëtarëve të Këshillit Drejtues, Emërimi i anëtarit z. B. K. është bërë në kundërshtim me ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 neni 155, pika 2 dhe neni 167, pika 4.

Konkretisht mandati i anëtarit të këshillit mbikëqyrës z. B. K. është për një afat 4 vjeçar kur neni 155, pika 2 e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008;

2. Anëtarët e këshillit të administrimit zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të këtij ligji, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili **nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet**. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të rizgjidhen.

neni 167, pika 4 e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008;

4. Parashikimet e neneve 155 e 157 të këtij ligji zbatohen edhe për numrin e anëtarëve, emërimin, përbërjen dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, me përjashtimet vijuese: a) anëtarët e këshillit nuk duhet të kryejnë funksione administrimi dhe shumica e tyre duhet të jenë të pavarur; b) statuti mund të parashikojë që disa prej tyre mund të zgjidhen dhe/ose shkarkohen nga punëmarrësit e shoqërisë.

2.Titulli i gjetjes: Emërimi i anëtarit z. B. K. në mospërputhje me legjislacionin në fuqi.

Situata: Nga auditimi u konstatua se nuk janë zbatuar si duhet procedurat për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, pasi në një rast, për z. B. K., rezultoi se është emëruar anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën nga data 25.11.2020 deri në datën 25.11.2024, pra me një mandat 4 vjeçar, nga 3 që parashikojnë dispozitat ligjore.

Kriteri: Neni 155, pika 2 e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008

Ndikimi/Efekt: Ushtrimi i funksionit jashtë mandatit e bën Këshillin Mbikëqyrës të ngelet me 5 anëtarë nga 6 që është vendosur nga ministria përgjegjëse.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në lidhje me kohëzgjatjen e emërimeve për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës si dhe të amendimit të afateve të kontratave.

Rëndësia: E lartë

2.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albcontrol, të respektojë afatin 3 vjeçar, si kohë të qëndrimit

në detyrë për këta punonjës, si dhe këto ndryshime të paraqiten edhe në ekstraktin historik të Shoqërisë ne QKB.

Në lidhje me sa më sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Në nenin 135, pika 2/c të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), përcaktohet që: 2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, kur parashikohet në statut, emërimin dhe revokimin e administratorëve. Veç sa më sipër, edhe në nenin 13, pika 2/c të Statutit të ALBCONTROL SHA përcaktohet që: 2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të

shoqërisë: c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës; Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës monitorohet nga Aksionari dhe është ky i fundit që nxjerr aktet përkatëse lidhur me emërimin, shkarkimin apo zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Fakti që anëtari ka ushtruar funksionet e tij përtej mandatit ligjor, pranuar kjo edhe nga Aksionari, mund të konsiderohet pranim në heshtje i vazhdimit të qëndrimit në detyrë të tij, nga Aksionari i shoqërisë.

Për më tepër, në nenin 17, pika 2 të Statutit të ALBCONTROL SHA përcaktohet që: Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës, mandati i të cilit ka përfunduar, qëndron në detyrë deri në emërimin e anëtarit të ri.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pas analizimit të observacioneve dhe takimit të mirëkuptimit, nuk u arrit të merren fakte apo argumente të tjera shtesë mbi rrëzimin e gjetjes së kryer nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër observacioni nuk u pranua.

Mbledhjet dhe vendimet e marra nga Këshilli Drejtues 2021-2023

Viti 2021

- 19.10.2021 Vendimi nr. 15 “Për miratimin e programit strategjik 2022 – 2024 të planit vjetor të auditimit të brendshëm”;
- 20.10.2021 Vendim nr. 16 “Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të vitit 2021”;
- 17.12.2021 Vendim nr. 17 “Mbi programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë të vitit 2022”
- 17.12.2021 Vendim nr. 18 ”Për krijimin e provizionit të shumave të debitorëve të Albcontrol SHA”

Viti 2022

- 21.01.2022 Vendim nr. 1 “Për zgjedhjen e kryetarit të KM të shoqërisë Albcontrol SHA”;
- 21.01.2022 Vendim nr.2 “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një kredie financiare nga Albcontrol SHA”
- 21.01.2022 Vendim nr. 3 “Për miratimin e raportit të audituesit ligjor për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Albcontrol SHA”;
- 21.01.2022 Vendim nr. 4 “Për një ndryshim në nr. total të punonjësve të shoqërisë Albcontrol SHA”;
- 23.02.2022 Vendim nr. 5 “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një huaje nga Autoriteti Portual i Durrësit”;
- 23.02.2022 Vendim nr. 6 “Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë Albcontrol SHA”;
- 30.03.2022 Vendim nr. 7 “Për një ndryshim në Vendimin e KM nr. 1, datë 24.04.2020 dhe për kthimin e pagave në nivelin e para-pandemisë”;
- 30.03.2022 Vendim nr. 8 “Për një ndryshim në Statutin e Shoqërisë Albcontrol SHA”;
- 30.03.2022 Vendim nr. 9 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shoqërisë Albcontrol SHA”;
- 30.03.2022 Vendim nr. 10 “Për një ndryshim në planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2022”;

-
- 05.05.2022 Vendim nr. 11 “Për lirimin e z. H. B. nga detyra e Administratorit të Shoqërisë Albcontrol SHA”;
 - 05.05.2022 Vendim nr. 12 “Për emërimin e Znj. L. O. në detyrën e Administratorit të Shoqërisë Albcontrol SHA”;
 - 05.07.2022 Vendim nr. 13 “Për miratimin e kontratës së administrimit të shoqërisë Albcontrol SHA”;
 - 05.07.2022 Vendim nr. 14 “Për miratimin e raportit të audituesve ligjorë dhe pasqyrave financiare 2021”;
 - 05.07.2022 Vendim nr. 15 “Për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të shoqërisë Albcontrol SHA”;
 - 18.08.2022 Vendim nr. 16 “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një huaje nga DPSHTRR”;
 - 30.09.2022 Vendim nr. 17 “Për përfundimin e marrëdhënieve të punës me kërkesën e saj të znj. E. F”;
 - 13.10.2022 Vendim nr. 18 “Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik për Shoqërinë Albcontrol SHA”;
 - 13.10.2022 Vendim nr. 19 “Për miratimin e programit strategjik 2023 – 2025 plani vjetor i njësisë së auditimit të brendshëm për vitin 2023”;
 - 13.10.2022 Vendim nr. 20 “Mbi përmirësimin/përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme të Albcontrol SHA”;
 - 15.12.2022 Vendim nr. 21 “Mbi dhënien e miratimit për kalimin kapital të disa pajisjeve të punës shkollës Rexhë Deliu, Fushë Krujë, Rinas”;
 - 15.12.2022 Vendim nr. 22 “Mbi programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë Albcontrol SHA të vitit 2023”;
 - 15.12.2022 Vendim nr. 23 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë Albcontrol SHA”;
 - 22.12.2022 Vendim nr. 24 “Mbi dhënien e miratimit për përfitimin e mbështetjes financiare nga Autoriteti i Aviacionit Civil”;
 - 28.12.2022 Vendim nr. 25 “Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të Shoqërisë Albcontrol SHA të vitit 2022”.

Viti 2023

- 29.03.2023 Vendim nr. 1 “Për emërimin e sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës”;
- 29.03.2023 Vendim nr. 2 “Për ri klasifikimin e të ardhurave të Albcontrol SHA për vitin ushtrimor 2022”;
- 13.06.2023 Vendim nr. 3 “Për miratimin e raportit të audituesit ligjor për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të Albcontrol SHA”;
- 13.06.2023 Vendim nr. 4 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë Albcontrol SHA”;
- 13.06.2023 Vendim nr. 5 “Për miratimin e shkallatores së re të pagave për punonjësit e Albcontrol SHA”;
- 13.07.2023 Vendim nr. 6 “Për miratimin e raportit të audituesve ligjorë dhe pasqyrave financiare për vitin 2022”;
- 20.10.2023 Vendim nr. 7 “Për zgjedhjen e kryetarit të KM të Albcontrol SHA”;
- 20.10.2023 Vendim nr. 8 “Për miratimin e rregullores së Brendshme të Shoqërisë Albcontrol SHA”;

- 20.10.2023 Vendim nr. 9 “Për një ndryshim në Programin e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë Albcontrol SHA për vitin 2023”;
- 20.10.2023 Vendim nr. 10 “Për miratimin e programit strategjik 2024 – 2026 dhe planit vjetor 2024 të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Albcontrol SHA”;
- 20.10.2023 Vendim nr. 11 “Për miratimin e kërkesës së ALBCONTROL lidhur me negociimin e kontratës me DPSHTRR”;
- 20.10.2023 Vendim nr. 12 “Për dhënien e miratimit për kalimin kapital të disa librave dhe pajisjeve Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”;
- 21.11.2023 Vendim nr. 13 “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një huaje financiare nga Korporata e Investimeve Shqiptare”;
- 14.12.2023 Vendim nr. 14 “Mbi programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë Albcontrol SHA për vitin 2024”;
- 14.11.2023 Vendim nr. 15 “Për një ndryshim në Programin e Zhvillimit Ekonomik të Albcontrol SHA për vitin 2023”.

Bazuar në një vlerësim me bazë risku nga grupi i auditimit janë kërkuar të vihen në dispozicion praktikat e disa nga vendimeve të mësipërme me dokumentacionin e plotë justifikues të shënuara me highlight.

- Në lidhje me Vendim nr. 18, datë 17.12.2021 “Për krijimin e provizionit të shumave të debitorëve të Albcontrol SHA” është mbajtur Relacioni nr.2027 prot., datë 13.12.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm z. H. B.. Bazuar në relacionin si mëposhtëm, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendimin nr.18 datë 17.12.2021 “Për krijimin e provizionit të shumave të debitorëve të Albcontrol SHA” Këshilli Mbikëqyrës me përbërje Znj. A. K. , z. B. K., znj. M. K., znj. V. H., znj. K. N. dhe znj. D. D..

*Relacioni “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga audituesit ligjorë të pasqyrave financiare, deri më 31.12.2020”
Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga audituesit ligjorë të cilët audituan pasqyrat financiare të shoqërisë Albcontrol SHA deri më datë 31 dhjetor 2020 u konstatua si mëposhtë:*

-Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme;

Në pasqyrat financiare të shoqërisë në pozicionin llogari të arkëtueshme tregtarë ekziston një e drejtë e arkëtueshme ndaj ish kompanisë ajrore B. A.. Kjo kompani ajrore rezulton debitorë për shërbimin e ofruar të terminalit, në shumën 278,240.88 euro për periudhën Korrik-Nëntor 2013. Për këtë periudhë kjo kompani ka akumuluar edhe një penalitet me vlerë 3,013.97 euro. Në datën 24.11.2013 kjo kompani ka ndërprerë fluturimet dhe në datën 22.11.2013 ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesën për hapjen e procedurës së falimentit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.580, datë 22.01.2014, vendosi pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës për falimentim. Albcontrol sh.a ka dorëzuar dokumentacionin përkatës, në lidhje me detyrimin e shoqërisë B. A. me vlerë 281,254.85 euro, shumë e rakorduar dhe pranuar nga administratori i falimentit. Ndodhur në këto kushte kur kjo llogari e arkëtueshme është e vjetruar mbi 5 vite ndërkohë që procesi i likuidimit është ende në proces, bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit si dhe rekomandimeve të ekspertëve kontabël që kanë audituar pasqyrat financiare të shoqërisë, ku kërkohet aplikimi i zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme dhe paraqitja e vlerës së aktiveve dhe kapitalit në vlerë të drejtë, propozojmë që detyrimi i kompanisë ajrore B. A. në vlerën 34,418,396.86 lekë të kalojë në provizione.

-Për shërbimin Terminal Charges;

Sipas “Annual Report and Accounts Terminal Charges 2020”, nga EUROCONTROL është paraqitur për provizionim vlera 177,089.76 euro e cila është e akumuluar për vitin 2020. Në total vlera për provizion për terminal charges në datë 31.12.2020 shkon në vlerën 357,320.76 euro, e cila përfshin detyrime të kompanive ajrore të cilat aktualisht nuk operojnë më në tregun e aviacionit. Bazuar në marrëveshjen nr.15 prot., datë 23.12.2015 2 palëshe midis Albcontrol dhe Eurocontrol përgjegjëse për mbledhjen me forcë të ardhurave të Terminalit është shoqëria Albcontrol sh.a, procedurë e cila po ndiqet nga struktura e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi.

Ndodhur në këto kushte kur Eurocontrol ka kryer zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme bazuar në SNK dhe IFRS, ne propozojmë që bazuar në “Annual Report and Accounts Terminal Charges 2020”, rekomandimeve të ekspertëve kontabël që kanë audituar pasqyrat financiare të shoqërisë si dhe SNK, që detyrimi për shërbimin terminal charge në vlerë prej 44,200,578.00 të kalojë në provizion.

-Huatë

Në pasqyrat financiare të shoqërisë Albcontrol sh.a ne pozicionin Huatë Afatgjata ekziston një detyrim ndaj Bankës Gjermane-KFW në vlerë 10,228,634.00 lekë. Ky detyrim është shënuar në librat kontabël të shoqërisë në vitin 2004 prej kësaj periudhe kjo hua nuk është amortizuar dhe nuk është paguar interesa.

Shoqëria Albcontrol nuk disponon asnjë dokument në lidhje me këtë hua, dhe ju drejtua me shkresën nr.1736 prot., datë 25.10.2021 “Kërkesë për Informacion” MFE (në cilësinë edhe të aksionarit) nëse Albcontrol sh.a ka përfituar ndonjë kredi nga Banka Gjermane-KFW.

MFE me anë të shkresës nr.18834/1 prot., datë 15.11.2021 informon Albcontrol se ekziston vetëm një kredi e akorduar nga Banka Gjermane për Aeroportin e Rinasit, e cila është nënshkruar ndërmjet KFW, Bankës së Shqipërisë dhe Albtransport (kanalizuar Albtransport). Kjo kredi aktualisht shlyhet nga shoqëria “T. A. P” sh.p.k, sipas marrëveshjes së kondencionarit.

Ndodhur në këto kushte kur ky detyrim nuk ekziston, propozojmë që ky detyrim me vlerë 1.,228,634.00 lekë duhet të sistemohet në pasqyrat financiare të shoqërisë (të fshihet si detyrim në pozicionin Hua Afatgjatë dhe vlera të kalojë në rezultat).

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Në zbatim të sa më sipër, ALBCONTROL SHA i ka dërguar disa shkresa kompanisë B. A., për ta njoftuar lidhur me detyrimet e prapambetura. Konkretisht ka dërguar shkresat që vijojnë: -Nr. prot. 561/14, datë 17.09.2013 “Njoftim mbi detyrimet e papaguara”; -Nr. prot. 561/16, datë 21.10.2013 “Njoftim për detyrimet e papaguara” (bashkëlidhur).

Në datën 22.11.2013, Shoqëria B. A. ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë, kërkesën për hapjen e procedurës së falimentit

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 580, datë 22.01.2014 ka vendosur pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentit (ref. Vendimi nr. 171 Akti, datë 13.12.2019). ALBCONTROL ka depozituar të gjithë dokumentacionin përkatës që lidhet me detyrimet e B. A. dhe ka ndjekur seancat e zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për këtë çështje.

Në datë 13.05.2015, Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mbi radhën e kreditorëve, ku rezultojnë se Albcontrol bën pjesë tek kreditorët fundorë, zëri “Furnitorë të ndryshëm, agjencitë dhe pasagjerët”, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me Vendimin nr. 117, datë 07.03.2017 (bashkëlidhur)

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit, mori në konsideratë pretendimet e Albcontrol SHA dhe kreu rregullimet përkatëse përgjatë materialit.

Për sa më sipër observacioni u pranua.

Për marrjen e vendimit nr. 3, datë 21.01.2022 “Për miratimin e raportit të audituesit ligjor për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Albcontrol SHA” drejtori i përgjithshëm z. H. B. i është drejtuar me një kërkesë nr.118 prot, datë 17.01.2022 Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA. Këshilli Mbikëqyrës me përbërje Znj. A. K. , z. B. K., znj. M. K., znj. V. H., z. I. Gj. dhe znj. E. F..

Kërkesë për miratimin e raportit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “Albcontrol SHA”

Në zbatim të Urdhrit të përbashkët të MFE-së dhe MIE-së nr.5907/2, datë 15.10.2020 “Për kalim kapital të aktiveve afatgjata materiale” nga ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti i Aviacionit Civil), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (“Albcontrol” SHA), shoqëria me shkresën nr.1849 prot., datë 26.11.2020 ngriti grupin e punës për marrjen në dorëzim të aktiveve afatgjata materiale të aeroportit të Kukësit nga Autoriteti i Aviacionit Civil, me vlerë totale 12,708,690 lekë.

Me shkresën nr.9996/1 datë 07.06.2021 Vendimit të asamblesë së aksionarit nr.38 datë 07.06.2021, Për miratimin e vendimit nr.3 datë 03.06.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Albcontrol” SH.A “Mbi shembjen e objektit kullë

në aeroportin e Kukësit”, aksionari vendosi shembjen e objektit të vlerësuar në shumën 2,432,000 lekë, për ti hapur rrugë investimeve infrastrukturore në aeroportin e Kukësit.

Në vijim të procesit, Albcontrol SHA me shkresën nr.1248 prot., datë 03.08.2021 “Mbi caktimin e një eksperti për zmadhimin e kapitalit”, i drejtohet MFE-së në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme për të caktuar një ekspert kontabël të autorizuar, për të përgatitur raportin e zmadhimit të kapitalit.

Me vendim të asamblesë së përgjithshme të aksionarit nr.80 prot., datë 10.09.2021 “Për përgatitjen e dokumentacionit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë ALBCONTROL SHA, caktohet audituesi ligjor znj. A. M. për të përgatitur raportin e zmadhimit të kapitalit. Bazuar në këtë vendim, shoqëria Albcontrol SHA në datë 01.12.2021, lidhi kontratën nr.1931 prot., me audituesin ligjor të emëruar znj. A. M.

Për hartimin e raportit audituesi ligjor i është referuar pasqyrave financiare për vitin 2020 miratuar nga aksionari, pasqyrave të ndërmjetme për vitin 2021, listës së aktiveve afatgjata materiale marrë në dorëzim nga Autoriteti Aviacionit Civil, si dhe Vendimit të asamblesë së aksionarit nr.38 datë 07.06.2021, Për miratimin e vendimit nr.3 datë 03.06.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “ALBCONTROL” SHA “Mbi shembjen e objektit kullë në aeroportin e Kukësit”

Më datë 20.12.2021, audituesi ligjor znj. A. M. dorëzoi raportin për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë Albcontrol SHA, nga ku rezulton se:

Kapitali i regjistruar para ndryshimit është 5.953.141.000 lekë

Kapitali i regjistruar zmadhohet për 10.276.000 lekë

Kapitali i regjistruar pas zmadhimit bëhet 5.963.417.000 lekë

Vlera prej 2,432,000 lekë që i përket objektit kullë është përjashtuar nga zmadhimi i kapitalit.

Sa më sipër u konstatua:

Me shkresën nr.9996/1 datë 07.06.2021 Vendimit të asamblesë së aksionarit nr.38 datë 07.06.2021, Për miratimin e vendimit nr.3 datë 03.06.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Albcontrol” SHA “Mbi shembjen e objektit kullë në aeroportin e Kukësit”, aksionari vendosi shembjen e objektit të vlerësuar në shumën 2,432,000 lekë, për ti hapur rrugë investimeve infrastrukturore në aeroportin e Kukësit. Grupit të auditimit nuk iu vunë në dispozicion materiale gjendjen faktike të kullës, amortizimit të saj dhe planit të investimeve, kjo pasi për sigurimin e kullës për aeroportin e Kukësit janë zhvilluar 2 procedura prokurimi me vlerë totale 117,163,600 lekë pa tvsh.

- Për marrjen e vendimit nr. 2 datë 21.01.2022 “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një kredie financiare nga Albcontrol SHA” është mbajtur Relacioni nr.117 prot., datë 17.01.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm z. H. B.. Bazuar në relacionin si mëposhtë Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendimin nr. 2 datë 21.01.2022 “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një kredie financiare nga Albcontrol SHA” Këshilli Mbikëqyrës me përbërje znj. A. K., z. B. K., znj. M. K., znj. V. H., z. I. Gj. dhe znj. E. F..

Relacion “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një kredie financiare nga Albcontrol SHA”

-Konteksti

Situata financiare e shoqërisë vazhdon të rëndohet dita-ditës, duke rrezikuar seriozisht përmbushjen e misionit të tij nga muaji pasues Mars, pasojë e lëshimit të urdhrat të ekzekutimit nga shërbimi përmbarimor Belg, me objekt “Bllokimin/ngrirjen e llogarive të Shqipërisë në Eurocontrol” që në muajin dhjetor 2020(tashmë për rreth 14 muaj), për një problematikë të hapur ligjore ku palë është Republika e Shqipërisë. Ky veprim, ka sjellë si rrjedhojë ngrirjen/bllokimin e llogarive të të ardhurave të shoqërisë, të cilat gjenerohen nga tarifat e navigimit ajror. Për pasojë të gjitha tarifat e shërbimeve navigacionale ajrore, të mbledhura në emër të shoqërisë Albcontrol SHA nga kompanitë ajrore, nuk mund të disbursohen derisa të hiqet ky urdher sekuestro. Këto shuma mbahen të bllokuara nga Eurocontrol në një llogari të veçantë deri në përfundimin e gjyqit të ekzekutimit dhe çlirimit të llogarive.

-Kredia financiare-si rrugëzgjdhje për situatën e Albcontrol SHA

Pas miratimit të marrë prej Këshillit Mbikëqyrës me vendimin nr.13, datë 31.08.2021, Albcontrol SHA ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për sigurimin e kësaj kredie, e cila do të mundësoje nxjerrjen nga kjo situatë e vështirë financiare.

Pas kërkesës zyrtare për nevojën e një kredie financiare drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, ka qenë vetëm T. B., e cila është ofruar për të hyrë në negociata, duke marrë në konsideratë analizën e riskut që mbart pasiguria financiare e shoqërisë sonë, e cila lidhet me ecurinë e çështjes Becchetti kundër Republikës së Shqipërisë, me palë të tretë Albcontrol SHA. Shuma e kredisë e vendosur nga Këshilli Mbikëqyrës për tu negociuar ishte 22.4 milionë Euro. Edhe pse kërkesa nga Albcontrol SHA ka qenë për marrjen e një kredie financiare 22.4 milionë Euro, T. B. është ofruar për kryerjen e bisedimeve vetëm për një shumë kredie financiare prej 10 milion Euro.

-Nevoja për miratimin e pranimit të ofertës për kredi dhe mënyra e mundshme e përdorimit të saj.

Kjo kredi do të shërbeje si një burim financimi tranzitorë, kryesisht për shpenzimet mujore të domosdoshme si pagat, energjia, detyrime të prapambetura, shërbimet e mirëmbajtjes për ato aktivitete që do të gjykohen të nevojshme për vazhdimin e ofrimit të lundrimit ajror në kushtet e parrezikshmërisë, deri në finalizimin e vendimit pozitiv, apo të zgjidhjes përfundimtare të situatës së bllokimit që vazhdon prej datës 7 Dhjetor 2020.

Kjo kredi shërben si burim i pjesshëm dhe i përkohshëm i planit tonë financiar të shoqërisë, miratuar nga Eurocontrol dhe nuk përben një zgjidhje afatgjatë për shoqërinë. Kjo kredi do të përdoret për sa kohë që Albcontrol nuk ka të mundur të arrijë të marrë të ardhurat që i burojnë nga aktiviteti dhe ato vazhdojnë të qëndrojnë të bllokuara si edhe deri më sot, kur tashmë vlera e tyre llogaritet të jetë rreth 21.2 milionë Euro.

Nëse kredia do të përdoret, detyrimet që do të rrjedhin si interesa apo komisione, do të varen nga shumat e disbursuara dhe afatet e përdorimit të tyre (komisioni që aplikohet mbi shumën e disbursuar, interesi mbi shumën e përdorur dhe afatin e përdorimit të shumave respektive).

Në rast përdorimi, detyrimet për interesa dhe komisione të këtij financimi do të alokohen në Programin e Zhvillimit Ekonomik, Shpenzimet e detajuara, në “SEKSIONIN E/ Shpenzime Financiare”.

- Për marrjen e vendimit nr. 16 datë 18.08.2022 “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një huaje nga DPSHTRR” drejtori i përgjithshëm znj. L. O. ka bërë relacionin nr.2082 prot, datë 09.08.2022 Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA. Këshilli Mbikëqyrës me përbërje Znj. A. K., z. B. K., znj. M. K., znj. V. H., z. I. Gj. dhe znj. E. F..

Relacion “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një huaje nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor”

Të gjendur në kushtet e nevojës për një hua financiare e cila do të shërbente për të mbuluar shpenzimet e Shoqërisë për muajt në vazhdim, i jemi drejtuar me shkresën nr.1892 prot., datë 19.07.2022, Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor, me kërkesën për dhënien e një huaje financiare.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së Albcontrol sha, nëpërmjet shkresës nr.17940/5 prot., datë 09.08.2022 dhe nr. 1892/2 prot. Datë 09.08.2022 për dhënien e huasë në shumën prej 936,000,000 lekë, e cila do të lëvrohet sipas kushteve të kontratës.

- Për marrjen e vendimit nr. 5 datë 23.02.2022 “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një huaje nga Autoriteti Portual i Durrësit” drejtori i përgjithshëm z. H. B. ka bërë relacionin nr.525 prot, datë 21.02.2022 Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA. Këshilli Mbikëqyrës me përbërje Znj. A. K., z. B. K., znj. M. K., znj. V. H., z. I. Gj. dhe znj. E. F..

Relacion “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një huaje nga autoriteti portual Durrës”

Shoqëria Albcontrol SHA po përballlet me mungesë ekstreme likuiditeti, si pasojë e bllokimit tashmë rreth 15 muaj të llogarive (në vlerë aktuale 23,8 milion Euro) për shkak të një vendimi të Gjykatës së Shkallës së parë në Bruksel, i cili prej datës 10.12.2020, ka vendosur sekuestro konservative mbi llogarinë e Republikës së Shqipërisë në Eurocontrol. Theksojmë se kjo është llogaria e vetme e të ardhurave për realizimin e treguesve ekonomiko-financiare të shoqërisë Albcontrol SHA Aktualisht likuiditeti i vlefshëm që disponojmë nuk mundëson vijueshmërinë e aktivitetit.

Donim të sillnim në vëmendjen tuaj se nevojat financiare të parashikuara në buxhetin e miratuar nga ju për vitin 2022, janë në vlerën e rreth 31.8 milion Euro. Këto fonde do të mundësonin që situata të rikthehej më normalitet.

Për problematikat e mësipërme dhe në veçanti për vështirësinë në likuiditete, ne kemi bërë me dije në mënyrë të vazhdueshme Këshillin Mbikëqyrës, dhe kemi ndjekur rekomandimet që janë dhënë. Sa më lartë, në vijim të informacioneve mbi gjithë procesin e ndjekur dhënë në mbledhjet e mëparshme, në mbledhjen e datës 21.01.2022

përpara Këshillit u paraqit dhe propozimi për marrjen e një kredie financiare në vlerën e 10 milion Euro, e cila do të mundësonte vijueshmërinë provizore të veprimtarisë së kompanisë.

Aktualisht na është përcjellë Vendimi i Asamblesë së Akademisë së Aksionarit nr.29 datë 11.02.2022 “Për miratimin e Vendimit nr.2, datë 21.01.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë “Albcontrol” SHA “Mbi dhënien e miratimit për marrjen e një kredie financiare nga “Albcontrol” SHA.

Për sa më sipër duke konsideruar që:

Ka paqartësi kohore për afatet e shpalljes (tashmë të tejkaluar prej muajsh) dhe formën e vendimit të gjykatës për zhblokimin e fondeve të cilat na mundësojnë operimin;

Nevojës urgjente për likuiditete të shoqërisë për të garantuar vijueshmërinë e aktivitetit;

Si dhe duke mbajtur në konsideratë alternativën potenciale për vendimmarrje nga gjykata jo në favor të shoqërisë, që dikton vijimin e bllokimit të fondeve, atëherë do të ishte e domosdoshme sigurimi i një fondi të barabartë me parashikimin buxhetor për vitin 2022.

Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit me institucione që kanë fushë të veprimit transportin dhe ofrimin e shërbimeve të rëndësishme nga pikëpamja tregtare ashtu edhe logjistike, në datë 10.02.2022, i jemi drejtuar me shkresë Autoritetit Portual Durrës për mbështetje financiare në formën e një huadhënie.

Autoritetit Portual Durrës i është përgjigjur pozitivisht kërkesës tonë në mbështetje financiare, deri në vlerën 5,000,000 Euro, hua e cila do të lëvrohet sipas kushteve të draft kontratës.

Në gjendjen aktuale, nisur nga kushtet e paraqitura nga Autoritetit Portual Durrës, gjykojmë se kjo alternativë është e favorshme si në planin financiar ashtu dhe afatet kohore të disbursimit të fondeve.

Qasja jonë në këtë kontekst me mjaft të panjohura, është që në pritje të finalizimit të procedurave për nënshkrimin e kontratës së kredisë, fillimisht të mundësojmë mbarëvajtjen e funksionit të kompanisë me fondet që do të sigurohen nëpërmjet huasë nga Autoritetit Portual Durrës.

Në rast se fondet do të vijnë të qëndrojnë të bllokuara, dhe në mungesë të një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë, do të vijnë me procesin e kredimarrjes sipas temave dhe kushteve të dakordësuar.

- Vendim nr. 24 datë 22.12.2022 “Mbi dhënien e miratimit për përfitimin e mbështetjes financiare nga Autoriteti i Aviacionit Civil” është marrë bazuar relacioni nr.3030 datë 22.12.2022 të drejtorit të përgjithshëm znj. L. O. drejtuar Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA. Këshilli Mbikëqyrës me përbërje Znj. A. K., z. B. K., znj. M. K., znj. V. H., z. I. Gj. dhe znj. E. F..

Relacioni “Mbi dhënien e miratimit për përfitimin e mbështetjes financiare nga Autoriteti i Aviacionit Civil”

Albcontrol sh.a vijon të përballlet me mungesë likuiditeti si pasojë e zbatimit të një Urdhër Ekzekutimi nga një Gjykatë Belge mbi procesin gjyqësor ku palë është Republika e Shqipërisë. Pavarësisht të ardhurave të realizuara, këto fonde mbeten të papërdorshme nga shoqëria Albcontrol sha deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes të Gjykatës së Apelit në Belgjikë.

Në këto rrethana, nga ana e Këshillit Mbikëqyrës gjatë vitit 2022 janë dhënë edhe më parë miratime për marrjen e një huaje financiare si:

1-Vlera prej 5 milion Euro, nga Autoriteti Portual i Durrësit, nëpërmjet vendimit nr.5, datë 23.02.2022. Kjo marrëveshje përcakton edhe shlyerjen nga Albcontrol sha të interesave të humbura nga prishja e depozitave përpara afatit të përcaktuar nga APD në vlerën 3,457,000 lekë.

2-Vlera prej 936,000,000 lekë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet vendimit nr.16 datë 17.08.2022. Kjo marrëveshje përcakton edhe përballimin e komisioneve, interesat e overdraftit sipas kontratës dhe që janë parashikuar për vitin 2022 në vlerën 9,604,000 lekë.

Vlen të theksohet se shlyerja e detyrimeve të prapambetura që shoqëria ka akumuluar gjatë viteve 2020-2022, do ti jepte një frymëmarrje aktivitetit ekonomik dhe financiar të shoqërisë, për të vijuar me projektet e reja të planifikuara sipas plan-biznesit të vitit 2023.

Për sigurimin e këtij financimi kemi bërë një kërkesë pranë Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, i cili me anë të shkresës nr.2150 prot., datë 20.12.2022 (protokolluar me tonën me nr.2944/1 prot., datë 21.12.2022), si dhe Vendimi nr.6 datë 19.12.2022 të Këshillit Drejtues të AAC na është miratuar kërkesa jonë për mbështetje financiare. Marrëveshja e Bashkëpunimit për Mbështetje Financiare e propozuar gjendet bashkëlidhur, në të cilën përcaktohet se Autoriteti i Aviacionit Civil ka detyrimin për të transferuar shumën prej 2,000,000,000 (dy miliard) lekë, brenda muajit Dhjetor 2022.

Burimi i financimit do të përdoret për të financuar nevojat e shoqërisë sipas parashtrimeve më sipër, brenda zërave të buxheteve të miratuara nga organet vendimmarrëse të shoqërisë.

Sa më sipër, duke qenë se shpallja e vendimit përfundimtar nga Gjykata Belge është një proces i cili zgjat bazuar në afatet ligjore dhe kalendarin gjyqësor të miratuar, ndërkohe shoqëria ka nevojë urgjente për likuiditet për të garantuar vijueshmërinë e aktivitetit, kërkojmë nga Këshilli Mbikëqyrës miratimin tuaj.

3. Titulli i gjetjes: Marrja e huave si pasojë e bllokimit të llogarive

Situata: Gjatë vitit 2022, ashtu si edhe gjatë vitit 2021, shoqëria nuk ka arkëtuar asnjë të ardhur nga shërbimi en route dhe terminal charge si pasojë e një vendimi të gjykatës së shkallës së parë të Brukselit, për ngrirjen e llogarive të Albcontrol SHA pranë organizatës Eurocontrol. Për përballimin e situatës së krijuar mbi mos arkëtimin e të ardhurave, Albcontrol SHA ka lidhur 3 marrëveshje për hua financiare si më poshtë:

1-Vlera prej 5 milion Euro, nga Autoriteti Portual i Durrësit, nëpërmjet vendimit nr.5, datë 23.02.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 686 Prot., datë 03.03.2022.

2-Vlera prej 936,000,000 lekë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet vendimit nr.16 datë 17.08.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 2178 Prot., datë 24.08.2022.

3-Vlera prej 2,000,000,000 lekë, nga Autoriteti i Aviacionit Civil, nëpërmjet vendimit nr. 24, datë 22.12.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 3078 Prot., datë 27.12.2022.

4-Vlera prej 2,000,000,000 lekë, nga Korporata Shqiptare e Investimeve, nëpërmjet vendimit nr. 24, datë 21.11.2023 dhe me Kontratë Huaje nr. 2570 Prot., datë 24.11.2023.

5- Vlera prej 3,000,000,000 lekë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Kontratë Huaje nr. 2857 Prot., datë 27.12.2023.

Në kontratat e mësipërme janë përcaktuar dhe detyrimet e huamarrësit dhe huadhënësve si dhe normat përkatëse të interesit të huave.

Grupi i auditimit konstatoi që vendimi i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës i kalon kompetencat që ka ky këshill, për shkak se shoqëria aksionare përcakton tarifën e saj ose të ardhurat në bazë të kostos së institucionit. Në këtë rast që llogaria vijon të mbetet e bllokuar ose në rastin më të keq që llogaria në fjalë të mos arkëtohet, do të ishte e pamundur shlyerja e huave dhe regjistrimi i veprimeve kontabël duke e sjellë që shoqëria të vijojë operimin me humbje dhe drejt falimentimit të saj.

Kriteri: “Parimet për përcaktimin e kostos bazë për tarifën e mbikalimeve dhe llogaritjen e tarifave për njësi” dhe Ligji Nr.96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”

Ndikimi/Efekti: Operimi me humbje i shoqërisë dhe dërgimi drejt falimentit të saj

Shkaku: Ngrirja e llogarive si pasojë e një vendimi të gjykatës së shkallës së parë të Brukselit.

Rëndësia: E Lartë

3.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës, duke u nisur nga natyra dhe lloji i institucionit që përfaqësojnë, institucion i cili nuk është fitimprurës, ku të ardhurat që përfiton ky institucion përcaktohen në bazë të kostove vjetore (TR=TC), të ndërpresë praktikën e marrjes së huave e cila shoqërohet me kosto shtesë (interesi), të cilat Albcontrol nuk ka mundësi ti shlyej nga buxheti i vet. Shoqëria, burimin e financimit ta kërkojnë nëpërmjet aksionarit duke qenë se dhe bllokimi i llogarive ka ndodhur për llogari të Shtetit Shqiptar.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Të ardhurat e ALBCONTROL SHA të siguruar nga ofrimi i shërbimit të lundrimit ajror janë paguar në llogarinë e ALBCONTROL dhe qëndrojnë të bllokuara në EUROCONTROL. Ato kanë vetëm një destinacion përdorimi: janë të dedikuara për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror, sipas përcaktimeve të zërave të lejuar të shpenzimeve që përcaktohen në manualët dhe rregulloret ekonomike ndërkombëtare që rregullojnë aviacionin civil. Kështu, në kreun 1, pika 1/1, paragrafi 4 të dokumentit të Eurocontrol “Principles for establishing the cost-base for en route charges and the calculation of the unit rates”, përcaktohet se: “Shtetet palë të marrëveshjes duhet të sigurojnë që shumat e mbledhura në emër të tyre të përdoren për të financuar kostot e rrugës të përcaktuara në

përputhje me këto Parime të Procedurës”, çka qartëson se të gjitha të ardhurat e siguruara shkojnë për mbulimin e kostos së shërbimeve të ofruara. Të drejtat (e arkëtueshme) të ALBCONTROL SHA, që vazhdojnë të bllokuara në Eurocontrol, të cilat përfaqësojnë kostot e shërbimeve të ofruara, janë në vlerën afro 107 milionë euro, ndërkohë që fondet zëvendësuese (huatë në total) deri më sot janë në vlerën afro 7.5 miliardë lekë. ALBCONTROL SHA është kujdesur që vlerat zëvendësuese të likuiditeteve (Detyrimet afatshkurtra, të jenë më të vogla se vlera e fondeve të bllokuara në llogari (Të drejtat e ALBCONTROL). Organet drejtuese të Shoqërisë kanë detyrimin e ndjekjes së të gjitha hapave ligjore në mënyrë që ALBCONTROL SHA të mund të sigurojë ofrimin e shërbimeve në kushtet e sigurisë në operim dhe të vazhdueshmërisë. Kështu, ndër kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm, theksojmë parashikimin e germës “h” të pikës 2 të nenit 27, të Statutit të ALBCONTROL SHA: 2. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të: h) krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë; Sikurse është evidentuar edhe nga ana juaj në këtë projekt raport, për secilën nga këto hua janë hartuar relacione të detajuara me të cilat i jemi drejtuar Këshillit Mbikëqyrës dhe është kërkuar miratimi i tij si organi më i lartë, në përputhje të plotë me Statutin në fuqi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit, thekson që qëllimi i gjetjes së mësipërme lidhet me mundësitë e shlyerjes së huave të marra në rastin e mosarkëtimit të të drejtave të arkëtueshme.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

- Vendim nr. 5, datë 13.06.2023 “Për miratimin e shkalltores së re të pagave për punonjësit e Albcontrol SHA” është marrë bazuar relacioni nr.1261 datë 09.06.2023 të drejtorit të përgjithshëm znj. L. O. drejtuar Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA. Këshilli Mbikëqyrës me përbërje znj. A. K. , z. B. K., znj. V. H., z. I. Gj..

Relacion “Mbi analizën e ecurisë së përfitimeve të stafit dhe nevojave mbi rishikimin e shkalltores së pagave dhe nivelit të pagës bazë të punonjësve të shoqërisë Albcontrol sha.

Hyrje

Albcontrol sha është ent shtetëror që ofron shërbime të lundrimit ajror në kushtet e parrezikshmërisë, sipas përcaktimeve të ligjit 96/2020 “Për kodin ajror të Republikës së Shqipërisë”.

Prej vitit 2001, Albcontrol sha aderon në Konventën Ndërkombëtare të Eurocontrol mbi bazën e ligjit nr.8821, datë 15.10.2001 “Për aderimin e Shqipërisë në konventën Ndërkombëtare të Eurocontrol-it.

Një prej parimeve të unifikuara të detyrueshme për zbatim nga të gjithë shtetet anëtare të kësaj organizate është parimi i koston bazë, sipas të cilit programi i zhvillimit ekonomik (buxheti) duhet të planifikohet dhe realizohet në mënyrë të tillë që të ardhurat e shoqërisë të jenë të barabarta me shpenzimet.

Sipas këtij parimi dhe rregullave të përcaktuara nga EUROCONTROL:

Shoqëria nuk duhet të sigurojë fitim;

Nuk ka limit që kufizon shpenzimet e enteve në fjalë (për të siguruar realizimin e misionit të tyre, ofrimin e shërbimeve navigacionale në kushtet e parrezikshmërisë);

Elementët e koston bazë janë : i) kosto e stafit; ii) kosto operative; iii) kosto e amortizimit dhe iv) kosto e riskut kapitalit.

Albcontrol sha e ushtron aktivitetin e tij në zbatim të Marrëveshjeve Ndërkombëtare të nënshkruar nga Republika e Shqipërisë në fushën e aviacionit civil dhe shërbimit të lundrimit ajror si dhe legjislacionit shqiptar.

Efektet e vendimmarrjes për reduktimin e pagave të shkaktuara nga pandemia covid-19, si dhe përfitimeve të munguara pas përfundimit të kontratës kolektive në Shkurt 2020.

Efektet e disa prej masave të ndërmarra gjatë 2020, reflektohen ende edhe sot në pagat e punëmarrësve të Albcontrol. Efektet e luhatjeve për disa nga pozicionet më të rëndësishme në gjithë divizionet e Albcontrol sha, duke krahasuar pagat bruto 2019/2023. Një tjetër element është edhe efekti në reduktimin e përfitimeve të të gjithë punonjësve si rezultat i mungesës së kontratës kolektive , që është e detyrueshme në industrinë që operojnë.

Krahasimi i kostove të stafit në Albcontrol sha me vendet e rajonit dhe e Evropës.

Nëse analizojmë kostot e stafit në raport me kostot totale në disa nga ANSP-të e rajonit dhe të Europës, do të konstatojmë se jemi i vetmi vend , nga 9 shtete që janë marrë në analizë (ku janë përzgjedhur shtetet e rajonit të ngjashme me ne) dhe rezultoni se përqindja e kostove të stafit zë më pak se 50% të kostove totale vjetore. Kështu kërkojmë që të vijohet me një politikë të përgjithshme të rritjes së pagave në Albcontrol sha dhe synimi është që të jemi sa më konkurrues me tregun lokal, sikurse edhe me rajonin në të njëjtën kohë.

Tregu i punës dhe analiza e kontekstit

Gjatë periudhës Prill 2020- Maj 2023, numri i personave të larguar me dorëheqje nga shoqëria ishte 63 persona, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve ekspertë me eksperiencë në këtë industri. Kosto financiare dhe periudha kohore për përgatitjen, kualifikimin dhe aftësimin e personelit të ri është e lartë nisur nga specifika e shërbimit që ofron shoqëria.

Hapi i parë për rikthimin e pagave në nivelin e para pandemisë gjatë muajit Prill 2022, por pa shtesat apo benefitet që rrjedhin nga kontrata kolektive, nuk e ndaluan këtë fenomen, i cili rrishtet edhe më shumë duke marrë në konsideratë iniciativat e reja të ndërmarra së fundi nga Qeveria Shqiptare e cila po jetëson përmes vendimeve dhe projektligjeve, objektivin për rritjen e pagave mesatare si dhe të rritjes së pagës minimale në rang vendi.

Ky propozim mbështete edhe në performancën pozitive të shoqërisë për 4 mujorin e parë të 2023.

Në vazhdim të analizës së konteksti duhet të merret parasysh edhe niveli i lartë i inflacionit që ka shoqëruar vendin tonë përgjatë viteve të fundit.

Propozim për shkallatoren e re të pagave në Albcontrol sh.a

Rikthimi i pagave në nivelin e para pandemisë, marrja në konsideratë e inflacionit të lartë gjatë kësaj periudhe, si dhe rishikimi i tyre duke i aktualizuar ato me iniciativat e qeverisë për rritjen e pagave aktuale në tërësi. Rritja me 30% e pagave bazë sipas shkallatores në fuqi është e domosdoshme për të motivuar të gjithë punonjësit sidomos në kushtet e trafikut të rritur në vazhdimësi përgjatë periudhës 2022-2023 dhe parashikimeve në vijim, për të evituar largime të tjera të stafit të kualifikuar dhe certifikuar si edhe për të tërhequr specialistë me ekspertizën më të mirë në treg.

4. Titulli i gjetjes: Rritje e pagave në një periudhë jo të mirë financiare të shoqërisë.

Situata: Më datë 09.06.2023 drejtori i përgjithshëm znj. L. O., me anë të relacionit nr. 1261 i është drejtuar Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA, me përmbajtje si më poshtë:

Propozim për shkallatoren e re të pagave në Albcontrol sh.a

Rikthimi i pagave në nivelin e para pandemisë, marrja në konsideratë e inflacionit të lartë gjatë kësaj periudhe, si dhe rishikimi i tyre duke i aktualizuar ato me iniciativat e qeverisë për rritjen e pagave aktuale në tërësi. Rritja me 30% e pagave bazë sipas shkallatores në fuqi është e domosdoshme për të motivuar të gjithë punonjësit sidomos në kushtet e trafikut të rritur në vazhdimësi përgjatë periudhës 2022-2023 dhe parashikimeve në vijim, për të evituar largime të tjera të stafit të kualifikuar dhe certifikuar si edhe për të tërhequr specialistë me ekspertizën më të mirë në treg.

Nisur nga pozicioni jo i mirë financiar i shoqërisë Albcontrol SHA, ku llogaritë e të ardhurave të shoqërisë vijnë të mbeten të bllokuara si dhe janë nënshkruar 5 kontrata huamarrje nga subjektet e tjera, kërkesa për rritje të pagave në nivelin 30% duket e pa arsyetuar, duke marrë në konsideratë edhe nivelin e pagave në rang vendi dhe të pagës mesatare.

Kriteri: Neni 8, Ligji Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

Ndikimi/Efekti: Ndikim në performancën financiare të shoqërisë

Shkaku: Evitimi i largimeve të stafit të kualifikuar dhe tërheqja e specialistëve me ekspertizën më të mirë në treg

Rëndësia: E Lartë

4.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, Këshilli Drejtues, në lidhje me vendimarrjen e tyre për arritjen e objektivave të institucionit, të marrë në konsideratë pozicionin jo të mirë financiarë të shoqërisë. Gjithashtu kjo nismë, në përmbushje të arsyes mbi evitimin e largimeve të stafit të kualifikuar dhe të tërheqjes së specialistëve me ekspertizë, të merret për pozicione të caktuara ku nevojitet stafi i kualifikuar dhe i certifikuar.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Ashtu sikurse kemi shpjeguar edhe në observacionin nr.1229/3 datë 04.04.2024 “Mbi aktkonstatimin nr.3.”, zbatimi i një shkallatores të re të pagave ka ardhur si domosdoshmëri e nevojës së ALBCONTROL SHA për të mbajtur personelin të lidhur me marrëdhënie pune, për shkak se niveli i ulët i pagës ka sjellë si pasojë, largimin e një pjesë të konsiderueshme të punonjësve të kualifikuar. Është pikërisht kualifikimi dhe certifikimi i këtij personeli që e bën shumë të vështirë zëvendësimin e tij me personel të ri të pakualifikuar dhe të pacertifikuar në profilin e aviacionit civil. Kështu, gjatë periudhës Prill 2020-Maj 2023, numri i personelit të larguar me dorëheqje nga shoqëria ishte 63 punonjës, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve ekspertë me

eksperiencë në industrinë e aviacionit civil. Kostoja financiare dhe periudha kohore për përgatitjen, kualifikimin dhe aftësimin e personelit të ri, është e lartë nisur nga specifikat e shërbimit që ofron shoqëria.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, del përsëri me rekomandimin e sipërcituar.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

▪ **Pika 3: Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiare në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij**

Në zbatim të Pikës 3 të Programit të Auditimit nr.1045/1 Prot. datë 29.12.2023, i ndryshuar, *“Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiare në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij”*, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Albcontrol SHA.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Programet e Zhvillimit Ekonomik, planifikimi dhe realizimi i tij;
- Ndryshimet përgjatë periudhës nën auditim të programeve ekonomike;
- Vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës;
- Vendimmarrja e Aksionarit.

Nga auditimi konstatohet:

Shoqëria Albcontrol SHA ushtron veprimtarinë e saj sipas objektit që ka për shërbime të lundrimit ajror, të nevojshme për të garantuar sigurinë, eficientë dhe rregullshmërinë e operimit të avionëve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe më gjerë të publikuar në AIP Albania, në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet e ratifikuara dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror. Projekt programet ekonomik-financiare për vitet 2021, 2022 dhe 2023 të “Albcontrol” SHA janë hartuar mbi bazën e realizimit të treguesve të vitit paraardhës dhe realizimit të pritshëm të vitit aktual, për vitin pasardhës që programohet. Projekt programi i çdo viti është hartuar nga drejtoria e shoqërisë dhe pasi është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, është paraqitur për mendim në MIE e më pas për miratim nga MFE, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në udhëzimin e METE nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” i ndryshuar me udhëzimin e MFE nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, si dhe në ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, Drejtoria e Albcontrol SHA, Këshilli Mbikëqyrës, dhe MIE, kanë ndjekur procedurat normale për hartimin dhe miratimin e programeve të zhvillimit ekonomik-financiar të vitit 2021. Për vitin 2021 nga shoqëria është hartuar programi i zhvillimit ekonomik i cili është miratuar me vendimin nr.8, datë 21.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës. Programi Ekonomik është miratuar nga MFE, me shkresën nr.24199/1, datë 18.01.2021.

Programi ekonomik për vitin 2021 dhe treguesit ekonomik 2021-2023, është hartuar duke u mbështetur në koston bazë të njësisë (Service Unit), ku ky tregues është parashikuar:

-për llogaritjen e të ardhurave nga mbikalimet është 58.79 Euro për çdo “Service Unit”, ose 7,263.5 lekë. Për vitin 2022 kosto është parashikuar 58.63 Euro dhe për vitin 2023 shkon në 57.31 Euro për çdo “Service Unit”.

-për llogaritjen e të ardhurave nga terminali, me parimin e “kostos bazë të njësisë”, për vitin 2021 është 235.67 Euro për çdo “Service Unit”, ose 29,117.59 lekë.

Shoqëria dhe me konfirmimin e EUROCONTROL ka planifikuar rritje të ardhurash krahasuar me vitin 2020, si rezultat i rritjes së trafikut në total në masën 47% për avionët që do të “Mbikalojnë” dhe 62% për avionët që do të “ulen e ngrihen” në Aeroportin “Nënë Tereza”, ku të ardhurat nga mbikalimet janë burimi kryesor, pasi zënë 86% të ardhurave totale të Shoqërisë.

Gjithsesi, realizimi i programit të zhvillimit ekonomiko-financiar, me ndryshime, në mënyrë të përmbledhur, për vitin 2021, paraqitet në vijim. Sipas programit të miratuar, shoqëria Albcontrol SHA dhe trafikut të parashikuar nga Eurocontrol, kishte parashikuar t’u shërbente gjithsej 176,926 avionëve për vitin 2021, ndërkohë që realizimi ishte 153,772 avionë dhe të ardhurat e gjeneruar paraqiten si më poshtë:

(Në 000/lekë)

Nr.	Aktiviteti	Parashikimi 2021	Realizimi 2021	Në % ndaj Planit
1	Ulje – Ngritje	429,534	455,597	106%
2	Mbikalime	2,566,574	2,397,025	93%
3	Nga burime të tjera	52,483	-	0%
4	Rimbursimi TVSH	299,580	216,564	72%
	Totali	3,348,171	3,069,186	92%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës rezulton se, të ardhurat nga “Ulje-Ngritje të avionëve” janë realizuar në masën 106%, ose 26,063 mijë lekë më shumë, ndërkohë që të ardhurat nga “Mbikalimet” janë realizuar në masën 93%, ose 169,549 mijë lekë më pak.

Treguesit ekonomik të vitit 2021, të ardhura dhe shpenzime të balancuara për 3’348’171 mijë lekë si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Njësia Matëse	Programi i vitit 2021
1	Të ardhura gjithsej	000/lekë	3,348,171
2	Shpenzime gjithsej	000/lekë	3,348,171
3	Investime gjithsej	000/lekë	904,019
4	Numri i punonjësve	Numër mesatar	347
5	Paga mesatare	Lekë	169,834
6	Fondi i pagave	000/lekë	766,120

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Gjatë vitit 2021 janë bërë ndryshime në zërat e shpenzimeve, por pa ndryshuar treguesit kryesore ekonomikë, vlerat e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, në dy raste dhe janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Propozimet e Drejtorit të Përgjithshëm që i janë paraqitur e miratuar në Këshillit Mbikëqyrës janë si më poshtë:

- Relacioni nr. 1485/1 i Drejtorit të Përgjithshëm, i datës 19.10.2021, është miratuar me Vendimin nr. 16, datë 20.10.2021 të Këshillit Mbikëqyrës;

Realizimi i treguesve kryesorë për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Njësia Matëse	Programimi	Realizimi	Në %
1	Të ardhura gjithsej	000/lekë	3,348,171	3,069,186	92%
2	Shpenzime gjithsej	000/lekë	3,348,171	2,369,734	71%
3	Investime gjithsej	000/lekë	904,019	192,353	21%
4	Numri i punonjësve	Numër mesatar	347	330	95%
5	Paga mesatare	Lekë	169,834	115,922	68%
6	Fondi i pagave	000/lekë	766,120	459,053	60%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme konstatohet se edhe për këtë vit shoqëria nuk ka realizuar asnjë nga treguesit kryesorë, si të ardhurat ashtu dhe shpenzimet. Kështu të ardhurat janë realizuar në masën 92%, shpenzimet në masën 71% dhe investimet në masën 21%, duke ndikuar në ecurinë financiare të saj.

Shpenzimet. Për realizimin e aktivitetit normal të saj shoqëria në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2021, kishte parashikuar të shpenzonte 3,348,171 mijë lekë. Për këtë vit shpenzimet janë realizuar në shumën 2,369,734 mijë lekë, në masën 71% të programimit, ose për 978,437 mijë lekë më pak kundrejt planifikimit. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesore paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Programi Vjetor	Amendimi	Fakti	Realizimi në %
1	Shlyerje e kësteve të kredisë me Eurocontrol	268,000		268,000	100%
2	Mallra	46,330		30,350	66%
3	Furnitura	319,850		84,229	26%
4	Shërbime gjithsej	415,200	5,000	311,524	74%
5	Pagat e Personelit	766,120		459,053	60%
6	Pagesat e Sigurimeve Shoqërore	79,852		61,313	77%
7	Shpenzime të tjera për Personelin	51,924		1,798	3%
8	Shpenzime për ekspert kontabël e vlerësues	9,000		9,000	100%
9	Tatim Taksa	9,500		7,205	76%
10	Shpenzime të tjera rrjedhëse	143,400	(5,000)	54,831	40%
11	Amortizimi i pajisjeve	793,074		780,574	98%
12	Specializime trajnime Personeli	5,200		1,374	26%
13	Trajnime të Stafit kontrollor+teknik	123,390		54,826	44%
14	Shpenzime financiare	7,000		3,862	55%
15	Shpenzime të jashtëzakonshme	300		-	0%
16	Pagesa për "Koston" e "Licencim" nga AAC	131,300		110,445	84%
17	Kuota e Anëtarimit në EUROCONTROL	159,942		128,235	80%
18	Pagesa e Anëtarimit në CANSO	3,630		3,115	86%
19	Pagesa për koston e shërbimit SAR	15,159		-	0%
	Shpenzime gjithsej	3,348,171		2,369,734	71%

Duke analizuar mos realizimin në disa nga zërat e shpenzimeve të programuara konstatohet se: **Zëri "Mallra"** që përfshin nënzërat, (karburante, mallra konsumi, veshje e uniforma, materiale të tjera, etj.) është realizuar në masën 66%, ose nga 46,330 mijë të programuara janë realizuar në shumën 30,350 mijë lekë, ose më pak 15,980 mijë lekë.

Zëri "Furnitura" është realizuar në masën 26%, nga 319,850 mijë lekë të programuara për janë shpenzuar 84,229 mijë lekë, ose 235,621 lekë më pak.

Zëri “Shërbime gjithsej” është realizuar në masën 74%, ose nga 415,200 mijë lekë të programuara janë shpenzuar 311,524 mijë lekë, ose më pak 103,676 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve (EAD,DVOR, ILS, DME, mirëmbajtje Remote Surface Management,mirëmbajtje e sistemit VCS GAREX), etj.

Zëri “Shpenzime të tjera rrjedhëse” është realizuar në masën 40%, ose nga 143,400 mijë lekë të programuara janë shpenzuar 54,831 mijë lekë, ose më pak 88,569 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen nënzërat: “pritje-përcjellje”, “shpenzime për kontrollin mjekësor”, “shpenzime për marrje konsulence”, “shpenzime të ndryshme si përkthime, bërje manuale, revista vjetore”, “projekti i certifikimit të Albcontrol”, “shpenzime për të përndjekurit politikë”, etj.

Zëri “Shpenzime financiare” është realizuar në masën 55%, ose nga 7,000 mijë lekë të programuara, janë shpenzuar 3,862 mijë lekë, ose më pak 3,138 mijë lekë.

Investimet. Sipas programit ekonomik “Albcontrol” SHA shpenzimet për investime ishin parashikuar në shumën 904,019 mijë lekë, ndërsa realizimi i investimeve sipas strukturës, paraqitet si më poshtë:

(Në 000/lekë)

Nr.	Emërtimi	Programi Vjetor	Fakti	Realizimi në %
1	Ndërtime-Montime	49,650	-	0%
2	Makineri e Pajisje	511,629	101,995	20%
3	Pajisje dhe Orendi	16,900	-	0%
4	Studime e Projektme	23,700	-	0%
5	Mirëmbajtje e aparaturave me P/N	273,640	90,358	33%
6	Projekte/pagesa viti kaluar	28,500	-	0%
	Investime gjithsej	904,019	192,353	21%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme investimet janë realizuar në masën 21%, nga 904,019 mijë lekë që ishin planifikuar janë realizuar në shumën 192,353 mijë lekë, ose me një mosrealizim prej 711,666 mijë lekë më pak.

Zërat “Ndërtime-Montime”, “Studime dhe Projektme”, “Pajisje dhe Orendi”, “Projekte/pagesa viti kaluar” janë realizuar në masën 0% kundrejt programimit, ose në shumën 0 lekë.

Zëri “Makineri Pajisje” është realizuar në masën 20% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 409,634 mijë lekë.

Zëri “Mirëmbajtje e aparaturave me P/N” është realizuar në masën 33% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 183,282 mijë lekë.

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, Drejtoria e Albcontrol SHA, Këshilli Mbikëqyrës, dhe MIE, kanë ndjekur procedurat normale për hartimin dhe miratimin e programeve të zhvillimit ekonomik-financiar të vitit 2022. Për vitin 2022 nga shoqëria është hartuar programi i zhvillimit ekonomik i cili është miratuar me vendimin nr.17, datë 17.12.2021 të Këshillit Mbikëqyrës. Programi Ekonomik është miratuar nga MFE, me shkresën nr.23593/1, datë 31.01.2022.

Programi ekonomik për vitin 2022 dhe treguesit ekonomik 2022-2024, është hartuar duke u mbështetur në koston bazë të njësisë (Service Unit), ku ky tregues është parashikuar:

-për llogaritjen e të ardhurave nga mbikalimet është 55.81 Euro për çdo “Service Unit”, ose 6,767 lekë. Për vitin 2023 kosto është parashikuar 53.325 Euro dhe për vitin 2024 kjo kosto parashikohet 51.28 Euro për çdo “Service Unit”.

-për llogaritjen e të ardhurave nga terminali është 229.48 Euro për çdo “Service Unit”, ose 27,823.17 lekë.

Shoqëria dhe me konfirmimin e EUROCONTROL ka planifikuar rritje të ardhurash krahasuar me vitin 2021, si rezultat i rritjes së trafikut në total në masën 47% për avionët që do të “Mbikalojnë” dhe 62% për avionët që do të “ulen e ngrihen” në Aeroportin “Nënë Tereza”, ku të ardhurat nga mbikalimet janë burimi kryesor, pasi zënë 81% të të ardhurave gjithsej të shoqërisë. Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë janë paraqitur të balancuara në shumën 3,819,583 mijë lekë.

Nr.	EMERTIMI	Njësia Matëse	Programimi
1	Të ardhura gjithsej	000/lekë	3,891,187
2	Shpenzime gjithsej	000/lekë	3,891,187
3	Investime gjithsej	000/lekë	1,664,360
4	Numri i punonjësve	Numër mesatar	338
5	Paga mesatare	Lekë	226,969
6	Fondi i pagave	000/lekë	997,300

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Sipas shkresës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë Nr.23593/1 Prot, datë 31.01.2022, për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik për vitin 2022 të Shoqërisë “Albcontrol Sha”, një ndër treguesit kryesorë të zhvillimit ekonomik “Investimet gjithsej” ka një mospërputhje midis vlerës së miratuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë (1,664,360 mijë lekë) me vlerën tek Projekt Programi i Zhvillimit Ekonomik Viti 2022 i Shoqërisë “Albcontrol Sha” (1,642,490 mijë lekë) me një diferencë prej 21,870 mijë lekë.

Gjatë vitit 2022 shoqëria Albcontrol Sha për të siguruar vazhdimësinë e biznesit dhe për të menaxhuar situatën e mungesës së plotë të likuiditetit ka marrë hua përkatësisht nga Autoriteti Portual Durrës në vlerën 615,000 mijë lekë, miratuar me Vendimin nr.6, datë 23/02/2022 të Këshillit Mbikëqyrës. Me këtë miratim, në tabelën e Programit të Zhvillimit Ekonomik në Seksionin IV/TREGUESIT FINANCIAR është shtuar ndarja me titull – “Kreditimi nga huaja e Autoritetit Portual Durrës” si dhe tek zëri “Shpenzime Gjithsej” është shtuar nëndarja “Shlyerja e huasë së marrë nga APD”. Gjithashtu huaja solli rrjedhimisht nevojën për përmbushjen e detyrimeve të kërkuara nga APD, si interesa të humbura nga prishja e depozitave përpara afatit të përcaktuar sipas kushteve të specifikuara në kontratë. Përmbushja e këtyre detyrimeve ka sjellë dhe nevojën për amendimin e zërave në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2022. Në total shtesa e kërkuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime Financiar/Shpenzime të Marrëveshjes mbi marrjen e huasë financiare nga APD” është 3,457,000 lekë, vlerë e cila është programuar të mbulohet nga zbritja e nen zërit “Amortizim”, sipas pasqyrës që i është bashkëlidhur relacionit për ndryshim të programit.

Kjo hua është shlyer në shumën 593,314 mijë lekë ose në masën 96%.

Nga DPSHTRR në vlerën 421,200 mijë lekë, miratuar me Vendimin nr.18, datë 13/10/2022 të Këshillit Mbikëqyrës. Me këtë miratim, në tabelën e Programit të Zhvillimit Ekonomik në Seksionin IV/TREGUESIT FINANCIAR është shtuar ndarja me titull – “Kreditimi nga huaja e DPSHTRR” si dhe tek zëri “Shpenzime Gjithsej” është shtuar nëndarja “Shlyerja e huasë së

marrë nga DPSHTRR”. Gjithashtu huaja solli rrjedhimisht nevojën për përmbushjen e detyrimeve të kërkuara nga DPSHTRR, si komisioni, interesat e overdraftit sipas kontratës së lidhur për marrjen e overdraftit të nënshkruar ndërmjet DPSHTRR dhe CREDINS BANK datë 05.08.2022. Përmbushja e këtyre detyrimeve ka sjellë dhe nevojën për amendimin e zërave në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2022 dhe 2023. Në total shtesa e kërkuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime Financiar/Shpenzime të Marrëveshjes mbi marrjen e huasë financiare nga DPSHTRR” është 9,604,000 lekë, vlerë e cila është programuar të mbulohet nga zbritja e nen zërit “Amortizim”, sipas pasqyrës që i është bashkëlidhur relacionit për ndryshim të programit. Kjo hua, sipas Programit të Zhvillimit Ekonomik të vitit 2022 i ndryshuar, pritet të shlyhet në vitin 2023.

Nga Autoriteti i Aviacionit Civil një ndihmë financiare në vlerën 2,000,000,000 (dy miliard) lekë, miratuar me Vendimin nr.25, datë 28/12/2022 të Këshillit Mbikëqyrës, për arsye të mungesës së likuiditetit si pasojë e bllokimit të fondeve nga një Urdhër Ekzekutimi i Gjykatës Belge. Me këtë miratim, në tabelën e Programit të Zhvillimit Ekonomik në Seksionin IV/TREGUESIT FINANCIAR është shtuar ndarja me titull – “Mbështetje Financiare AAC” si dhe tek zëri “Shpenzime Gjithsej” është shtuar nëndarja “Shlyerja e mbështetjes financiare AAC”.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë bërë ndryshime në zërat e shpenzimeve, por pa ndryshuar treguesit kryesore ekonomike, në tre raste dhe janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Propozimet e Drejtorit të Përgjithshëm që i janë paraqitur e miratuar në Këshillit Mbikëqyrës janë si më poshtë:

- Relacioni nr. 529 i Drejtorit të Përgjithshëm, i datës 21.02.2022, është miratuar me Vendimin nr. 6, të Këshillit Mbikëqyrës, më datë 23.02.2022;
- Relacioni nr. 2402 i Drejtorit të Përgjithshëm, i datës 28.09.2022, është miratuar me Vendimin nr. 18, të Këshillit Mbikëqyrës, më datë 13.10.2022;
- Relacioni nr. 3064, i Drejtorit të Përgjithshëm i datës 27.12.2022, është miratuar me Vendimin nr. 25, të Këshillit Mbikëqyrës, më datë 28.12.2022;

Realizimi i treguesve kryesorë për vitin 2022 paraqitet si më poshtë :

Nr.	EMERTIMI	Njësia Matëse	Programimi	Realizimi	Në %
1	Të ardhura gjithsej	000/lekë	3,891,187	4,364,239	112%
2	Shpenzime gjithsej	000/lekë	3,891,187	2,516,327	65%
3	Investime gjithsej	000/lekë	1,642,490	97,311	6%
4	Numri i punonjësve	Numër mesatar	338	330	98%
5	Paga mesatare	Lekë	226,969	171,942	76%
6	Fondi i pagave	000/lekë	997,300	680,892	68%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme konstatohet se edhe për këtë vit nga treguesit kryesorë, shoqëria ka realizuar vetëm të ardhurat ndërsa treguesit e tjerë mbeten të pa realizuar. Kështu të ardhurat janë realizuar në masën 112%, shpenzimet në masën 65% dhe investimet në masën 6%, duke ndikuar në ecurinë financiare të saj.

Realizimi i volumit të punës kundrejt programimit për vitin 2022, paraqitet si më poshtë:

Në numër

Nr.	Aktiviteti	Parashikimi 2022	Realizimi 2022	Në % ndaj Planit
1	Nr. Avionëve të shërbyer	202,000	251,244	124%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Si rezultat i përmirësimit të situatës pas një periudhe të gjatë krize të COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021 më të gjitha efektet që ajo solli në industrinë e aviacionit, në vitin 2022 u është shërbyer 49,244 avionëve më shumë se programimi i miratuar nga EUROCONTROL.

Të ardhurat nga aktiviteti kryesor i shoqërisë paraqiten si më poshtë :

Në 000/lekë

Nr.	Aktiviteti	Parashikimi 2022	Realizimi 2022	Në % ndaj Planit
1	Ulje – Ngritje	456,480	664,970	146%
2	Mbikalime	3,164,592	3,588,806	113%
	Totali	3,621,072	4,253,776	117%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës rezulton se, të ardhurat nga “Ulje-Ngritje të avionëve” janë realizuar në masën 146%, ose 208,490 mijë lekë më shumë, të ardhurat nga “Mbikalimet” janë realizuar në masën 113%, ose 424,214 mijë lekë më shumë dhe në total ka një realizim të të ardhurave mbi programimin prej 632,704 mijë lekë.

Shpenzimet. Për realizimin e aktivitetit normal të saj shoqëria në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2022, kishte parashikuar të shpenzonte 3,891,187 mijë lekë. Për këtë vit shpenzimet janë realizuar në shumën 2,516,327 mijë lekë, në masën 65% të programimit, ose për 1,374,860 mijë lekë më pak kundrejt planifikimit. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesore paraqitet si më poshtë:

(Në 000/lekë)

Nr.	Emërtimi	Programi Vjetor	Amendimi	Fakti	Realizimi në %
1	Shlyerje e kësteve të kredisë me Eurocontrol	71,604		71,604	100%
2	Mallra	53,070		21,839	41%
3	Furnitura	361,600		131,532	36%
4	Shërbime gjithsej	609,755		289,463	47%
5	Pagat e Personelit	997,300		680,892	68%
6	Pagesat e Sigurimeve Shoqërore	92,740		78,398	85%
7	Shpenzime të tjera për Personelin	144,980		84,268	58%
8	Shpenzime për ekspert kontabël e vlerësues	9,000		8,400	93%
9	Tatim Taksa	9,300		375	4%
10	Shpenzime të tjera rrjedhëse	135,500		39,173	29%
11	Amortizimi i pajisjeve	941,836	(13,061)	757,406	82%
12	Specializime trajnime Personeli	7,750		1,501	19%
13	Trajnime të Stafit kontrollor+teknik	189,400		113,348	60%
14	Shpenzime financiare	2,780	13,061	270	2%
15	Shpenzime të jashtëzakonshme	300		-	0%
16	Pagesa për "Koston" e "Licencim" nga AAC	143,300		143,070	100%
17	Kuota e Anëtarimit në EUROCONTROL	97,572		91,688	94%
18	Pagesa e Anëtarimit në CANSO	3,800		3,100	82%
19	Pagesa për koston e shërbimit SAR	19,600		-	0%

	Shpenzime gjithsej	3,891,187	2,516,327	65%
--	---------------------------	------------------	------------------	------------

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Duke analizuar mos realizimin në disa nga zërat e shpenzimeve të programuara konstatohet se: **Zëri “Mallra”** që përfshin nënzërat, (karburante, mallra konsumi, veshje e uniforma, materiale të tjera, etj.) është realizuar në masën 41%, ose nga 53,070 mijë të programuara janë realizuar në shumën 21,839 mijë lekë, ose më pak 31,231 mijë lekë.

Zëri “Furnitura” është realizuar në masën 36%, nga 361,600 mijë lekë të programuara për janë shpenzuar 131,532 mijë lekë, ose 230,068 lekë më pak.

Zëri “Shërbime gjithsej” është realizuar në masën 47%, ose nga 609,755 mijë lekë të programuara janë shpenzuar 289,463 mijë lekë, ose më pak 320,292 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve (MWL,EAD,DVOR, ILS, DME, mirëmbajtje Remote Surfice Management,mirëmbajtje e sistemit VCS GAREX), etj.

Zëri “Shpenzime të tjera rrjedhëse” është realizuar në masën 29%, ose nga 135,500 mijë lekë të programuara janë shpenzuar 39,173 mijë lekë, ose më pak 96,327 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen nënzërat: “pritje-përcjellje”, “shpenzime për kontrollin mjekësor”, “shpenzime për marrje konsulence”, “shpenzime të ndryshme si përkthime, bërje manuale, revista vjetore”, “projekti i certifikimit të Albcontrol”, “shpenzime për të përndjekurit politikë”, etj.

Zëri “Shpenzime financiare” është realizuar në masën 2%, ose nga 15,841 mijë lekë të programuara, janë shpenzuar 270 mijë lekë, ose më pak 15,571 mijë lekë. Në këtë zë ka pasur dhe një shtesë në vlerën 13,061 mijë lekë, për arsye të huave të marra gjatë vitit 2022.

Investimet. Sipas programit ekonomik “Albcontrol” SHA shpenzimet për investime ishin parashikuar në shumën 1,642,490 mijë lekë, ndërsa realizimi i investimeve sipas strukturës, paraqitet si më poshtë:

(Në 000/lekë)				
Nr.	Emërtimi	Programi Vjetor	Fakti	Realizimi në %
1	Ndërtim-Montime	156,850	-	0%
2	Makineri e Pajisje	881,900	10,814	1%
3	Pajisje dhe Orendi	41,800	2,442	6%
4	Studime e Projekttime	183,700	-	0%
5	Mirëmbajtje e aparaturave me P/N	262,240	44,250	17%
6	Projekte/pagesa viti kaluar	116,000	39,805	34%
	Investime gjithsej	1,642,490	97,311	6%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme investimet janë realizuar në masën 6%, nga 1,642,490 mijë lekë që ishin planifikuar janë realizuar në shumën 97,311 mijë lekë, ose me një mosrealizim prej 1,545,179 mijë lekë më pak.

Zërat “Ndërtim-Montime”, “Studime dhe Projekttime”, janë realizuar në masën 0% kundrejt programimit, ose në shumën 0 lekë.

Zëri “Makineri Pajisje” është realizuar në masën 1% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 871,086 mijë lekë.

Zëri “Pajisje dhe Orendi” është realizuar në masën 6% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 39,358 mijë lekë.

Zëri “Mirëmbajtje e aparaturave me P/N” është realizuar në masën 17% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 217,990 mijë lekë.

Zëri “Projekte/pagesa viti kaluar” është realizuar në masën 34% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 76,195 mijë lekë.

Gjatë këtij viti shoqëria Albcontrol SHA ka vazhduar të punojë në sajë të huave të marra nga APD dhe DPSHTRR, si dhe nga mbështetja financiare e AAC.

Për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, Drejtoria e Albcontrol SHA, Këshilli Mbikëqyrës, dhe MIE, kanë ndjekur procedurat normale për hartimin dhe miratimin e programeve të zhvillimit ekonomik-financiar të vitit 2023. Për vitin 2023 nga shoqëria është hartuar programi i zhvillimit ekonomik i cili është miratuar me vendimin nr.22, datë 15.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës. Programi Ekonomik është miratuar nga MFE, me shkresën nr.23928/1, datë 30.01.2023.

Programi ekonomik për vitin 2023 dhe treguesit ekonomik 2023-2025, është hartuar duke u mbështetur në koston bazë të njësisë (Service Unit), ku ky tregues është parashikuar:

-për llogaritjen e të ardhurave nga mbikalimet është 50.27 Euro për çdo “Service Unit”, ose 5,853 lekë. Për vitin 2024 kosto është parashikuar 48.22 Euro dhe për vitin 2022 kjo kosto parashikohet 47.61 Euro për çdo “Service Unit”.

- për llogaritjen e të ardhurave nga terminali është 219.45 Euro për çdo “Service Unit”, ose 25,552.14 lekë.

Shoqëria dhe me konfirmimin e EUROCONTROL ka planifikuar rritje të ardhurash krahasuar me vitin 2022, si rezultat i rritjes së trafikut në total në masën 7.2% për avionët që do të “Mbikalojnë” dhe 29.8% për avionët që do të “ulen e ngrihen” në Aeroportin “Nënë Tereza”, ku të ardhurat nga mbikalimet janë burimi kryesor, pasi zënë 81% të të ardhurave gjithsej të shoqërisë.

Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë janë paraqitur të balancuara në shumën 4,279,900 mijë lekë.

Nr.	EMERTIMI	Njësia Matëse	Programimi
1	Të ardhura gjithsej	000/lekë	4,279,900
2	Shpenzime gjithsej	000/lekë	4,279,900
3	Investime gjithsej	000/lekë	1,516,000
4	Numri i punonjësve	Numër mesatar	333
5	Paga mesatare	Lekë	222,869
6	Fondi i pagave	000/lekë	964,800

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Gjatë vitit 2023 janë bërë ndryshime në zërat e shpenzimeve dhe investimeve, por pa ndryshuar treguesit kryesore ekonomike, vlerat e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, në dy raste dhe janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Propozimet e Drejtorit të Përgjithshëm që i janë paraqitur e miratuar në Këshillit Mbikëqyrës janë si më poshtë:

- Relacioni nr. 2262 i Drejtorit të Përgjithshëm, i datës 18.10.2023, është miratuar me Vendimin nr. 9, datë 20.10.2023 të Këshillit Mbikëqyrës;

Në këtë vendim shoqëria ka ndryshuar zërat brenda zërave kryesorë, përkatësisht në zërin “Shpenzime gjithsej” është shtuar nën zëri “Shpenzime për Sigurinë Private” me vlerën 2,600 mijë lekë, që është programuar të mbulohet nga nën zëri “Amortizimi” sipas pasqyrës bashkëlidhur në relacion.

Në zërin “Investimet gjithsej” është shtuar nën zëri “Blerje e pajisjeve që mundësojnë transferimin e sistemeve operacionale dhe të dhënave meteorologjike nga zyra METEO ekzistuese në aeroport, në zyrën e re në godinë operacionale si dhe shtimin e posteve të reja të punës për akomodimin e këtyre sistemeve” me vlerën 10,500 mijë lekë. Ky nënzë është programuar të mbulohet nga nën zëri “Rinovim i sistemit të kondicionimit të administratës” në vlerën 4,900 mijë lekë dhe nën zëri “Blerje dhe instalim i sistemit të kamerave në pistë për përmbushjen e MWO Observing data në vlerën 5,600 mijë lekë sipas pasqyrës bashkëlidhur në relacion.

· Relacioni nr. 2648 i Drejtorit të Përgjithshëm, i datës 06.12.2023, është miratuar me Vendimin nr. 15, datë 14.12.2023 të Këshillit Mbikëqyrës;

Me arsyetimin e mungesës së plotë të likuiditetit në vitin 2023 është marrë me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.15, datë 14.12.2023 huaja nga Korporata Shqiptare e Investimeve Sha, për të financuar nevojat e shoqërisë, brenda buxheteve të miratuara nga organet vendimmarrëse të shoqërisë. Me këtë miratim, në tabelën e Programit të Zhvillimit Ekonomik në Seksionin IV/TREGUESIT FINANCIAR është shtuar ndarja me titull – “Hua nga Korporata e Investimeve Shqiptare SHA” si dhe tek zëri “Shpenzime Gjithsej” është shtuar nëndarja “Shlyerja e huasë së marrë nga Korporata e Investimeve Shqiptare SHA”. Shpenzimet për interesat e kësaj huaje të përlllogaritur në vlerën 60,000 mijë lekë, do të reflektohen në Programin e Zhvillimit Ekonomik të vitit pasardhës.

Realizimi i treguesve kryesorë për vitin 2023 paraqitet si më poshtë :

Nr.	EMERTIMI	Njësia Matëse	Programimi	Realizimi	Në %
1	Të ardhura gjithsej	000/lekë	4,279,900	4,536,643	106%
2	Shpenzime gjithsej	000/lekë	4,279,900	2,777,395	65%
3	Investime gjithsej	000/lekë	1,516,000	286,698	19%
4	Numri i punonjësve	Numër mesatar	333	363	109%
5	Paga mesatare	Lekë	222,869	172,952	78%
6	Fondi i pagave	000/lekë	964,800	753,377	78%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme konstatohet se edhe për këtë vit nga treguesit kryesorë, shoqëria ka realizuar zërin e të ardhurave në masën 106% dhe numrin e punonjësve në masën 109%, ndërsa treguesit e tjerë mbeten të pa realizuar. Kështu shpenzimet janë realizuar në masën 65% dhe investimet në masën 19%, duke ndikuar në ecurinë financiare të saj.

Realizimi i volumit të punës kundrejt programimit për vitin 2023, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Aktiviteti	Parashikimi 2023	Realizimi 2023	Në % ndaj Planit
1	Nr. Avionëve të shërbyer	256,000	304,223	119%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Në vitin 2023 u është shërbyer 48,223 avionëve ose 119% më shumë se programimi i miratuar nga EUROCONTROL.

Të ardhurat nga aktiviteti kryesor i shoqërisë paraqiten si më poshtë :

Në 000/lekë

Nr.	Aktiviteti	Parashikimi 2023	Realizimi 2023	Në % ndaj Planit
1	Nga ulje ngritjet Aeroporti "Nënë Tereza"	806,769	781,690	97%
2	Nga avionët që mbikalojnë	3,383,145	3,685,328	109%
3	Nga burime të tjera (këmbimi valutor,interesa etj)	30,000	-	0%
4	Nga burimi rimbursimit të TVSH	59,986	69,625	116%
	Totali	4,279,900	4,536,643	106%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës rezulton se, të ardhurat nga “Ulje-Ngritje të avionëve” janë realizuar në masën 97%, ose 25,079 mijë lekë më pak, të ardhurat nga “Mbikalimet” janë realizuar në masën 109%, ose 302,183 mijë lekë më shumë dhe në total ka një realizim të ardhurave mbi programimin prej 256,743 mijë lekë.

Shpenzimet. Për realizimin e aktivitetit normal të saj shoqëria në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2023, kishte parashikuar të shpenzonte 4,279,900 mijë lekë. Për këtë vit shpenzimet janë realizuar në shumën 2,777,395 mijë lekë, në masën 65% të programimit, ose për 1,502,505 mijë lekë më pak kundrejt planifikimit. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesore paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Programi Vjetor	Amendimi	Fakti	Realizimi në %
1	Mallra	64,720		26,871	42%
2	Furnitura	431,700		156,666	36%
3	Shërbime gjithsej	614,690	2,600	276,585	45%
4	Pagat e Personelit	964,800		753,377	78%
5	Pagesat e Sigurimeve Shoqërore	93,780		91,268	97%
6	Shpenzime të tjera për Personelin	212,943		79,323	37%
7	Shpenzime për ekspert kontabël e vlerësues	9,000		7,858	87%
8	Tatim Taksa	9,300		6,338	68%
9	Shpenzime të tjera rrjedhëse	137,300		44,153	32%
10	Amortizimi i pajisjeve	935,154	(2,600)	932,554	100%
11	Specializime trajnime Personeli	9,500		1,672	18%
12	Trajnime të Stafit kontrollor+teknik	412,600		99,298	24%
13	Shpenzime financiare	39,500		-	0%
14	Shpenzime të jashtëzakonshme	300		-	0%
15	Pagesa për "Koston' e "Licencim" nga AAC	197,300		196,751	100%
16	Kuota e Anëtarimit në EUROCONTROL	116,667		102,015	87%
17	Pagesa e Anëtarimit në CANSO	3,800		2,666	70%
18	Pagesa për koston e shërbimit SAR	26,846		-	0%
	Shpenzime gjithsej	4,279,900	-	2,777,395	65%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Duke analizuar mos realizimin në disa nga zërat e shpenzimeve të programuara konstatohet se: **Zëri “Mallra”** që përfshin nënzërat, (karburante, mallra konsumi, veshje e uniforma, materiale të tjera, etj.) është realizuar në masën 42%, ose nga 64,720 mijë të programuara janë realizuar në shumën 26,871 mijë lekë, ose më pak 37,849 mijë lekë.

Zëri “Furnitura” është realizuar në masën 36%, nga 431,700 mijë lekë të programuara për janë shpenzuar 156,666 mijë lekë, ose 275,034 lekë më pak.

Zëri “Shërbime gjithsej” është realizuar në masën 45%, ose nga 617,290 mijë lekë të programuara janë shpenzuar 276,585 mijë lekë, ose më pak 338,105 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve (MWL,EAD,DVOR, ILS, DME, mirëmbajtje Remote Surface Management,mirëmbajtje e sistemit VCS GAREX), etj.

Zëri “Shpenzime të tjera rrjedhëse” është realizuar në masën 32%, ose nga 137,300 mijë lekë të programuara janë shpenzuar 44,153 mijë lekë, ose më pak 93,147 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen nënzërat: “pritje-përcjellje”, “shpenzime për kontrollin mjekësor”, “shpenzime për marrje konsulence”, “shpenzime të ndryshme si përkthime, bërje manuale, revista vjetore”, “projekti i certifikimit të Albcontrol”, “shpenzime për të përndjekurit politikë”, etj.

Zëri “Shpenzime financiare” është realizuar në masën 0%, ose nga 39,500 mijë lekë të programuara, janë shpenzuar 0 lekë.

Investimet. Sipas programit ekonomik “Albcontrol” SHA shpenzimet për investime ishin parashikuar në shumën 1,642,490 mijë lekë, ndërsa realizimi i investimeve sipas strukturës, paraqitet si më poshtë:

(Në 000/lekë)

Nr.	Emërtimi	Programi Vjetor	Amendimi	Realizimi	Realizimi në %
1	Ndërtime-Montime	132,000	10,500	-	0%
2	Makineri e Pajisje	800,850	(4,900)	223,566	28%
3	Pajisje dhe Orendi	28,200	-	-	0%
4	Studime e Projektme	140,800	-	-	0%
5	Mirëmbajtje e aparaturave me P/N	356,650	(5,600)	40,100	11%
6	Projekte/pagesa viti kaluar	57,500	-	23,032	40%
	Investime gjithsej	1,516,000	-	286,698	19%

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme investimet janë realizuar në masën 19%, nga 1,516,000 mijë lekë që ishin planifikuar janë realizuar në shumën 286,698 mijë lekë, ose me një mosrealizim prej 1,229,302 mijë lekë më pak.

Zërat “Ndërtime-Montime”, “Studime dhe Projektme”, “Pajisje dhe Orendi” janë realizuar në masën 0% kundrejt programimit, ose në shumën 0 lekë.

Zëri “Makineri Pajisje” është realizuar në masën 28% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 572,384mijë lekë.

Zëri “Mirëmbajtje e aparaturave me P/N” është realizuar në masën 11% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 310,950 mijë lekë.

Zëri “Projekte/pagesa viti kaluar” është realizuar në masën 40% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 34,468 mijë lekë.

5.Titulli i gjetjes: Planifikimi jo i duhur i Programit te Zhvillimit Ekonomik

Situata: Nga realizimi i treguesve kryesorë për vitin 2021 konstatohet se për këtë vit shoqëria nuk ka realizuar asnjë nga treguesit kryesorë, si të ardhurat ashtu dhe shpenzimet. Të ardhurat janë realizuar në masën 92%, shpenzimet në masën 71% dhe investimet në masën 21%.

Nga realizimi i treguesve kryesorë për vitin 2022 konstatohet se për vitin 2022 nga treguesit kryesorë, shoqëria ka realizuar vetëm të ardhurat ndërsa treguesit e tjerë mbeten të pa realizuar. Kështu Të ardhurat janë realizuar në masën 112%, shpenzimet në masën 65% dhe investimet në masën 6%.

Nga realizimi i treguesve kryesorë për vitin 2023 konstatohet se për këtë vit nga treguesit kryesorë, shoqëria ka realizuar zërin e të ardhurave në masën 106% dhe numrin e punonjësve në masën 109%, ndërsa treguesit e tjerë mbeten të pa realizuar. Kështu shpenzimet janë realizuar në masën 65% dhe investimet në masën 19%. Realizimi i investimeve për të tre vitet me vlera të ulëta, është një tregues negativ në realizimin e atyre objektivave të cilat lidhen me investimet e pa realizuara, si dhe tregues që evidenton mangësi në planifikim dhe realizim të buxhetit për shpenzimet.

Kriteri: Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë.

Ndikimi/Efekti: Mos realizimi i objektivave dhe ndikim në performancën financiare të shoqërisë

Shkaku: Planifikim jo i saktë i programit ekonomik nga strukturat përgjegjëse të shoqërisë

Rëndësia: E lartë

5.1 Rekomandimi: Titullari i shoqërisë të marrë masa që gjatë procesit të hartimit të programit ekonomik, të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme, të kryejë një planifikim të saktë dhe të detajuar, duke u bazuar dhe në realizimin e zërave të buxhetit në vitet paraardhëse dhe në planifikimet e marra nga Eurocontrol.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Shoqëria ALBCONTROL SHA e ushtron aktivitetin e saj ekonomik në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, në fushën e aviacionit civil dhe të shërbimit të lundrimit ajror, siç janë: a. “Konventa e Çikagos dhe anekset e saj” e miratuar me Dekret Nr.7438, datë 1.12.1990, e cila e obligon Republikën e Shqipërisë në zbatimin e Rregulloreve të miratuara nga Organizata e ICAO-s, si dokumenti Nr.9082 “Për politikën e ICAO-s mbi Programin Ekonomik” si dhe dokumenti Nr. 9161 “Manuali Ekonomik për ANS”; b. Marrëveshja Multilaterale e nënshkruar në Bruksel më 1 Prill 2002 me Organizatën Europiane të Sigurisë në shërbimin e lundrimit ajror “EUROCONTROL” dhe rregulloreve të miratuara në zbatimin e kësaj Marrëveshje si, “Parimet për përcaktimin e kostos bazë për tarifën në rrugëkalimet (en-route) dhe llogaritjen e kostos për njësi” dok. Nr. 20.60.01 datë 01.01.20 i EUROCONTROL. Aderimi në këtë marrëveshje është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr. 8821, datë 15 Tetor 2001, ku parashikohet ndër të tjera edhe aderimi në Marrëveshjen Shumëpalëshe të 12 shkurtit të 1981 dhe në Protokollin që konsolidon Konventën Ndërkombëtare të EUROCONTROL-it.....

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, del përsëri me rekomandimin e sipërcituar.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

6.Titulli i gjetjes: Planifikimi jo i duhur i Programit të Zhvillimit Ekonomik duke mos marrë në konsideratë situatën në të cilën ndodhet institucioni.

Situata: Gjatë viteve 2021-2023, shoqëria ka marrë hua nga Autoriteti Portual Durrës, DPSHTRR, Autoriteti i Aviacionit Civil, Korporata e Investimeve Shqiptare SHA dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për arsye të mungesës së likuiditetit si pasojë e bllokimit të fondeve nga një Urdhër Ekzekutimi i Gjykatës Belge.

Albcontrol SHA nuk ka përfshirë në Programin e Zhvillimit Ekonomik 2021-2023 asnjë zë për këto hua, por ka bërë ndryshime në zërat përkatës gjatë vitit sipas relacioneve nga Drejtori i Përgjithshëm.

Kriteri: Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Udhëzimi nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë.

Ndikimi/Efekti: Mos marrja në konsideratë e bllokimit të llogarive të të ardhurave sjell rritje të riskut për realizimin e objektivave kryesorë të shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Shkaku: Mos vlerësimi si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E lartë

6.1 Rekomandimi: Titullari i shoqërisë të marrë masa që gjatë procesit të hartimit të programit ekonomik, të të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme, të analizojë me kujdes situatën e institucionit, duke marrë në konsideratë bllokimin e llogarive të të ardhurave.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Gjatë viteve 2021-2023, planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në Programet e Zhvillimit Ekonomik të secilit vit, është bazuar në rregulloren ekonomike të EUROCONTROL, “Parimet për përcaktimin e kostos bazë për tarifën në rrugëkalimet (en- route) dhe llogaritjen e kostos për njësi”, e detyrueshme për zbatim nga të gjitha shtetet anëtare. Bazuar në këto planifikime të miratuara në EUROCONTROL, aktiviteti i shërbimeve të lundrimit ajror do të gjeneronte burime të mjaftueshme financiare për të mbështetur të gjitha aktivitetet e planifikuara për t’u zhvilluar përgjatë secilit vit ushtrimor

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, del përsëri me rekomandimin e sipërcituar.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

- **Pika 4: Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat dhe shpërblimet e punonjësve. Zbatimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin. Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës dhe efektet financiare të rrjedhura prej tyre.**

Në zbatim të Pikës 5 të Programit të Auditimit nr.1045/1 Prot. datë 29.12.2023, i ndryshuar, “Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat dhe shpërblimet e punonjësve. Zbatimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin. Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës dhe efektet financiare të rrjedhura prej tyre.”, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Albcontrol SHA.

Nga grupi i auditimit u verifikuan:

Struktura organizative

Dosjet e personelit

Rregullorja për përcaktimin e kriteve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës

Kontrata kolektive dhe ato individuale të punës

Procedurat e rekrutimit dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës

Procedurat e dhënies të masave disiplinore


Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Organet drejtuese të Albcontrol SHA janë :

Administratori, znj. L. O. dhe
 Këshilli Mbikëqyrës me përbërje z. G. GJ. (kryetar), znj. V. H., z. B. K., z. I. Gj., znj. O. C. dhe
 znj. M. G. (anëtarë).

Me anë të Vendimit nr. 4 datë 13.06.2023, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

1. Për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë Albcontrol SHA



2. Miratimin e numrit të punonjësve, në total 383.

Marrëdhëniet e punës Albcontrol SHA

Manualin e Burimeve Njerëzore miratuar me nr. prot 635 date 06.03.2019 në të cilin përcaktohet: punësimi, transferimet, ngritjet /uljet në detyrë, vlerësimi i punonjësve, masat disiplinore dhe përfundimi i kontratës së punës.

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi shkëputjet e marrëdhënieve të punës dhe shkaqet për marrjen e këtyre masave

Shkëputjet e marrëdhënieve të punës dhe shkaqet për marrjen e kësaj mase

Nr.	Periudha	Mungesa të pajustificuara	Dorëheqje	Dalje në pension	Dalje në Kemp	Zgjidhje Kontrate	Përfundim i Kontratës së Punës	Total
1	2021		9			6		15
2	2022		18	3		1		22
3	2023		15	6			1	22
	Total							59

Burimi: Të dhënat nga Albcontrol SHA, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi realizimin e zërave të shpenzimeve për periudhën objekt auditimi për personelin si fondi i pagave, pagesa për turne dhe orë jashtë orarit, shpenzime ushqimi për punonjësit, shpenzime për udhëtime dhe dieta, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime page për vjetërsi në punë, fondi suplementar i pensionit, shpenzime të tjera për personelin.

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Paga personeli	691,661,558	456,851,182
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	78,399,252	61,303,700
Shpenzime të tjera për personelin (shpërblime)	69,842,736	3,372,141

Shpenzime të tjera për personelin (trajnime)	35,164,048	71,957,451
Shpenzime të tjera për personelin	1,566,538	14,151,526
	876,634,132	607,636,000

Burimi: Të dhënat nga Albcontrol SHA, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi emërimet e reja

Emërimet e reja për vitin 2021, 2022 dhe 2023:

Nr.	Periudha	Total
1	2021	5
2	2022	27
3	2023	13
	Total	45

Burimi: Të dhënat nga Albcontrol SHA, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Mbi organizimin, rregullsinë dhe mbajtjen e dosjeve të personelit dhe rekrutimin e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara.

Nga grupi i auditimit u audituan 10 dosje personeli.

Proceset gjyqësore për largime të punonjësve nga puna të ngritura, gjatë periudhës objekt auditimi:

Referuar tabelës nr.1 në Aneksë për periudhën objekt auditimi, u konstatuan 56 procese gjyqësore të ngritura nga punonjësit e larguar nga puna. nga të cilat 23 procese gjyqësore janë akoma në status “në proces”. Personat e cilësuar me highlight, përkrijnë me largimet në periudhën objekt nën auditim.

- **Pika 5: Auditimi i veprimtarisë financiare të institucionit. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni nëpërmjet arkës dhe bankës si dhe për blerjet me vlerë të vogël. Saktësimi dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë. Inventarizimi i pasurisë së institucionit.**

Në zbatim të Pikës 6 të Programit të Auditimit nr.1045/1 Prot. datë 29.12.2023, i ndryshuar, “*Auditimi i veprimtarisë financiare të institucionit. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni nëpërmjet arkës dhe bankës si dhe për blerjet me vlerë të vogël. Saktësimi dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë. Inventarizimi i pasurisë së institucionit*”, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Albcontrol SHA.

Në lidhje me auditimin e pikës së mësipërme të programit, grupit të auditimit ju vunë në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat e pozicionit financiar
- Pasqyrat e performancën financiare
- Pasqyrat e flukseve monetare (Cashflow)
- Pasqyrat e Ndryshimeve ne Aktivet Neto/ Fondet Neto

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “Albcontrol” të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2021 dhe datë 31 dhjetor 2022, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe

pasqyrën e ndryshimeve të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Pasqyrat financiare të Albcontrol SHA janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç aktiveve afatgjata materiale të cilat maten me vlerën e rivlerësuar dhe huave afatgjata të cilat njihen me vlerën e drejte në momentin fillestar dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Standarde dhe interpretime të reja.

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021

- Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet financiare", SNK 39 "Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese", SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" dhe SNRF 16 "Qiratë" - Reforma e standardit të normës së interesit - Faza 2 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).

- Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" – Zgjatja e përjashtimit të përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 (data e skadencës për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 u zgjat në periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2023 ose pas).

- Në përgatitjen e pasqyrave financiare drejtimi ka ushtruar gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë prej këtyre vlerësimeve.
- Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.
- Inventarët maten me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e koston specifike për secilin artikull dhe përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së tyre në vendndodhjen dhe kushtet ekzistuese.
- Aktivitetet afatgjata jo-materiale të blera nga Shoqëria janë paraqitur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar të rënies në vlerë. Shpenzimet e mëpasshme të aktiveve afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të aktiveve specifike me të cilat lidhen.
- Aktivitetet afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar janë paraqitur me vlerën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit së cilës i zbritet amortizimi i akumuluar dhe çdo humbje pasardhëse e akumuluar nga rënia e vlerës.

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë efekte materiale në vlerat e njohura në pasqyrat financiare është përfshirë në shënimet si më poshtë:

- aktivet afatgjata materiale: zgjedhja e metodës së rivlerësimit;
- instrumentet financiare.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme që vijnë prej aktiveve dhe detyrimeve financiare:

- Risku i kreditimit
- Risku i tregut
- Risku i likuiditetit

Funksioni i menaxhimit të riskut brenda shoqërisë kryhet duke marrë në konsideratë risqet financiare (të kredisë, tregut, monedhës, likuiditetit dhe normës së interesit), risqet operacionale dhe risqet ligjore. Objektivi kryesor i funksionit të menaxhimit të riskut financiar është të vendosë limite risku, dhe më tej të sigurohet se ekspozimi ndaj risqeve mbahet brenda këtyre limiteve. Funksionet e riskut operacional dhe ligjor janë parashikuar të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar risqet operacionale dhe ligjore. Shoqëria operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike me zhvillime dinamike. Përshtjellimi i mëtejshëm i saj mund të ketë impakt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë. Drejtimi kryen monitorime të rregullta mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe zhvillimeve të tregjeve ndërkombëtare. Bazuar në këtë, drejtimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe kërkon të implementojë masat e duhura në lidhje me riskun e kreditimit, riskun e tregut (kryesisht të normës së interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke limituar kështu efektet e mundshme negative. Për më tepër, Albcontrol SHA është financuar nga nën-huazime nga Qeveria ose palët e lidhura (si DPSHTRR, AAC, APD dhe KISH). Në këtë mënyrë, Albcontrol SHA i përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut duke ruajtur pozicione të qëndrueshme kapitali.

Rritja e riskut të kreditimit.

Siç shpjegohet dhe më poshtë, humbjet e pritshme të kreditit maten si një provizion i barabartë me humbjen e pritshme 12-mujore për instrumentet e fazës 1, ose humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetës për instrumente të fazës 2 ose 3. Një instrument financiar lëviz në fazën 2 kur risku i tij i kreditit është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. SNRF 9 nuk e përcakton çfarë nënkupton një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kreditit. Për të vlerësuar nëse risku i kreditit të një instrumenti është rritur ndjeshëm apo jo, Shoqëria merr parasysh informacion cilësor dhe sasior të arsyeshëm dhe të parashikuar. Bazuar në vlerësimin e menaxhimit “Qasja e përgjithshme” është aplikuar për llogaritë e arkëtueshme me llogaritë e bllokuara pranë Eurocontrol. Duke u bazuar në faktin se llogaritë e bllokuara që përkohë me një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe për llogarit të shtetit Shqiptar, vlerësojmë që risku i kreditit të kompanisë është i ndërlidhur pozitivisht me riskun e sovranitetit të Shqipërisë. Përveç kësaj, ne e konsiderojmë qeverinë shqiptare si suportues të Albcontrol SHA në rast vështirësie financiare, duke e ulur riskun e kreditit. Qeveria duhet të jetë plotësisht e angazhuar për të përmirësuar efikasitetin, kapacitetin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare.

Gjatë matjes së humbjes së pritshme të kredisë, Shoqëria përdor informacion të arsyeshëm dhe të parashikuar, i cili bazohet në supozimet për lëvizjet e ardhshme të faktorëve të ndryshëm nxitës ekonomikë dhe se si këto faktorë do të ndikojnë tek njëri-tjetri.

Humbja nga mos shlyerja është një vlerësim i humbjes që vjen nga mospagimi, duke u bazuar në diferencën midis fluksit monetar kontraktual që paguhet dhe asaj që pritet të merret. Implementimi i “Qasjes së thjeshtuar” është përdorur për aktivet financiare dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera. Analiza e vjetërsisë nuk është kryer e ndarë në 1-30 ditë, 30-60 ditë, 69-90 ditë edhe më shumë se 90 ditë, prandaj janë identifikuar vetëm gjendjet që nuk janë paguar për më shumë se 365 ditë. Në shumicën e rasteve, këto balanca përbëhen nga klientët që janë në një proces gjyqësor

me Shoqërinë. Në lidhje me aktivet financiare, këto balanca përfshijnë kreditë e dhëna drejt punonjësve.

Mundësia e mosshlyerjes përbën një faktor kyç në matjen e humbjes së pritshme të kreditit. Mundësia e mosshlyerjes është një vlerësim i mundshëm i mos pagesës në një periudhë të caktuar kohore, llogaritja e të cilës përfshin të dhëna historike, supozime dhe pritshmëri për kushtet e ardhshme.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku nga humbja që rezulton prej ndryshimeve në çmimet e tregut të brendshëm, kurset e këmbimit dhe normat e interesit. Niveli i riskut të tregut ndaj të cilit ekspozohet shoqëria në një moment të caktuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive për çmimet e ardhshme ose ndryshimet në normat e tregut dhe përbërjen e aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave. Drejtimi cakton limite mbi vlerat e riskut që mund të pranohen, të cilat monitorohen mbi baza mujore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre limiteve në rast të ndryshimeve më të rëndësime të tregut.

Risku i kursit të këmbimit

Risku i kursit të këmbimit rrjedh prej faktit që të ardhurat e shoqërisë dhe pjesa më e madhe e të arkëtueshmeve janë të shprehura në Euro, ndërsa pjesa më e madhe e huave të Albcontrol SHA janë shprehur në monedhë vendase LEK. Risku është që vlera e flukseve të parasë në monedhë funksionale që lind prej ri pagimit të huave dhe interesave respektivë do të ndryshojë si rezultat i lëvizjeve në kurset e këmbimit, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë domethënëse fitimet e shoqërisë.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Albcontrol SHA është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Kjo vihet re dhe nga një rritje e theksuar të Llogarisë së pagueshme nga viti 2021 prej 965,684,451 lekë në vitin 2022 prej 1,121,273,598 lekë.

7. Titulli i gjetjes: Ekspozimi ndaj riskut të kreditimit, tregut dhe likuiditetit

Situata: Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme që vijnë prej aktiveve dhe detyrimeve financiare:

- Risku i kreditimit
- Risku i tregut
- Risku i likuiditetit

Funksioni i menaxhimit të riskut brenda shoqërisë kryhet duke marrë në konsideratë risqet financiare (të kredisë, tregut, monedhës, likuiditetit dhe normës së interesit), risqet operacionale dhe risqet ligjore. Shoqëria operon në kushtet e një bashkëpunimi global dhe situatë ekonomike me zhvillime dinamike. Pështjellimi i mëtejshëm i saj mund të ketë impakt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë. Drejtimi kryen monitorime të rregullta mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe zhvillimeve të tregjeve ndërkombëtare. Bazuar në këtë, drejtimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe kërkon të implementojë masat e duhura në lidhje me riskun e kreditimit, riskun e tregut (kryesisht të normës së interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke limituar kështu efektet e mundshme negative.

Për më tepër, Albcontrol SHA është financuar nga nën-huazime nga Qeveria ose palët e lidhura (si DPSHTRR, AAC, APD dhe KISH).

Kriteri: Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”, Ligj Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”

Ndikimi/Efekti: Ndikim në funksionimin e menaxhimit të institucionit dhe në arritjen e objektivave.

Shkaku: Risku i krijuar nga zhvillime dinamike të jashtme.

Rëndësia: E mesme

7.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, gjatë menaxhimit të tij të ketë në konsideratë që objektivi kryesor i funksionit të menaxhimit të riskut financiar është të vendosë limite risku, dhe më tej të sigurohet se ekspozimi ndaj risqeve mbahet brenda këtyre limiteve. Funksionet e riskut operacional dhe ligjor janë parashikuar të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar risqet operationale dhe ligjore.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit nr. 1045/1 Prot., datë 29.12.2023, “*Auditimi i veprimtarisë financiare të institucionit. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni nëpërmjet arkës dhe bankës si dhe për blerjet me vlerë të vogël. Saktësimi dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë. Inventarizimi i pasurisë së institucionit.*”, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Albcontrol SHA.

Për vitin 2021 janë zhvilluar 18 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me vlerë totale prej 6,901,818 lekë pa tvsh, për vitin 2022 janë zhvilluar 15 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me vlerë totale prej 7,272,195 lekë pa tvsh, dhe për vitin 2023 janë zhvilluar 15 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me vlerë totale prej 7,549,050 lekë pa TVSH. (Tab. nr.3, Aneks)

Në qëllim të përmbushjes së pikës së mësipërme të programit, në bazë të riskut dhe kriterëve të përzgjedhjes, u morën në shqyrtim procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si më poshtë:

Objekti	Fondi limit	Afati	Operatori Ekonomik	Oferta
Trajnim periodik për sektorin e Sigurisë	791.200	11.02.2021	I. A.	791.000
Rinovim license 1 (një) vjeçar për antivirus McAfee ePO për 300 code	793.333		S. CO	650.000
Shërbim riparim modul fuqie 16 KË të UPS APC SHNEIDER , Radari Rinas , sasia 1 copë	498.000		S. CO	490.000
Opinion mbi objektin e veprimtarisë së shoqërisë Albcontrol, statusin ligjor të saj, pronësia mbi asetet dhe funksioni publik i saj.	590.000	13.04.2021	G. B.	497.500
Rinovim license për ManageEngine ServiceDesk Plus , licensë 1 vjeçare.	763.867		S. CO	650.000
Blerje modul fuqie 16 KW për UPS SHNEIDER modular SIMETRA	798.233		S. CO	789.000
Materiale elektrike	986.667		T. sh.p.k	520.000
Gyp PTT, kompatibël për ëalker 9028-1(me konektor modular RJ/LEMO/UD)	693.333	12.04.2021	R. sh.p.k	660.000
Zëvendësimi i pajisjeve të komunikimit për shërbimin EAD	899.000	19.07.2022	P. S.	879.000

Nga auditimi i procedurave të mësipërme të prokurimit me vlerë të vogël, nga grupi i auditimi u konstatua që:

Në 5 procedura nga 9 të përzgjedhura për auditim oferta fituese është sa 99% e vlerës së fondit limit.

Kompania S. CO nga 9 procedura që janë përzgjedhur për kontroll ka fituar 4 prej tyre.

3 nga këto procedura janë fituar pasi janë tërhequr Operatorët Ekonomik me ofertë ekonomike më të ulët se OE S. CO konkretisht procedura me objekt:

“*Rinovim licence 1 (një) vjeçar për antivirus McAfee ePO për 300 node*” OE S. CO ka qenë e renditur në vendin e 3. Janë tërhequr 2 OE me ofertë më të ulët P. S. me ofertë ekonomike 490,000 lekë dhe Business Information Systems Softëare me oferte 600,000 lekë.

“Rinovim license për ManageEngine ServiceDesk Plus , licensë 1 vjecare” OE S. CO ka qenë e renditur në vendin e 2. Është tërhequr OE me ofertë më të ulët Business Information Systems Softëare me oferte 500,000 lekë.

“Blerje modul fuqie 16 KW për UPS SHNEIDER modular SIMETRA” OE S. CO ka qenë e renditur në vendin e 5. Janë tërhequr OE P. me ofertë ekonomike 769,000 lekë , OE A. 2018 me ofertë ekonomike 769,000 lekë , OE O. M. me ofertë 782,000 lekë dhe OE E. K. &T. me ofertë ekonomike 788,000 lekë.

Gjithashtu nga ana e shoqërisë Albcontrol një zë të konsiderueshëm zë dhe zëri “Blerje bileta” (Tab. nr.4, Anekse)

Për shpenzime udhëtimi, bileta për vitin 2021 janë shpenzuar 14,185,245 lekë, për vitin 2022 janë shpenzuar 6,998,065 lekë dhe për vitin 2023 janë shpenzuar 6,305,186 lekë.

Ajo që vihet re nga grupi i auditimit është se mesatarisht çdo biletë e transportit ajror për person është mesatarisht 100,000 lekë pavarësisht destinacionit përfundimtar.

- **Pika 6: Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e proceduarve të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve**

Në zbatim të pikës 7 të Programit të Auditimit nr. 1045/1 Prot., datë 29.12.2023, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për realizimin e procedurave të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave , punëve dhe shërbimeve.”, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Albcontrol SHA.

Objektivi i këtij akt konstatimi është:

- Vlerësime nëse subjekti ka zhvilluar një procedurë prokurimi konform udhëzimeve dhe ligjeve në fuqi.
- Vlerësime nëse kërkesat e sigurisë janë adresuar në prokurim dhe janë në përputhje me to.

Auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik

Bazuar në një analizë risku dhe në metodat e përzgjedhjes për auditim të procedurave të prokuruaru u vendos për auditimin e procedurës të mëposhtme:

- “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA”

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA ” 2021		
Urdhër Prokurimi : Nr.1986, datë 09.12.2021		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”	36. Njësia e Prokurimit Urdh.Nr.1986 prot., datë 09.12.2021/ i ndryshuar me Urdh. Nr.33 prot., datë 07.01.2022 (ndryshim i anëtares S. P. me K. V.). Z. E. Ll. Znj. K. V. Z. F. H.	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Urdh. Nr 1819/1 prot., datë 11.11.2021 Znj. M. R. Kryetare Z. G. Th. Anëtar Z. M. M. Anëtar
4. Fondi limit (pa TVSH): 84.175.068 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Albcontrol SHA	6. Data e hapjes së tenderit: 10.01.2022

7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: OE "A. P." Sh.p.k K.....H OE "A. G. C." Sh.p.k K.....I OE "C. F." Sh.p.k L.....R OE "D." Sh.p.k K.....H B.OE "A." Sh.p.k L.....A & "S." sh.p.k K.....D B.OE "P. S." Sh.p.k L.....R & "V. R." sh.p.k L.....Q b) Kualifikuar: B.OE "A." Sh.p.k L.....A & "S." sh.p.k K.....D	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdh.Nr.1986/1prot.,datë 9.12.2021 Znj. D. C. Kryetare Z. D. B. Anëtar Z. J. K. Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 79.170.408 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë furnizimi nr.1986/10 prot., datë 22.04.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 5.004.660 lekë	12. Ankimime Ankesa nr.2056 prot., datë 20.12.2021 e O.E "G. E." për procedurën e prokurimit me objekt " Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : Urdh. Nr.1986/11 prot., datë 22.04.2022 Znj. M. R. Kryetare Z. G. Th. Anëtar Z. M. M. Anëtar	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 36 muaj

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Kërkesës nr.1819 prot., datë 11.11.2021, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Sigurisë i është drejtuar sektorit të prokurimeve për të filluar procedura e prokurimit me objekt **"Shërbim i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA"**.

Me anë te Urdhrit të brendshëm nr.1819/1 prot., datë 11.11.2021 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e specifikimeve teknike për prokurimin me objekt **"Shërbim i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA"**. Me anë të urdhrit nr.1180/3 prot., datë 15.11.2021 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit. Grupi i punës i përbërë nga znj. H. P. Kryetare , znj. V. I. Anëtare , V. Ll. Anëtare me anë të proces verbalit nr.1817/4 prot., datë 26.11.2021 ka vendosur fond limit **84.175.068** (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mije e gjashtëdhjetë e tetë lekë) pa TVSH me afat 36 muaj. Ky fond limit është përcaktuar në bazë të vlerësimit të 3 ofertave nga operatorët si mëposhtëm:

1. "F." sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 84.432.060 lekë pa TVSH për 36 muaj.
2. "P. Xh." G. S. PF paraqiti ofertën e tij me vlerë 84.710.124 lekë pa TVSH për 36 muaj.
3. "A." sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 83.383.020 lekë pa TVSH për 36 muaj.

Në datë 09.12.2021, me anë të Urdhri i Prokurimit nr.1986 prot. me objekt **"Shërbim i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA"** u caktuan anëtarët e NJP.

Në datë 09.12.2021 me anë të urdhrit nr. 1986/1 prot., u ngrit KVO.

Në datën 09.12.2021 Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret kualifikuese që u vendosën në DST. Njoftimi i kësaj kontrate u publikua në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. Data e hapjes së ofertave u vendos 10.01.2022.

Me anë të procesverbalit datë 10.12.2021 njësia e prokurimit ka dhënë shpjegimit që kjo *"Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetary"* nuk mund të ndahet në lote. Ky argumentim është mbështetur në Kreun V , neni 42 , pika 1 dhe 2 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*.

Në 20.12.2021 pranë AK "Albcontrol" SHA u protokollua ankesa nr.2056 prot., nga O.E "G. E." Në zbatim të ligjit nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"* , neni 112 *"Veprimet paraprake"* VKM nr.285 , datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* (i ndryshuar) , nenit 96 *"Veprimet paraprake të autoritetit/entit kontraktor"*, AK nxori urdhër pezullimin Nr.1986/2 datë

20.12.2021 për NJP që të pezulloje vazhdimin e procedurës deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në datën 20.12.2021 me anë të urdhrin nr. 1986/3 prot., është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesës. Komisioni përbehej nga znj. D. C. Kryetare, J. K. Anëtar dhe D. B. Anëtar.

Në datën 22.12.2021 me anë të letrës nr. 2056/1 prot., është kthyer përgjigje O.E “G. E.” në lidhje me ankesën e depozituar nr.2056 prot., datë 20.12.2021 për rishikimin e pikës 2.3.4 për kapacitetin teknik tek DST. Është pranuar e plotë ankesa duhej e hequr këtë pikë nga kriteret e veçanta të kualifikimit.

Në datën 22.12.2021.

Në lidhje me pranimin e ankesës së O.E “G. E.” dhe ndryshimin e kriterit për pikën 2.3.4 për kapacitetin teknik tek DST është njoftuar Komisioni i Prokurimit Publik me anë të letrës nr. 2056/2 datë 22.12.2021.

Në datën 28.12.2021 me anë të shkresës nr. 1986/4 prot., është nxjerrë urdhri për heqjen e pezullimit të procedurës me objekt **“Shërbim i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA”**.

Në datën 07.01.2022 me anë të shkresës nr.33 datë AK ka bërë zëvendësimin e anëtares së NJP znj.S. P. me anëtares znj.K. V.. Ky zëvendësim është bërë në bazë të kërkesës nr.18 prot., datë 06.01.2022 që znj. S. P. i ka dërguar drejtorit të përgjithshëm të Albcontrol SHA.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin nr. 1986/1 datë 9.12.2021, ka mbajtur procesverbalin në datën 19.01.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me objekt: **“Shërbim i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA”**, me fond limit **84.175.068** (tetëdhjet e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e tetë lekë) pa TVSH me afat 36 muaj .

Në këtë procedurë është paraqitur janë paraqitur operatorët ekonomikë si mëposhtë:

1. O.E "A. P." SHPK me NIPT K.....H me ofertë ekonomike : 58.680.000 lekë pa TVSH.
2. O.E "A. G. C." SHPK me NIPT K.....I me ofertë ekonomike : 59.844.210 lekë pa TVSH.
3. O.E "C. F." SHPK me NIPT L.....R me ofertë ekonomike : 70.999.992 lekë pa TVSH.
4. O.E "D." SHPK me NIPT K.....H me ofertë ekonomike : 74.952.650 lekë pa TVSH.
5. B.O.E "A." SHPK me NIPT L.....A & “S.” SHPK me NIPT K.....D me ofertë ekonomike : 79.170.408 lekë pa TVSH.
6. B.O.E "P. S." SHPK me NIPT L.....R & “V. R.” SHPK me NIPT L.....Q me ofertë ekonomike : 82.465.056 lekë pa TVSH

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), i ngritur me Urdhrin Urdhër nr. 1986/1 datë 9.12.2021 ka mbajtur procesverbalin në datë 31.01.2022 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me objekt: **“Shërbim i pastrimit të ambjenteve të Albcontrol SHA”**, me fond limit **84.175.068** pa TVSH me afat 36 muaj .

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatorëve ekonomik.

Pasi u krye vlerësimi i ofertave për kriteret e përgjithshme u konstatua se operatorët ekonomik i plotësonin këto kriteret.

Nga vlerësimi i dokumenteve teknike dhe ekonomike për të gjithë operatorët KVO ka skualifikuar operatorët si mëposhtë duke dhënë edhe arsyet e skualifikimit:

1. OE “A. P.” sh.p.k me nipt K.....H nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet standarde të tenderit konkretisht:

OE nuk plotëson pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën parashikohet se ofertuesi duhet të paraqesë: *“O.E për realizimin e kësaj kontrate duhet të ketë të punësuar të paktën 30 punonjës për tre muajt e fundit nga data e shpalljes së procedurës, për ndjekjen/zbatimin e kontratës.* O.E nuk e përmbush këtë kriter pasi listpagesa e muajit Nëntor OE ka deklaruar 23 punonjës.

OE nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën parashikohet se ofertuesi duhet të paraqesë: *“OE në lidhje me çështjen e sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të ketë të punësuar me kontratë individuale një mjek të shoqërisë”.* Për përmbushjen e këtij kriteri OE ka ngarkuar në SPE “Kontratë Individuale Pune” të datës 03.10.2016 me mjeken e shoqërisë. Edhe pse OE e ka paraqitur këtë kontratë ai nuk e ka deklaruar si pjesë të stafit në listë pagesat për 3 muajt e fundit. OE nuk plotëson shkronjën b pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën parashikohet se OE duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme: *b) Grumbullim, transportim, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve urbane.* Për përmbushjen e këtij kriteri O.E ka ngarkuar në SPE : Licence-Kodi III.2.B, me nr. Serial LN-2170-10-2016 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: *“Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane”.* Objekti i licencës nuk përfshin proceset e tjera të kërkuara në DST atë të *riciklimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve.*

2. OE “A. G. C.” sh.p.k me nipt K.....I nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet standarde të tenderit konkretisht:

OE nuk plotëson shkronjën b pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën parashikohet se OE duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme: *b) Grumbullim, transportim, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve urbane.* Për përmbushjen e këtij kriteri O.E ka ngarkuar në SPE : Licence-Kodi III.2.B, me nr. Serial LN-1163-03-2016 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: *“Transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”.* Objekti i licencës nuk përfshin proceset e tjera të kërkuara në DST atë të *grumbullimit, riciklimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve.*

3. OE “C. F.” sh.p.k me nipt L.....R nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet standarde të tenderit konkretisht:

OE nuk plotëson shkronjën b pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën parashikohet se OE duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme: *b) Grumbullim, transportim, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve urbane.* Për përmbushjen e këtij kriteri O.E ka ngarkuar në SPE : Licence-Kodi III.2.B, me nr. Serial LN-3708-08-2017 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: *“Ngarkim, grumbullim transportim dhe depozitim i mbetjeve urbane”.* Objekti i licencës nuk përfshin proceset e tjera të kërkuara në DST atë të *riciklimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve.*

4. OE “D.” sh.p.k me nipt K.....H nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet standarde të tenderit konkretisht:

OE nuk plotëson shkronjën b pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën parashikohet se OE duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme: *b) Grumbullim, transportim, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve urbane.* Për përmbushjen e këtij kriteri

O.E ka ngarkuar në SPE : Licence-Kodi III.2.B, me nr. Serial LN-0998-02-2016 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: “*Grumbullim transportim dhe depozitim i mbetjeve urbane*”. Objekti i licencës nuk përfshin proceset e tjera të kërkuara në DST atë të, *riciklimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve*.

5. B.O.E "A." SHPK me NIPT L.....A & “S.” SHPK me NIPT K.....D nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet standarde të tenderit konkretisht:

B.OE nuk plotësojnë pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën parashikohet se B.OE duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme:

a) *Vlerësimi e ndikimi në mjedis dhe auditimi mjedisor.*

b) *Grumbullim, transportim, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve urbane.*

c) *Licence II.8.B, Licence për Shërbime Ndërhyrës Higjenoshëndetsore (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim).*

Sipas kontratës së bashkëpunimit për B.OE me nr.312 Rep dhe nr.214 Kol. datë 18.01.2022, pjesëmarrja në këtë procedurë është në raportet: 43.3% për OE “A.” sh.p.k dhe 56.7% për OE “S.” SHPK

Në bazë të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nenit 88 “ Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 3 e tij specifikon se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LLP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në SPE rezulton se OE “A.” sh.p.k, pjesë e këtij B.OE nuk ka përmbushur pikën 2.3.4 në raport me përqindjen e marrë përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit.

6. B.O.E "P. S." SHPK me NIPT L.....R & “V. R.” SHPK me NIPT L.....Q nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet standarde të tenderit konkretisht:

B.OE nuk plotësojnë pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën parashikohet se :Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë kontrata ku te ketë realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël sa 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Sipas kontratës së bashkëpunimit për B.OE me nr.344 Rep dhe nr.91 Kol. datë 19.01.2022, pjesëmarrja në këtë procedurë është ndarë në raportet: 87.4% për OE “P. S.” shpk dhe 12.6% për OE “V. R.”.

Në bazë të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nenit 88 “ Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 3 e tij specifikon se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LLP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhej të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në SPE rezulton se OE “V. R.” shpk, pjesë e këtij B.OE nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, për realizimin e shërbimeve të ngjashme me objekt shërbimi pastrimi, në raport me përqindjen e marrë përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit.

Për sa më sipër Autoriteti Kontraktues do të presë afatet proceduralë të ankimit për procedurën me objekt : **“Shërbim i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA”**, me fond limit **84.175.068** (tetëdhjete e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e tetë lekë) pa TVSH me afat 36 muaj .

AK ne datë 31.01.2022, me anë të shkresës ne.1986/6 prot. bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “ Për prokurimin publik” nenin 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, shkronja b “në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”, ka njoftuar anulimin e procedurës se prokurimit me objekt : “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA”.

Kundër vendimit të KVO-së kanë bërë ankimim B.O.E A." SHPK me NIPT L.....A & “S.” SHPK me NIPT K.....D si dhe OE “A. G. C.” sh.p.k me nipt K.....I.

Në datë 07.02.2022 AK ka nxjerrë urdhrin e pezullimit nr. 1986/6 prot., për pezullimin e vazhdimin të procedurës me nr. REF-14628-12-09-2021.

Në datën 07.02.2022 me anë të urdhrin të brendshëm nr.393 AK urdhëroj ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesave, ky komision i përbërë nga z. G. Th. (Kryetar), z. K. N. Anëtar dhe z. K. B. (Anëtar) në përfundim të shqyrtimit të ankesave vendosi mos pranimin e ankesave.

Kundër vendimit të komisionit për vlerësimin e ankesave të ngritur nga Autoriteti Kontraktues është bërë ankimim pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.294/2022 , me nr. 208/5 prot. datë 30.03.2022 ka vendosur të pranojë ankesën e paraqitur nga B.O.E "A." SHPK & “S.” SHPK për procedurën e prokurimit “ E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-14628-12-09-2021, me objekt “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol” SHA dhe Autoriteti Kontraktor te anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e B.O.E "A." shpk & “S.” shpk.

Autoriteti Kontraktues pas vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.294/2022 , me nr. 208/5 prot. datë 30.03.2022 ka nxjerrë urdhrin nr. 1986/7 datë 31.03.2022 për heqjen e pezullimit për procedurën e prokurimit me nr. REF-14628-12-09-2021, me objekt “Shërbimi i pastrimit të ambjenteve të Albcontrol” SHA

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor në zbatim të vendimit të KPP-së, më datë 31.03.2022 me shkresën nr.1986/8 prot. ka publikuar formularin e njoftimit të fituesit (pas procesit të ankimit).

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Në datë 22.04.2022 është lidhur kontratë furnizimi nr.1986/10 prot., me B.OE “A.” sh.p.k & “S.” SHPK Kjo kontratë do të ndiqet nga grupi i punës i ngritur me anë të Urdh. Nr.1986/11 prot., datë 22.04.2022.

Për sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar se:

KPP në lidhje me vendimin për kualifikimin e B.O.E "A." SHPK & “S.” SHPK për procedurën e prokurimit “ E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-14628-12-09-2021, me objekt “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol” SHA, nuk ka marrë në konsideratë rishikimin

e dokumentacionit dhe të skualifikimi të OE të tjerë pjesëmarrës, të cilët janë skualifikuar nga KVO për të njëjtat arsye si më poshtë:

“OE nuk plotëson shkronjën b pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kuaifikimit, në të cilën parashikohet se OE duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme: b) *Grumbullim, transportim, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve urbane*. Për përmbushjen e këtij kriteri O.E ka ngarkuar në SPE : Licence-Kodi III.2.B, me nr. Serial LN-0998-02-2016 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: “*Grumbullim transportim dhe depozitim i mbetjeve urbane*”. Objekti i licencës nuk përfshin proceset e tjera të kërkuara në DST atë të, *riciklimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve.*”

Në kushte të tilla, duke qenë se është marrë në konsideratë si i përmbushur kriteri i mësipërm, atëherë KPP duhet të kishte zgjedhur si fitues të procedurës së prokurimit, OE me ofertë më të ulët, që në këtë rast është O.E "A. G. C." SHPK me NIPT K.....I me ofertë ekonomike : **59.844.210** lekë pa TVSH, duke shkaktuar një efekt financiar në vlerën prej 19,326,198 lekë pa TVSH, në Buxhetin e shoqërisë Albcontrol SHA.

- Grupi i auditimit mbështet auditimin e tij dhe në praktikat më të mira, ku bazuar në kontrata të ndryshme të zhvilluara nga subjekte të ngjashme në vendet e tjera, çmimi i ofruar për kryerjen e një shërbimi të tillë luhet midis vlerave 0.20-0.50\$/m², ndërkohë në kontratën në fjalë, çmimet luhaten midis vlerave 120-144 lekë/m².
- Gjithashtu gjatë rishikimit të preventivit të shërbimit të pastrimit, vihen re zëra të përfshirë që në nuk janë të arsyeshëm dhe që të çojnë drejt fyerjes së fondit limit, si më poshtë:

Lista e çmimeve

1- Maroubi Lounge						
1	Shërbim mirëmbajtje tualetesh 44.4 m ² (10 tualete : 7 banjo, 3 parabanjo)	copë	10	1900	19000	Grafiku periodik
2	Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim I mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim I mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)	m ²	450	9	4050	mujore
2-Godina e administratës						
1	Shërbim mirëmbajtje tualetesh 44.4 m ² (14 tualete : 10 banjo, 4 parabanjo)	copë	14	1900	26600	Grafiku periodik
2	Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim I mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim I mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)	m ²	5500	9	49500	mujore
3- Godina e akademisë						
1	Shërbim mirëmbajtje tualetesh 44.4 m ² (12 tualete : 8 banjo, 4 parabanjo)	copë	12	1900	22800	Grafiku periodik
2	Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim I mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim I mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)	m ²	771	9	6939	mujore
4- Godina ACC dhe kulla e re						
1	Shërbim mirëmbajtje tualetesh 44.4 m ² (24 tualete : 16 banjo, 8 parabanjo)	24	24	1900	45600	Periodik
2	Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim I mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim I mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)	m ²	4000	9	36000	mujore
5- zyrat meteo						
1	Shërbim mirëmbajtje tualetesh 7.3 m ² (1 tualete : 1banjo, 1 parabanjo)	1	1	1900	1900	periodik
2	Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim I mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim I mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)	m ²	47	9	423	
6- zyrat e brifingut						
1	Shërbim mirëmbajtje tualetesh 7.3 m ²	copë	1	1500	1500	ditore
2	Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim I mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim I mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)	m ²	12	9	108	
7- magazine / pranë administratës						
1	Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim I mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim I mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)	m ²	400	9	3600	mujore
8- Lokali pranë godinës së ACC dhe kulla e re						
1	Shërbim mirëmbajtje tualetesh 13 m ²	copë	3	1900	5700	peridike
2	Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim I mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim I mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)	m ²	305	9	2745	mujore
Totali						

8. Titulli i gjetjes: Shpenzim i fondeve publike pa efektivitet në vlerën 1,951,680 lekë pa tvsh
Situata: Nga auditimi u konstatua se në specifikimet teknike dhe preventiv, është përfshirë edhe zëri “Monitorime e shërbime D.D.D (shërbim i mirëmbajtjes për dezinfektim, dezinfektim, deratizim i mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektim për pandeminë Covid -19)”. Natyra e këtij shpenzimi lidhet me problematikën që ka krijuar në vend situata e COVID 19, situatë e cila nuk ekziston më për periudhën në të cilën është lidhur dhe zbatuar kontrata për të kryer shërbimet e mësipërme. Planifikimi i kohëzgjatjes së shërbimit që do të përfitohej nga zhvillimi i kësaj procedure, nga AK është bërë për 3 vite, një planifikim i pa arsyetuar, pasi data e përfundimit të kontratës është 22.04.2025.

Autoriteti Kontraktor Albcontrol SHA, nuk duhet të kishte përfshirë në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA”, edhe shpenzimit të cilat lidhen me situatën COVID 19. Shpenzimet për situatën e pandemisë, duhet të ishin kryer me procedurë më vete, pasi kohëzgjatja e nevojës për pastrimin e ambienteve, nuk lidhet me kohëzgjatjen e nevojës për shpenzime në funksion të pandemisë. e cila është një nevojë që diktohet nga ecuria e situatës dhe kërkon zhvillim procedurash në afate të shkurtra kohore.

Për sa më sipër vlera e shpenzuar për shkak të situatës së pandemisë COVID 19, prej 1,951,680 lekë, nga lidhja e kontratës deri më 31.12.2023, konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa efektivitet, pasi nga shpenzimi i tyre autoriteti kontraktor nuk ka përfituar asnjë dobi.

Kriteri: Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

Ndikimi/Efekti: Shpenzim i fondeve publike pa efektivitet në vlerën 1,951,680 lekë pa TVSH.

Shkaku: Vendosja e specifikimeve teknike jo në proporcion me objektin e kontratës.

Rëndësia: E lartë

8.1 Rekomandimi: Ak të marrë masa që në rastet e kontratave të cilat kanë natyra dhe kohëzgjatje të ndryshme, të bëjë ndarjen e tyre në procedura më vete, me qëllim që kohëzgjatja e njëjës natyrë procedurës të mos kushtëzohet nga kohëzgjatja e natyrës tjetër të procedurës.

9. Titulli i gjetjes: Nuk është kryer një analizë kosto përfitim në lidhje me ofrimin e shërbimit

Situata: Nga auditim i u konstatua se shoqëria Albcontrol SHA në vitin 2022 ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim i pastrimit të ambienteve të Albcontrol SHA”, me vlerë të kontratës 79,170,408 lekë, me afat 36 muaj. Edhe pse shoqëria ka në strukturën e vetë organizative Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse dhe të Sigurisë, konstatohet se përpara zhvillimit të kësaj procedure nga AK nuk janë bërë analizë e detajuar kosto-përfitim, nëse duke krijuar struktura të reja me punonjës të këtij shërbimi, ky shërbim mund të kryhej me kosto më të ulëta nga kostot e llogaritura në procedurën me prokurim publik. Gjithashtu grupi i auditimit mbështet auditimin e tij dhe në praktikat më të mira, ku bazuar në kontrata të ndryshme të zhvilluara nga subjekte të ngjashme në vendet e tjera, çmimi i ofruar për kryerjen e një shërbimi të tillë luhet midisi vlerave 0.20-0.50\$/m², ndërkohë në kontratën në fjalë, çmimet luhaten midisi vlerave 120-144 lekë/m².

Kriteri: Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

Ndikimi/Efekti: Përdorimi i burimeve jo në mënyrë eficiente, efektive dhe ekonomike.

Shkaku: Personat përgjegjës janë bazuar në kontratat e mëparshme.

Rëndësia: E lartë

9.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, Këshilli Mbikëqyrës dhe departamentet përkatëse gjatë hartimit të planifikimeve buxhetore të shoqërisë, të marrin në konsideratë pozicionin financiar që ndodhet Albcontrol SHA, si dhe për çdo planifikim buxhetor të natyrës së shërbimeve të kryej një

analizë kosto përfitim për mundësinë e kryerjes së shërbimit duke u mbështetur dhe në burimet e veta njerëzore.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Në lidhje me konstatimin e mësipërm, siç kemi shpjeguar në Observacionin nr.1229/5 datë 04.04.2024, theksojmë sërish se: -Zëri “Shërbim mirëmbajtje tualetesh” në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr.1819/1 prot 11.11.2021, është parashikuar si zë më vete. Ky zë nuk ka lidhje me pastrimin e tualeteve, letrave higjenike ose pastruesit higjenik, pasi këto janë shërbime që i përkasin zërit “pastrimi i tualeteve” dhe zërit “materiale pastrimi”. -Zëri “Shërbim mirëmbajtje tualetesh” përfshin specifikisht shërbimet e mirëmbajtjes për nyjet sanitare si (rubineta, saracineska, sifona, galexhantëve, kapakë WC, autokllave 200 lt.etj), si edhe mirëmbajtjen e pompave të ujit. Ky shërbim është parashikuar për arsye se, furnizimi me ujë i ambjentëve të shoqërisë ALBCONTROL SHA nuk kryhet nga rrjeti i ujësjellës kanalizimeve por nëpërmjet dy puseve. Për shkak të këtij furnizimi dhe të ujit me përmbajtje të lartë gëlqerore (specifike e zonës), në mënyrë të vazhdueshme krijohen problematika me bllokime të nyjeve sanitare dhe probleme nga më të ndryshme në ambientet e tualeteve të Shoqërisë ALBCONTROL SHA. Duke iu referuar shërbimeve të sipërcituara bëhet i qartë dallimi se zëri “shërbim mirëmbajtje tualetesh” përfshin shërbime qartësisht të dallueshme nga zërat e tjerë, të tilla si pastrimi i tualeteve, letrat higjenike apo pastruesit higjenik. Ky zë nuk është një zë i ekzagjeruar por një zë i nevojshëm brenda objektit të kontratës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ndikonte në “fryrjen e fondit limit”.

Në përgatitjen e specifikimeve teknike, ky zë lidhet specifikisht me Dezinsektimin, Deratizimin, Dezinfektimin (D.D.D) e ambienteve të brendshme dhe të jashtme (me fokus në ambientet e jashtme) të Shoqërisë ALBCONTROL SHA, përkatësisht Godina e Administratës, Godina ACC/Kulla e Re, Godina “Marubi Lounge”, Magazina pranë Administratës, Lokali pranë Godinës ACC / Kulla e Re, Zyra Meto, Zyra e Brifingut pranë pistës së TIA. Këto shërbime kryhen me qëllim parandalimin dhe asgjësimin e insekteve të dëmshme të të gjitha llojeve, zvarranikëve apo brejtësve, të cilët janë bartës të agjentëve të sëmundjeve ngjitëse, si edhe mund të deportojnë dhe të jenë faktor risku në ofrimin e shërbimit të lundrimit ajror si dhe në menaxhimin e aseteve të kompanisë. Prandaj është kërkuar zbatimi i një programi të vazhdueshëm për parandalimin dhe asgjësimin e tyre, për të siguruar një mbrojtje maksimale. Pra, ky është qëllimi bazë i shërbimeve që përfshihen në këtë zë. Paqartësia e shërbimit të kryer në këtë zë nga ana e Grupit të Audituesve, në gjykimin tonë ka sjellë dhe një përlllogaritje jo të saktë të dëmit ekonomik, duke e pëlllogaritur të gjithë shërbimin si shërbim që lidhet vetëm me dezinfektim për pandeminë Covid-19. Veç sa më sipër, sjellim në vëmendje edhe parashikimet e mëposhtme në aktet juridike, në të cilat reflektohet specifika dhe rëndësia e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror, konkretisht:

A) Në Statutin e Shoqërisë në fuqi, në nenin 3 të tij, Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë parashikohet se është:

Të ofrojë shërbime të lundrimit ajror, të nevojshme për të garantuar sigurinë, eficientën dhe rregullueshmërinë e operimit të avionëve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe më gjerë të publikuar në AIP Albania, në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet e ratifikuara dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror.

B) Në nenin 197/5, pika 2 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, sanksionohet se:

2. Janë shërbime të rëndësishme jetike:

a) shërbimet e domosdoshme mjekësore dhe spitalore;

b) shfuqizuar;

c) shfuqizuar;

ç) shërbimet e kontrollit të trafikut ajror;

d) shërbimet e domosdoshme të mbrojtjes kundër zjarrit;

dh) shërbimet e domosdoshme në burgje.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, mori në konsideratë observacionin pjesërisht dhe kreu rregullimet përkatëse përgjatë materialit.

Për sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi, Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike ngritur me urdhr nr. 1819/1 Prot., datë 11.11.2021, me përbërje: znj. M. R. Kryetare. z. G. Th. Anëtar dhe z. M. M. Anëtar, për veprimet dhe mosveprimet në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Gjithashtu ngarkohet me përgjegjësi grupi i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës ngritur me Urdhër Nr.1986/11 prot., datë 22.04.2022 me përbërje: znj. M. R. Kryetare. z. G. Th. Anëtar dhe z. M. M. Anëtar, për veprimet dhe mosveprimet në mospërputhje me Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

“Mirëmbajtja e programit ArcGIS”

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e programit ArcGIS” 2022		
Urdhër Prokurimi : Nr.2699, datë 10.11.2022		
2. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar ”	2. Njësia e Prokurimit Urdh. Nr.2699 prot., datë 10.11.2022 Znj. S. P. Znj. K. V. Z. K. N.	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Urdh. Nr.2306/1 datë 16.09.2022 Znj. S. M. Kryetare Z. A. B. Anëtar Z. J. T. Anëtar
4. Fondi limit (pa TVSH): 6.183.333 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Albcontrol SHA	6. Data e hapjes së tenderit: 25.11.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: OE “A. B. P.” shpk b) Kualifikuar: OE “A. B. P.” shpk	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.2699/1 datë 10.11.2022 Z. D. I. Kryetar Z. D. K. Anëtar Z. E. L. Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 6.183.233 ekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë furnizimi nr.2699/4 prot., datë 22.12.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 100 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : Urdh. Nr.2699/5 prot., datë 22.12.2022 Znj. S. M. Kryetare Z. A. B. Anëtar Z. J. T. Anëtar	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 12 muaj

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të kërkesës nr.2306 prot., datë 14.09.2022, Drejtoria e Divizionit Operacional i është drejtuar sektorit të prokurimeve për të filluar procedura e prokurimit me objekt “**Mirëmbajtja e programit ArcGIS**”.

Me anë te Urdhrit të brendshëm nr.2306/1 prot., datë 16.09.2022 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e specifikimeve teknike. Me anë te Urdhrit të brendshëm nr.2306/2 prot., datë 20.09.2022 anëtarët e strukturës së specializuar paraqitën specifikimet teknike të cilat u vendosën në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST).

Me anë të urdhrit nr.2306/3 prot., datë 04.11.2022 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit. Grupi i punës i përbërë nga znj. H. P. Kryetare , znj. V. I. Anëtare dhe z. R. M. Anëtar me anë të proces verbalit nr.2306/4 prot., datë 09.11.2022 ka vendosur fond limit 6.183.333 (gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjete e tre mijë e treqind e tridhjet e tre lekë) pa TVSH. Ky fond limit është përllogaritur duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

“A.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 6.000.000 lekë pa TVSH.
“N.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 5.750.000 lekë pa TVSH.
“K.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 6.800.000 lekë pa TVSH.

Në datë 10.11.2022, me anë të Urdhri i Prokurimit nr.2699 prot. me objekt “**Mirëmbajtja e programit ArcGIS**” u caktuan anëtarët e NJP.

Në datë 10.11.2022 me anë të urdhrit nr. 2699/1 prot., u ngrit KVO.

Në datën 11.11.2022, Njësia e Prokurimit përcaktoi kriteret kualifikuese, që u vendosën në DST për procedurën e prokurimit nr.2699 prot. me objekt **“Mirëmbajtja e programit ArcGIS”** me fond limit **6.183.333** lekë pa TVSH. Afati i ri për hapjen e ofertave ishte data 25.11.2022.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.2699/1 datë 10.11.2022, ka mbajtur procesverbalin në datën 25.11.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave.

Në këtë procedurë është paraqitur vetëm një operator si mëposhtë:

1. **OE “A. B. P.s”** sh.p.k me ofertë ekonomike 6.183.233 lekë pa TVSH.

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin nr. 2699/1 datë 10.11.2022 ka mbajtur procesverbalin në datë 05.12.2022 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin dokumentet për Kriteret e Përgjithshme për operatorin ekonomik. Operatori Ekonomik i plotësonin Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit.

Nga vlerësimi i dokumenteve teknike dhe ekonomike rezultoi se OE i plotësonin të gjitha kriteret e përcaktuara në DST.

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 25.11.2021 me anë të shkresës nr.2699/2 prot., Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Nga kjo procedurë prokurimi fitues është shpallur oferta ekonomike e OE **“A. B. P.s” shpk** me vlerë **6.183.233** lekë pa TVSH

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Në datë 22.12.2022 është lidhur kontratë furnizimi nr.2699/4 prot., me OE fitues **“A. B. P.s” shpk**. Kjo kontratë do të ndiqet nga grupi i punës i ngritur me Urdh. Nr.2699/5 prot., datë 22.12.2022.

10. Titulli i gjetjes Mos përmbushja e kriterëve të përcaktuara në DST

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e programit ArcGIS” zhvilluar në vitin 2022 me vlerë të fondit limit 6,183,333 lekë, në përmbushje të kriterëve të veçanta, pikës 4 të dokumenteve standarde të Tenderit *“Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me autorizim prodhuesi Esri i programit ArcGIS. Autorizimi duhet të jetë i lëshuar nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar, apo të tjerë lejuar/certifikuar/autorizuar nga prodhuesi në Republikën e Shqipërisë. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, gjithashtu AK ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave*

të Autorizimit të Prodhuesit apo të lejeve të prodhuesit.”, OE fitues i procedurës së prokurimit “A. B. P.s” shpk. ka sjellë deklaratë që OE G. SHPK i cili i vetëshpallur si distributor zyrtar i E, autorizon OE A. B. P.” sh.p.k si përfaqësues të ESRI për procedurën e prokurimit. OE G. SHPK nuk ka bashkëlidhur asnjë deklaratë të E ku e deklaroi si distributor zyrtar i tij për Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu në faqen zyrtare të E, ky operator nuk gjendet si distributor zyrtar për Republikën e Shqipërisë. Për sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk duhej të kishte kualifikuar OE A. B. P.” sh.p.k për procedurën e prokurimit në kushtet e mos plotësimit të kriterëve nga ana e OE

Kriteri: Nenin 75 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i riskut mbi realizimin e objektivave të procedurës së prokurimit.

Shkaku: Mos verifikimi dhe marrja në konsideratë e një deklaratë të dorëzuar nga OE fitues.

Rëndësia: E mesme

10.1 Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave, për garantimin e një procesi të drejtë dhe transparent për përzgjedhjen e OE të duhur, të marrë në shqyrtim dhe të kryej verifikimin e të gjithë dokumentacionit të dorëzuar nga OE pjesëmarrës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje znj. S. M., z. A. B. dhe z. J. T. për veprimet dhe mosveprimet jo në përputhje me Nenin 75 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Në faqen zyrtare të kompanisë E, në fushën e Partners, në linkun <https://www.esri.com/partners/G.-cmt-global-a2T7000000TNN0EAO> figuron partner Silver kompania ‘G. CMT Global’ me zyra qendrore në Zagreb, Kroaci. Në faqen zyrtare të G. (www.G..net), tek fusha Company/Overview, paragrafi Office Locations, në listën (dhe hartën) e zyrave, figuron ‘G. Tirana’, me adresë Rr.Gjin Bue Shpata 2/1, Tirane, Shqipëri, Tel +355-4-259-004. Fakti që kompania G. CMT Global figuron si Silver partner në Kroaci në faqen zyrtare të ESRI, është vetëm për arsyen se zyrat qendrore të kësaj kompanie ndodhen në Kroaci, por ka një rrjet prej 16 zyrash në të gjithë Evropën, dhe ndër këto zyra është edhe zyra në Shqipëri. Gjithashtu në mbështetje të këtyre fakteve, O.E. A. B. P. ka depozituar përveç deklaratës nga O.E G. shpk që autorizon O.E. A. B. P., edhe një dokument nga ESRI, ESRI Certificate Distributori për G. Technology Platforms D.o.o, me distributor për Shqipërinë ‘O.E. G. shpk Tirana’.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, del përsëri me rekomandimin e sipërcituar.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

11. Titulli i gjetjes: Përlllogaritja e gabuar e vlerës së fondit limit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e programit ArcGIS” për vitin 2022, për përcaktimin e fondit limit, është kryer studimi i tregut dhe është vendosur vlera prej 6.183.233 lekë pa TVSH si fond limit për zhvillimin procedurës së prokurimit. Në faqen zyrtare të ESRI, referuar specifikimeve teknike për licencat

ArcGIS for Aviation: Charting Single Use License dhe ArcGIS for Aviation: Airports Single Use License, janë në vlerën respektive 4,376\$ dhe 8,752\$, në total 13,128\$ ose 1,312,800 lekë (13,128\$ x 1.00 kursi zyrtar nëntor 2022). Gjithashtu për sa kohë nuk ka distributor zyrtar për Republikën e Shqipërisë, mbetet e paqartë se si është kryer studimi i tregut dhe përcaktimi i fondit limit.

Kriteri: Neni 13 “Studimi paraprak i tregut”, Vendim nr. 285, Datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Ndikimi/Efekti: Përdorimi i fondeve të shoqërisë Albcontrol, pa 3 E.

Shkaku: Përlllogaritja e fondit limit jo në mënyrën e duhur.

Rëndësia: E lartë

11.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës gjatë përlllogaritjes së fondit limit në të ardhmen, në lidhje me procedurat e prokurimit që kanë të bëjnë me licencat të sistemeve që Albcontrol SHA operon, për të cilat OE duhet të kenë autorizime nga kompanitë prodhuese, të kryejnë verifikimet përkatëse tek këto kompani dhe më pas tu adresohen OE që rezultojnë distributor zyrtar për kryerjen e studimit të tregut.

Njësia e hartimit të specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit znj. M. J., z. J. T. dhe z. J. V. në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Struktura e posaçme e caktuar për përlllogaritjen e fondit limit, është bazuar në nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet këto mundësi për përlllogaritjen e fondit limit: a) Çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/ dhe cmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose /dhe b) Studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose /dhe c) Çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose / dhe d) Çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht. Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve ekonomikë...

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit, del përsëri me rekomandimin e sipërcituar.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

“Kontratë blerje pjesë ndërrimi, mirëmbajtje teknike, rinovim licencash për sistemin VIOP,Cisco,Wireless,Telekonference”

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Kontrate blerje pjese ndërrimi, mirëmbajtje teknike, rinovim licencash për sistemin VIOP,Cisco,Wireless,Telekonference ” 2021		
Urdhër Prokurimi : Nr.1768, datë 01.11.2021		
3. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Urdh.nr.1768 prot., datë 01.11.2021 Znj. S. P. Znj. K. V. Z. F. H.	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Znj. M. J. Kryetare Z. J. T. Anëtare Z. J. V. Anëtare
4. Fondi limit (pa TVSH): 30.250.000 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Albcontrol SHA	6. Data e hapjes së tenderit: 17 .11.2021
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: OE S. A. Sh.p.k, L.....H B.OE I. S. sh.p.k, J.....C + I. sh.p.k, K.....K O.E I. sh.p.k, L.....H b) Kualifikuar: B.OE I. S. sh.p.k, J.....C + I. sh.p.k, K.....K	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.1768/1 datë 1.11.2021 Z. M. E. Kryetar Z. D. B. Anëtar Z. E. Ll. Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 29.604.315 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë shërbime nr.1768/4 prot., datë 15.12.2021	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 645.685 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : Znj. M. J. Kryetare Z. J. T. Anëtare Z. J. V. Anëtare	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 12 muaj

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Kërkesës nr.1529 prot., datë 16.09.2021, Drejtoria e Divizionit Teknik i është drejtuar sektorit të prokurimeve për të filluar procedura e prokurimit me objekt “Kontrate blerje pjese ndërrimi, mirëmbajtje teknike, rinovim licencash për sistemin VIOP, Cisco, Wireless, Telekonference”.

Me anë të Urdhrit të brendshëm nr.1529/1 prot., datë 16.09.2021 është ngritur grupi i punës për përlogaritjen e specifikimeve teknike. Me anë të urdhrin nr.1529/3 prot., datë 21.09.2021 është ngritur grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit. Grupi i punës me anë të procesverbalit nr.1529/4 prot., datë 24.09.2021 ka vendosur fond limit **30.250.000** (tridhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë lekë) pa TVSH.

Ky fond limit është përlogaritur duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

“I. S.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 32.577.600 lekë pa TVSH.
“S.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 28.852.400 lekë pa TVSH.
“S. I.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 29.320.000 lekë pa TVSH.

Në datë 11.10.2021, me anë të Urdhrit i Prokurimit nr.1768 prot. me objekt “Kontrate blerje pjese ndërrimi, mirëmbajtje teknike, rinovim licencash për sistemin VIOP, Cisco, Wireless, Telekonference ” u caktuan anëtarët e NJP.

Në datë 1.11.2021 me anë të urdhrin nr. 1768/1 prot., u ngrit KVO.

Në datën 15.10.2021, me iniciativën e Autoriteti Kontraktor, si dhe të ligjit nr.162/2020, AK vendosi të bëjë modifikimin e DST. Afati i ri për hapjen e ofertave ishte data 24.11.2021.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Urdhër nr.1768/1 datë 1.11.2021, ka mbajtur procesverbalin në datën 24.11.2021, për të dokumentuar hapjen e ofertave.

Në këtë procedurë janë paraqitur tre operator si mëposhtë:

I. S. sh.p.k, me NIPT **J.....C** + **I. sh.p.k**, me NIPT **K.....K** Oferta ekonomike : **29,604,315** lekë pa TVSH

S. A. sh.p.k me NIPT **L.....H** Oferta ekonomike : **30,240,000** leke pa TVSH

I. sh.p.k, me NIPT **L.....H** nuk ka paraqitur Oferte Ekonomike

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin nr.1768/1 datë 1.11.2021 ka mbajtur procesverbalin në datë 25.11.2021 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatoreve ekonomik. Pasi përfundoi vlerësimi i ofertave të paraqitura dhe pasi të gjithë anëtarët e KVO përfunduan procesin e vlerësimit të ofertave, sistemi i prokurimit elektronik tregoi renditjen përfundimtare si mëposhtë:

Vendi i parë :Operatori Ekonomik " **I. S. sh.p.k** + **I. SHPK**

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 26.11.2022 Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Gjithashtu në datën 15.10.2021, me iniciativën e Autoriteti Kontraktor, janë bërë modifikime në DST për procedurën e prokurimit nr.1768 prot. me objekt “Kontrate blerje pjese ndërrimi, mirëmbajtje teknike, rinovim licencash për sistemin VIOP,Cisco,Wireless,Telekonference”.

Konkretisht:

Në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, bëhet ndryshimi si vijon:
<p>Ishte: 2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë specializime për teknologjitë e sigurisë, aksesit dhe të telefonisë, me qëllim menaxhimin e rrjetit të Albcontrol, i cili është i ndërtuar në produkte dhe teknologji Cisco. Për të dëshmuar këtë aftësi, Operatori Ekonomik duhet të zotëroje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Specializimin “Advanced Security Architecture” ose ekuivalente me to. - Specializimin “Advanced Collaboration Architecture” ose ekuivalente me to. <p>Bëhet: Ky kriter hiqet nga kriteret e veçanta të kualifikimit</p>

Oferta e dërguar nga OE fitues i procedurës së prokurimit, jepet si më poshtë:

1	2	3	4	6
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)
1				
1.1	Rinovim suporti per pajisjet Router	1 cope	1,110,119	1,110,119
1.2	Rinovim suporti per pajisjet Sëitching	1 cope	1,854,732	1,854,732
1.3	Rinovim suporti per pajisjet fireëall dhe licencat e shërbimeve te ofruara (AMP, IPS, Remote VPN)	1 cope	1,915,523	1,915,523
1.4	Rinovim Suporti per zgjidhjet e sigurise (Email Security, Web Security dhe menaxhimi i tyre)	1 cope	5,245,705	5,245,705
1.5	Rinovim Suporti per zgjidhjen e kontrollit te aksesit te rrjetit dhe licencat perkatese	1 cope	1,136,356	1,136,356
1.6	Permiresimi i infrastruktures se rrjetit te Datacenterit	1 cope	426,316	426,316
2	Mirembajtje e sistemit IP Telefoni			
2.1	Rinovim suporti per serverat e Call Manager	1 cope	3,483,264	3,483,264
2.2	Rinovim suporti per Voice Gateway	1 cope	386,610	386,610
3	Mirembajtje e sistemit Ëireless dhe Telekonference			
3.1	Rinovim suporti per pajisjet Wireless	1 cope	90,678	90,678
3.2	Rinovim suporti per sistemin e teleprezences	1 cope	224,837	224,837
4	Permiresim/perditesim dhe Rinovim Suporti per Sistemet e Menaxhimit te Rrjetit	1 set	9,412,971	9,412,971
5	Suport teknik per mirembajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonference, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit te Rrjetit per periudhen 1 vjecare	12 muaj	359,767	4,317,204
	Çmimi total (Mallrat) 29,604,315			
	Çmimi Neto pa TVSH		29,604,315	
	TVSH (%)		5,920,863	
	Çmimi total me TVSH:		35,525,178	

12. Titulli i gjetjes: Dëm ekonomik i shkaktuar buxhetit të shoqërisë Albcontrol në vlerën **4,317,204 lekë pa tvsh**

Situata: Nga auditim i preventivit të procedurës së prokurimit me objekt “Kontrate blerje pjese ndërrimi, mirëmbajtje teknike, rinovim licencash për sistemin VIOP, Cisco, wireless, Telekonference”, u konstatua se zëri 5 “Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, ëireless, telefonat IP, Telekonference, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1 vjeçare”, është vendosur dy herë, njëherë si zë më vete dhe njëherë si pjesë e zërave të veçuar të preventivit, e cila ka sjellë që për rritje fiktive të shpenzimeve të bëra nga AK dhe përfitim të padrejtë nga BOE "I. S. sh.p.k + I. SHPK të vlerës 4,317,204 lekë pa TVSH.

Kriteri: Neni 21 dhe Kreu XV “Zbatimi i kontratës” i Ligjit nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”

Ndikimi/Efekti: Dëm i shkaktuar buxhetit të shoqërisë në vlerën 4,317,204 lekë pa tvsh

Shkaku: Vendosja e specifikimeve teknike jo në proporcion me objektin e kontratës

Rëndësia: E lartë

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Albcontrol SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **4,317,204 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit B.O.E "I. S. sh.p.k + I. SHPK, për mbivendosje të zërave të shërbimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet

Njësia e hartimit të specifikimeve teknike znj. M. J., z. J. T. dhe z. J. V. në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. M. E. , z. D. B. dhe z. E. Ll. për veprimet dhe mosveprimet jo në përputhje me Nenin 75 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, mbi kthimin e përgjigjes nga subjekti I. S. sh.p.k. protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 dhe 1045/5 datë 1306.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Zëri Rinovimi i suportit nga Prodhuesi përmban nëndarjet 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 2.1 të preventivit dhe konsiston në rinovimin e suportit të prodhuesit të produkteve Cisco. Duke qenë se disa nga pajisjet ishin jashtë garancie, mundësohet vendosja e tyre në garanci nga prodhuesi gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Vendosja në garanci nga prodhuesi siguron shërbim teknik më të mirë nga prodhuesi si edhe ofrohet garanci shtesë, pas përfundimit të garancisë në lëvrin. Sasia e këtyre zërave është 1 (një), pasi ky shërbim parabollet nga prodhuesi dhe është me afat 1-vjeçar. Zëri Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, wireless, telefonat IP, telekonferencë, shërbimet IT dhe sistemi i monitorimit të rrjetit për periudhën 1 vjeçare ka të bëjë me suportin teknik të operatorit ekonomik i cili me specialistët përkatës jep një nivel shërbimi të përcaktuar në Specifikimet Teknike nr.1523/2 datë 21.09.2021(bashkëlidhur)..

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe të Operatorit Ekonomik, pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit, del përsëri me rekomandimin e sipërcituar pasi nuk u sollën fakte dhe argumente shtesë të reja.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

• “Shërbim mirëmbajtje sistem finance, prokurimi, buxheti dhe e-ticket”

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Shpenzime mirembajtje sistem finance, prokurimi, buxheti dhe e-ticket ” 2022		
Urdhër Prokurimi : Nr.600, datë 23.02.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Urdh.Nr.600 prot., datë 23.02.2022 Znj. S. P. Znj. K. V. Z. F. H.	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Z. M. M. Kryetar Znj. M. J. Anëtare Znj. R. B. Anëtare
4. Fondi limit (pa TVSH): 24.920.000 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Albcontrol SHA	6. Data e hapjes së tenderit: 15 .03.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: O.E A. A. T. D.sh.p.k , L.....B OE D. L. sh.p.k, L.....S O.E I. B. S.sh.p.k , L.....G O.E I. sh.p.k, L.....L b) Kualifikuar: OE D. L. sh.p.k, L.....S	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdher Nr.600/1 datë 23.02.2022 Z. D. G. Kryetar Z. D. B. Anëtar Z. E. Ll. Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 23,880,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë sherbime nr.600/4 prot., datë 07.04.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 486,560 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : Z. M. M. Kryetar Znj. M. J. Anëtare Znj. R. B. Anëtare	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 12 muaj

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Kërkesës nr.448 prot., datë 11.02.2021, Drejtoria e Divizionit Teknik i është drejtuar sektorit të prokurimeve për të filluar procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime mirëmbajtje sistem finance, prokurimi, buxheti dhe e-ticket”

Me anë te Urdhrit të brendshëm nr.448/1 prot., datë 14.02.2021 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e specifikimeve teknike.

Me anë të urdhrin nr.448/3 prot., datë 17.02.2022 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit i përberë nga znj. H. P. Kryetare, znj.T. F. , z. R. M. Anëtare. Grupi i punës me anë të proces verbalit nr.448/4 prot., datë 22.02.2022 ka vendosur fond limit 24.920.000 (njëzet e katër milion e nëntëqind e njëzet mije lekë) pa TVSH.

Ky fond limit është përllogaritur duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

“A. A. T. D. ” Sh.P.K Paraqiti Ofertën E Tij Me Vlerë 26.160.000 Lekë Pa TVSH.
“I. & C. D.” Sh.P.K Paraqiti Ofertën E Tij Me Vlerë 23.760.000 Lekë Pa TVSH.
“I. ” Sh.P.K Paraqiti Ofertën E Tij Me Vlerë 24.840.000 Lekë Pa TVSH.

Në datë 23.02.2022, me anë të Urdhri i Prokurimit nr.600 prot. me objekt “**Shpenzime mirëmbajtje sistem finance, prokurimi, buxheti dhe e-ticket**” u caktuan anëtarët e NJP.

Në datë 23.02.2022 me anë të urdhrin nr. 600/1 prot., u ngrit KVO.

Në datën 04.03.2022, me iniciativën e Autoriteti Kontraktor, si dhe të ligjit nr.162/2020, AK vendosi të bëjë modifikimin e DST.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Urdhër nr.600/1 datë 23.02.2022, ka mbajtur procesverbalin në datën 15.03.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave.

Në këtë procedurë janë paraqitur tre operator si mëposhtë:

“A. A. T. D.” sh.p.k, me NIPT L.....B Oferta ekonomike **24,433,440** lekë pa TVSH

“D. L.” sh.p.k me NIPT L.....S Oferta ekonomike : **23,880,000** leke pa TVSH

“I. B. S.” sh.p.k, me NIPT L.....G Oferta ekonomike : **24,588,000** leke pa TVSH

“I.” sh.p.k, me NIPT L.....L Oferta ekonomike : **24,695,400** leke pa TVSH

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Urdhër nr.600/1 datë 23.02.2022 ka mbajtur procesverbalin në datë 17.03.2022 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentat e operatoreve ekonomik. Pasi përfundoi vlerësimi i ofertave të paraqitura dhe pasi të gjithë anëtarët e KVO përfunduan procesin e vlerësimit të ofertave, sistemi i prokurimit elektronik tregoi renditjen përfundimtare si mëposhtë:

Vendi i parë :Operatori Ekonomik **“D. L.” sh.p.k**

Vendi i dyte :Operatori Ekonomik **“A. A. T. D.” sh.p.k**

Vendi i dyte :Operatori Ekonomik **“I. B. S.” sh.p.k**

Vendi i dyte :Operatori Ekonomik **“I.” sh.p.k**

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 26.11.2022 Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Gjithashtu në datën 04.03.2022, me iniciativën e Autoriteti Kontraktor, janë bërë modifikime në DST për procedurën e prokurimit nr.600 prot.

Konkretisht:

Në pikën 2.3. të kapacitetit teknik, bëhet ndryshimi si vijon:
Ishte: 2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet te jete i specializuar ne fushën e shërbimeve të sistemeve të menaxhimit financiar (Financial Management Systems) Oracle E-Business Suite R12 ose ekuivalente. Kjo të dëshmohet nëpërmjet certifikatës se specializimit.
Bëhet: Ky kriter hiqet nga kriteret e veçanta të kualifikimit
Në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, bëhet ndryshimi si vijon:
Ishte: 2.3.5 Operatori ekonomik, duhet te jete i specializuar ne fushën e shërbimeve te sistemeve te Zinxhirit te furnizimeve (Supply Chain) Oracle E-Business Suite R12 ose ekuivalente. Kjo te dëshmohet nëpërmjet certifikatës se specializimit.
Bëhet: Ky kriter hiqet nga kriteret e veçanta të kualifikimit

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Ndryshimet në DST për heqjen e kriterëve janë bërë nga rekomandimi dhe asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) jep për autoritetet kontraktore, në mbështetje të nenit 23 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika ç), ku parashikohet se: “Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione: ç) jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik”

Konkretisht, për këtë procedurë prokurimi, APP pas verifikimit të dokumentave të tenderit, ka udhëzuar ALBCONTROL SHA si vijon: “APP rekomandon që AK, duke iu përmbajtur rigorozisht përcaktimeve të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik dhe për fusha të tjera ku procedura shtrin ndikimin, apo kuptimit të tyre, duhet të saktësojë/riformulojë kriteret në vijim, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen në plotesimin e kriterit nga OE ofertues apo që mbarten edhe në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kriterit nga KVO. Konkretisht, Në pikën 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.3.5 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: 2.3.3 Operatori ekonomik, duhet të ketë marrëdhënie partneriteti aktive me prodhuesin Oracle. Kjo duhet të dëshmohet nëpërmjet certifikates se partneritetit origjinal ose kopjes të noterizuar të certifikates, të lëshuar nga prodhuesi Oracle. 2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të jetë i specializuar në fushën e shërbimeve të sistemeve të menaxhimit financiar (Financial Management Systems) Oracle E-Business Suite R12 ose ekuivalent. Kjo të dëshmohet nëpërmjet certifikatës së specializimit. 2.3.5 Operatori ekonomik, duhet të jetë i specializuar në fushën e shërbimeve të sistemeve të Zinxhirit të Furnizimeve (Supply Chain) Oracle E-Business Suite R12 ose ekuivalent. Kjo të dëshmohet nëpërmjet certifikatës së specializimit. Sugjerojmë rivlerësimin e kërkesave për partneritet apo specializim si më lart kërkuar, pasi AK ka kërkuar punonjës të specializuar për teknologji Oracle, gjë e cila garanton ekspertizën e operatorëve ekonomikë për ekzekutimin e kontratës, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 77 pika 1 të LPP 162, i cili citon se: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, merr në konsideratë observacionin.

Për sa më sipër observacioni merret në konsideratë.

13.Titulli i gjetjes: Mbulimi i shërbimit pa autorizim nga Oracle

Situata: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Shpenzime mirëmbajtje sistem finance, prokurimi, buxheti dhe e-ticket” për vitin 2022, për përmbushjen e qëllimit të procedurës së prokurimit, nevojitet dhe autorizimi nga ana e Oracle për OE pjesëmarrës në garë, i cili nga analizimi i dokumentacionit të sjellë, rezulton që ka autorizim të vlefshëm deri më datë 15 Janar 2024, si dhe nga hulumtimet e grupit të auditimit në faqen zyrtare të Oracle, nuk rezulton që OE D. L. SHPK të ketë autorizim aktiv. Kjo situatë sjell që shërbimi të mbulohej pa një licenca aktive nga OE D. L. SHPK

Në lidhje me përcaktimin e fondit limit dhe ofertave të dhëna, mungojnë detaje thelbësore mbi përcaktimin e saktë të vlerës së shërbimit, si numri i licencave (userave), pasi dhe në faqe zyrtare të oracle, tarifat e shërbimit përcaktohen nga numri i kërkuar i licencave (userave) që do të përdorin shërbimin.

Kriteri: Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Ndikimi/Efekti: Risk mbi ofrimin e shërbimit nga OE fitues.

Shkaku: OE i kësaj procedure nuk ka riaktivizuar licencën për periudhën e mbulimit të shërbimit.

Rëndësia:E lartë

13.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe përlogaritjes së fondit limit, të përfshijnë detaje të cilat janë të rëndësishme dhe themelore për përcaktimin e drejtë të koston dhe vlerës së procedurës së prokurimit. Gjithashtu titullari i institucionit të ngrejë

një grup pune për verifikimin e afateve të licencave të OE fitues i cili mbulon këtë shërbim, dhe në rast të mos ekzistencës së tyre të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e situatës.

Njësia e hartimit të specifikimeve teknike z. M. M., znj. M. J. dhe znj. R. B. në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Operatori ekonomik D. L. shpk ka paraqitur në ofertë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), certifikatën e partneritetit të D. L. me Oracle me afat vlefshmërie deri me 15 Janar 2023, për procedurën e zhvilluar më datë 15.03.2022, si dhe për kontratën e lidhur më datë 07.04.2022 me afat 12 mujor (bashkëlidhur dokumenti). Gjithashtu, gjatë SLA, është dërguar dhe dokumenti për aktivizimin e licensave software nga prodhuesi Oracle, ku konstatohet periodha e vlefshmërisë deri më datë 30.04.2023 (bashkëlidhur dokumenti).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, qëndron me të njëjtin rekomandim.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

“Rishikimi i procedurave të afrimit RNP dhe SID RNAV të Aeroportit të Tiranës”

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rishikimi i procedurave të afrimit RNP dhe SID RNAV të Aeroportit të Tiranës” 2022		
Urdhër Prokurimi : Nr.1586, datë 16.06.2022		
2. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar ”	2. Njësia e Prokurimit Urdh. Nr.1586 prot., datë 16.06.2022 Znj. S. P. Znj. K. V. Z. K. N.	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Urdh. Nr.1430/1 datë 30.09.2022 Z. I. Zh. Kryetar Z. D. K. Anëtar Z. I. Sh. Anëtar
4. Fondi limit (pa TVSH): 20.883.333 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Albcontrol SHA	6. Data e hapjes së tenderit: 07.07.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: BOE “R. F. & A. E.” shpk dhe “E.” S.P.A b) Kualifikuar: BOE “R. F. & A. E.” shpk dhe “E.” S.P.A	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdher Nr.1586/1 datë 16.06.2022 Z. D. I. Kryetar Z. D. B. Anëtar Z. E. L. Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 15.645.833 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë furnizimi nr.1586/4 prot., datë 19.07.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 5.187.500 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : Urdh. Nr1586/5 prot., datë 19.07.2022 Z. I. Zh. Kryetar Z. D. K. Anëtar Z. I. Sh. Anëtar	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 6 muaj

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Kërkesës nr.1430 prot., datë 23.05.2022, Drejtoria e Divizionit Operacional i është drejtuar sektorit të prokurimeve për të filluar procedura e prokurimit me objekt “**Rishikimi i procedurave të afrimit RNP dhe SID RNAV të Aeroportit të Tiranës**”.

Me anë te Urdhrit të brendshëm nr.1430/1 prot., datë 30.09.2022 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e specifikimeve teknike. Me anë të urdhrorit nr.1430/3 prot., datë 06.06.2022 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit. Grupi i punës i përbërë nga znj. V. I. Kryetare, znj. H. P. Anëtare dhe z. R. M. Anëtar me anë të proces verbalit nr.1430/4 prot., datë 14.06.2022

ka vendosur fond limit **20.883.333** (njëzet milionë e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre lekë) pa TVSH.

Ky fond limit është përlllogaritur duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

4. "A. C." sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 21.666.666 lekë pa TVSH.
5. "O. T. C. & S." sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 20.000.000 lekë pa TVSH.
6. "R. F. & A. E." sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 20.833.333 lekë pa TVSH.

Në datë 16.06.2022, me anë të Urdhri i Prokurimit nr.1586 prot." u caktuan anëtarët e NJP.

Në datë 16.06.2022 me anë të urdhrin nr. 1586/1 prot., u ngrit KVO.

Në datën 20.06.2022, Njësia e Prokurimit përcaktoi kriteret kualifikuese, që u vendosën në DST për procedurën e prokurimit me nr.1586 prot.

Në datën 23.06.2022, Njësia e Prokurimit ka bërë ndryshimin e dokumenteve të tenderit. Afati për pranimin e ofertave nuk ka ndryshuar duke lënë datën 07.07.2022.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.1586/1 datë 16.06.2022, ka mbajtur procesverbalin në datën 07.07.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave.

Në këtë procedurë është paraqitur vetëm një ofertë ekonomike nga bashkimi i operatorëve ekonomik si mëposhtë:

BOE "**R. F. & A. E.**" shpk dhe "**E.**" S.P.A me ofertë ekonomike 15.645.833 lekë pa TVSH.

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin nr. 1586/1 datë 16.06.2022 ka mbajtur procesverbalin në datë 12.07.2022 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin dokumentet për Kriteret e Përgjithshme për bashkimin e operatorëve ekonomik. B.OE i plotësonin Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit.

Nga vlerësimi i dokumenteve teknike dhe ekonomike rezultoi se B.OE i plotësonin të gjitha kriteret e përcaktuara në DST.

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, më datë 18.07.2022 me anë të shkresës nr.1586/2 prot., Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Nga kjo procedurë prokurimi fitues është shpallur oferta ekonomike e BOE "**R. F. & A. E.**" shpk dhe "**E.**" S.P.A me ofertë ekonomike 15.645.833 lekë pa TVSH

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Në datë 19.07.2022 është lidhur kontratë furnizimi nr.1586/4 prot., me BOE “R. F. & A. E.” shpk dhe “E.” S.P.A. Kjo kontratë do të ndiqet nga grupi i punës i ngritur me Urdh. Nr1586/5 prot., datë 19.07.2022.

- **“Rishikimi i procedurave instrumentale afrimit e uljes me VOR e ILS, aeroportit të Tiranës, përfshirë rrugët standarde afrimit (STAR) e ngritjes (SID)”**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Rishikimi i procedurave instrumentale afrimit e uljes me VOR e ILS, aeroportit të Tiranës, përfshirë rrugët standarde afrimit (STAR) e ngritjes (SID) 2021		
Urdhër Prokurimi : Nr.1739, datë 25.10.2021		
3. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Urdh.Nr.1739 prot., datë 25.10.2021 Znj. S. P. Znj. K. V. Z. F. H.	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Urdh. Nr.1480/1 datë13.09.2021 Z. D. K. Kryetar Z. I. Zh. Anëtar Z. E. M. Anëtar
4. Fondi limit (pa TVSH): 14.166.666 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Albcontrol SHA	6. Data e hapjes së tenderit: 10.11.2021
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: OE “T. M. C.” shpk B.P.OE “R. F. & A. E.” shpk dhe “E.” S.P.A OE “R. A. S.” S.R.L b) Kualifikuar: OE “T. M. C.” shpk B.P.OE “R. F. & A. E.” shpk dhe “E.” S.P.A	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdher Nr.1739/1 datë 25.10.2021 Z. D. I. Kryetar Z. D. B. Anëtar Z. E. Ll. Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 13.458.332 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë furnizimi nr.1739/4 prot., datë 10.12.2021	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 708.334 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : Urdh. Nr.1739/5 datë 10.12.2021 Z. D. I. Kryetar Z. I. Zh. Anëtar Z. D. K. Anëtar	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 9 muaj

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Kërkesës nr.1480 prot., datë 13.09.2021, Drejtorja e Divizionit Operacional i është drejtuar sektorit të prokurimeve për të filluar procedura e prokurimit me objekt **“Rishikimi i procedurave instrumentale afrimit e uljes me VOR e ILS, aeroportit të Tiranës, përfshirë rrugët standarde afrimit (STAR) e ngritjes (SID)”**.

Me anë te Urdhrit të brendshëm nr.1480/1 prot., datë 13.09.2021 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e specifikimeve teknike. Me anë të urdhrin nr.1480/3 prot., datë 20.09.2021 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit. Grupi i punës i përbërë nga znj. H. P. Kryetare , znj. R. D. Anëtare dhe znj.V. I. Anëtare me anë të proces verbalit nr.1480/4 prot., datë 27.09.2021 ka vendosur fond limit **14.166.666** (katërmëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë lekë) pa TVSH. Ky fond limit është përllogaritur duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

“C. & M. A.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 12.915.000 lekë pa TVSH.
“D. N.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 13.735.000 lekë pa TVSH.
“E.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 15.850.000 lekë pa TVSH.

Në datë 25.10.2021, me anë të Urdhri i Prokurimit nr.1739 prot. me objekt **“Rishikimi i procedurave instrumentale afrimit e uljes me VOR e ILS, aeroportit të Tiranës, përfshirë rrugët standarde afrimit (STAR) e ngritjes (SID)”** u caktuan anëtarët e NJP.

Në datë 25.10.2021 me anë të urdhrin nr. 1739/1 prot., u ngrit KVO.

Në datë 25.10.2021 Njësia e Prokurimit përcaktoi kriteret kualifikuese që u vendosën në DST për procedurën e prokurimit me nr.1379 prot., me fond limit **14.166.666** (katërbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë lekë) pa TVSH , me afat 9 muaj. Data e hapjes së ofertave ishte 10.11.2021

Në datën 29.10.2021, me iniciativën e Autoriteti Kontraktor, si dhe në mbështetje të ligjit nr.162/2020, neni 75,pika 2 AK vendosi të bëjë modifikimin e DST..

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Urdher nr.1739/1 datë 25.10.2021, ka mbajtur procesverbalin në datën 10.11.2021, për të dokumentuar hapjen e ofertave.

Në këtë procedurë ishin paraqitur 3 (tre) operator si mëposhtë:

- 1.Operatori Ekonomik "**T. M. C.**" **shpk** me ofertë ekonomike **13.900.000** lekë pa TVSH
- 2.Bashkimi i përkohshëm i Operatorëve Ekonomik "**R. F. & A. E.**" **shpk** dhe "**E.**" **S.P.A** me ofertë ekonomike 13.458.332 lekë pa TVSH.
- 3.Operatori Ekonomik "**R. A. S.**" **S.R.L** ky operator nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin nr.1739/1 datë 25.10.2021 ka mbajtur procesverbalin në datë 22.11.2021 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatorit ekonomik. Pasi përfundoi vlerësimi i ofertës së paraqitur dhe pasi të gjithë anëtarët e KVO përfunduan procesin e vlerësimit të ofertës, sistemi i prokurimit elektronik tregoi renditjen përfundimtare si mëposhtë:

Vendi i parë: Bashkimi i përkohshëm i Operatorëve Ekonomik "**R. F. & A. E.**" **shpk** dhe "**E.**" **S.P.A** me ofertë ekonomike 13.458.332 lekë pa TVSH.

Vendi i dytë: Operatori Ekonomik "**T. M. C.**" **shpk** me ofertë ekonomike 13.900.000 lekë pa TVSH

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 24.11.2022 me anë të shkresës nr.1739/2 prot. Njësia e Prokurimit ka nxjerrë Formularin e njoftimit të fituesit.

Fitues është shpallur oferta ekonomike me e ulët nga ana e Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik "**R. F. & A. E.**" **shpk** dhe "**E.**" **S.P.A** me ofertë ekonomike 13.458.332 lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Në datën 10.12.2021 është lidhur kontrata e shërbimit nr. 1739/4 prot., midis Autoriteti Kontraktues dhe Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik “R. F. & A. E.” shpk dhe “E.” S.P.A me një afat kohor 9 muaj.

Për ndjekjen e kësaj kontrate është ngritur grupi i punës me anë të shkresës nr. 1739/5 datë 10.12.2021.

Në datën 31.12.2021 me anë të urdhrin të brendshëm nr.2159 është bërë zëvendësimi i anëtarit për ndjekjen e kontratës z. E. M. me z. D. K..

14. Titulli i gjetjes Kualifikim i OE me mungesë dokumentacioni

Situata: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt: “*Rishikimi i procedurave instrumentale afrimit e uljes me VOR e ILS, aeroportit të Tiranës, përfshirë rrugët standarde afrimit (STAR) e ngritjes (SID)*” B.OE fitues “R. F. & A. E.” shpk dhe OE “E.” S.P.A në dokumentacionin e sjellë, ka dorëzuar një kontratë për përcaktimin e punëve/shërbimeve që secili OE do të kryej për kontratën me objekt “Rishikimi i procedurave instrumentale afrimit e uljes me VOR e ILS, aeroportit të Tiranës, përfshirë rrugët standarde afrimit (STAR) e ngritjes (SID)”. Sipas kësaj marrëveshje OE “R. F. & A. E.” shpk do angazhohet vetëm për Menaxhimin e Projektit. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE fitues rezulton se OE “R. F. & A. E.” shpk që ishte i angazhuar vetëm për rolin e menaxherit te projektit nuk ka dorëzuar dokumentacion mbështetës që përmbush rolin e tij në këtë bashkëpunim, por ky dokumentet që përkon me certifikatën për “Menaxhim Projektit” është paraqitur nga OE E. S.P.A dhe jo nga OE R. F. & A. E.” shpk që është angazhuar për ta realizuar. Për sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk duhej të kishte kualifikuar BOE “R. F. & A. E.” shpk dhe OE “E.” S.P.A për procedurën e prokurimit në kushtet e mos plotësimit të kriterëve nga ana e OE.

Kriteri: Neni 75 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021.

Ndikimi/Efekti: Risku për arritjen e objektivave të procedurës së prokuruar.

Shkaku: Kualifikimi i OE që nuk përmbushin kriteret e deklaruara.

Rëndësia: E lartë

17.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar nga OE pjesëmarrës në garë, të kryejnë një vlerësim të drejtë dhe transparent, si dhe të kryejnë verifikimet përkatëse mbi deklaratat e dhëna nga operatorët ekonomik.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. D. I., z. D. K. dhe z. E. Ll. për veprimet dhe mosveprimet jo në përputhje me Nenin 75 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcntrrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Fusha e veprimtarisë së ALBCNTRROL SHA “Lundrimi Ajror”, është mjaft specifike dhe si rrjedhojë sistemet me të cilat operon duhet të jenë kompatibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtarë të Aviacionit Civil si dhe me kërkesat e tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret dhe me sistemet e tjera që janë operative. Duke e parë në këtë këndvështrim, hartohen specifikimet teknike dhe kriteret e përzgjedhjes, por pa shkelur parimet bazë të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik. Pavarësisht se B.O.E ka përcaktuar që O.E “R. F. & A. E.” sh.p.k do të bëjë menaxhim projekti kundrejt ALBCNTRROL SHA, duke iu referuar edhe marrëveshjes së bashkimit të përkohshëm të operatorëve, vërejmë se në paragrafin që ka të bëjë me pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit në bashkëpunimin e përkohshëm, theksohet se pavarësisht ndarjes së punëve, palët do të jenë përgjegjëse përballë AK për implementimin në mënyrë korrekte dhe dërgimin në kohë të objektit të kontraktuar, shërbimit sipas specifikeve teknike si dhe ekzekutimi final i kontratës do të bëhet dhe është përgjegjësi e OE E. S.p.A. Duke qenë se është një nga kompanitë lider në kryerjen e këtyre llojeve shërbimeve siç konstatohet edhe nga Formulari i vetëdeklarimit ku ka deklaruar punonjësit e specializuar për

menaxhimin e projektit si dhe të realizimit të kontratës, duke plotësuar çdo kriter të vendosur nga Autoriteti Kontraktor. Duke iu referuar edhe ndarjes së kuotave, sipas të cilave ka një vlerë 30 % të projektit, gjykojmë se përgjegjësia dhe realizimi i kontratës sipas standardeve dhe specifikimeve teknike kërkohet të kryhet nga O.E E. S.p.A. **Qëndrimi i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, qëndron me të njëjtin rekomandim.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

“Trajnimi për ATCO AFIS Kukës”

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Trajnimi për ATCO AFIS Kukës” 2022		
Urdhër Prokurimi : Nr.1503, datë 03.06.2022		
4. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”	2. Njësia e Prokurimit Urdh. Nr.1503 prot., datë 03.06.2022 Znj. S. P. Znj. K. V. Z. K. N.	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Urdh. Nr.1194/1 datë 07.04.2022 Z. A. S. Kryetar Z. P. Xh. Anëtar Znj. B. B. Anëtare
4. Fondi limit (pa TVSH): 26.666.666 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Albcontrol SHA	6. Data e hapjes së tenderit: 07.07.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: OE “C. & M. A.” shpk b) Kualifikuar: OE “C. & M. A.” shpk	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdher Nr.1503/1 datë 03.06.2022 Z. D. I. Kryetar Z. D. B. Anëtar Z. E. Ll. Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 26.400.000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë furnizimi nr.1503/4 prot., datë 08.07.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 266.666 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : Urdh. Nr1503/5 prot., datë 08.07.2022 Z. A. S. Kryetar Z. P. Xh. Anëtar Znj. B. B. Anëtare	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 6 muaj

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Kërkesës nr.1194 prot., datë 05.04.2022, Drejtoria e Divizionit Operacional i është drejtuar sektorit të prokurimeve për të filluar procedura e prokurimit me objekt “**Trajnimi për ATCO AFIS Kukës**”.

Me anë te Urdhrit të brendshëm nr.1194/1 prot., datë 07.04.2022 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e specifikimeve teknike për prokurimin. Me anë të urdhrit nr.1194/3 prot., datë 30.05.2022 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit. Grupi i punës i përbërë nga znj. H. P. Kryetare, znj.V. Ll. Anëtare dhe znj. T. F. Anëtare me anë të proces verbalit nr.1194/4 prot., datë 01.06.2022 ka vendosur fond limit **26.666.666** (njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë lekë) pa TVSH.

Ky fond limit është përllogaritur duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

7. “A.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 25.500.000 lekë pa TVSH.
8. “R.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 26.400.000 lekë pa TVSH.
9. “E.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 28.100.000 lekë pa TVSH.

Në datë 03.06.2022, me anë të Urdhri i Prokurimit nr.1503 prot. u caktuan anëtarët e NJP.

Në datë 03.06.2022 me anë të urdhrit nr. 1503/1 prot., u ngrit KVO.

Në datën 06.06.2022, Njësia e Prokurimit përcaktoi kriteret kualifikuese, që u vendosën në DST për procedurën e prokurimit nr.1503 prot.

Në datën 17.06.2022, Njësia e Prokurimit ka bërë ndryshimin e dokumenteve të tenderit. Afati për pranimin e ofertave nuk ka ndryshuar duke lënë datën 30.06.2022.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.1503/1 datë 03.06.2022, ka mbajtur procesverbalin në datën 30.06.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë është paraqitur vetëm një ofertë ekonomike nga operatori ekonomik si mëposhtë:

· OE “**C. & M. A.**” shpk me ofertë ekonomike 26.400.000 lekë pa TVSH.

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin nr. 1503/1 datë 03.06.2022 ka mbajtur procesverbalin në datë 01.07.2022 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave për procedurën e prokurimit.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin dokumentat për Kriteret e Përgjithshme për operatorin ekonomik. OE i plotësonin Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit. Nga vlerësimi i dokumenteve teknike dhe ekonomike rezultoi se OE i plotësonin të gjitha kriteret e përcaktuara në DST.

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 06.07.2022 me anë të shkresës nr.1503/2 prot., Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Nga kjo procedurë prokurimi fitues është shpallur oferta ekonomike e OE “**C. & M. A.**” shpk me ofertë ekonomike 26.400.000 lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Në datë 08.07.2022 është lidhur kontratë furnizimi nr.1503/4 prot., me OE “**C. & M. A.**” shpk. Kjo kontratë do të ndiqet nga grupi i punës i ngritur me Urdh. Nr1503/5 prot., datë 08.07.2022.

Për sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar:

- Kohëzgjatja/Plani është jo më shumë se 9 javë (teori dhe SIM) si dhe nr. i Pjesëmarrësve është 5 kandidatë për kualifikime AFISO, që do të thotë investimi për një kandidatë është në vlerën 5,280,000 lekë për 9 javë.
- Në lidhje me dokumentacionin e dërguar nga OE fitues, për përmbushjen e kriterit për punë të ngjashme deri në vlerën 40% të fondit limit, dokumentacioni i sjellë nga OE janë kontratat e

ezauruara midis OE dhe Albcontrol SHA, ku lindin dyshime mbi lidhjen e kontratës së parë me Albcontrolin me nr. 2185/4 Prot., në vitin 2019 në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri.

Në lidhje me përcaktimin e fondit limit, në lidhje me ofertat e marra në treg, dy nga tre OE që është marrë oferta nuk e kanë për objekt fushën e trajnimit të personelit, duke e mos kryer një analizë të saktë mbi përcaktimin e fondit limit.

15. Titulli i gjetjes: Përlllogaritja në mënyrë të gabuar të fondit limit.

Situata: Gjatë auditimit të procedurës me objekt: “Trajnimi për ATCO AFIS Kukës” për vitin 2022, u konstatua që kohëzgjatja/plani është jo më shumë se 9 javë (teori dhe SIM) si dhe nr. i Pjesëmarrësve është 5 kandidatë për kualifikime AFISO, që do të thotë investimi për një kandidatë është në vlerën 5,280,000 lekë për 9 javë.

Në lidhje me dokumentacionin e dërguar nga OE fitues, për përmbushjen e kriterit për punë të ngjashme deri në vlerën 40% të fondit limit, dokumentacioni i sjellë nga OE janë kontratat e ezauruara midis OE dhe Albcontrol SHA, ku lindin dyshime mbi lidhjen e kontratës së parë me Albcontrolin me nr. 2185/4 Prot., në vitin 2019 në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri.

Gjithashtu për përlllogaritjen e fondit limit është bërë studimi i tregut duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

1. “A.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 25.500.000 lekë pa TVSH.

2. “R.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 26.400.000 lekë pa TVSH.

3. “E.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 28.100.000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me studimin e tregut u konstatua në lidhje me ofertat e marra në treg, dy nga tre OE që është marrë oferta nuk e kanë për objekt fushën e trajnimit të personelit, duke e mos kryer një analizë të saktë mbi përcaktimin e fondit limit.

Kriteri: Nenin 76 shkronja b të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik" , neni 2 i ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 dhe Nenin 2 shkronja b të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020

Ndikimi/Efekti: Përlllogaritje të gabuar të fondit limit.

Shkaku: Marrja e ofertave në treg nga operatore ekonomik që nuk kanë për objekt fushën e procedurës së prokuruar.

Rëndësia: E lartë

15.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës gjatë përlllogaritjes së fondit limit në të ardhmen, në lidhje me procedurat e prokurimit që kanë të bëjnë me trajnimet për punonjësit e Albcontrol SHA, në rastin kur përdoret studimi i tregut për përcaktimin e fondit limit, të përzgjidhen OE të cilët e kanë për objekt fushën e trajnimit të personelit sipas objektit të caktuar nga Albcontrol SHA

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit i përbërë nga znj. H. P. kryetare , znj.V. Ll. anëtare dhe znj. T. F. në mospërputhje me Nenin 13 “Studimi paraprak i tregut”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): ALBCONTROL SHA, si ofruesi i vetëm i shërbimeve të lundrimit ajror në Republikën e Shqipërisë është i detyruar të sigurojë: • Infrastrukturën e kërkuar navigacionale; • Shërbimin e trafikut ajror (ATS); • Shërbimin e Komunikimit, Navigimit dhe Survejimit (CNS); • Shërbimin Meteorologjik (MET); • Shërbimin e Informacionit Aeronautik. ALBCONTROL SHA, operon në një fushë që është shumë specifike që është “Lundrimi Ajror” dhe në funksion të objektit të veprimtarisë së saj për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror: ATS, CNS, AIS dhe MET, duhet të sigurojë trajnimin dhe kualifikimin e personelit përkatës për këto shërbime në përputhje me kërkesat rregullative. Në këtë kuadër, në bazë të Rregullores së Komisionit Evropian (EU) Nr.340/2015 të transpozuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.91 date 21.02.2019, kërkohet që stafi i cili do

të kryejë detyrat dhe funksionet e Kontrollorit të Trafikut Ajror, të ketë përfunduar me sukses: Trajnimin Fillestar, Trajnimin e Rangut, Nivelin e Mjaftueshëm të Aftësisë Gjuhësore dhe Trajnimin në Vendin e Punës.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, qëndron me të njëjtin rekomandim.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

“Trajnim për 30 kontrolloret e rinj Bazik, TËR VIA dhe ACC AREA”

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Trajnim për 30 kontrolloret e rinj Bazik, TËR VIA dhe ACC AREA” 2023		
Urdhër Prokurimi : Nr.1002, datë 08.05.2023		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar ”	2. Njësia e Prokurimit Urdh.Nr.1002 prot., datë 08.05.2023 Znj. S. P. Znj. K. V. Z. A. S.	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Urdh. Nr.882/1 datë 19.04.2023 Z. Gj. B. Kryetar Znj. B. B. Anëtare Z. G. L. Anëtar
4. Fondi limit (pa TVSH): 208.333.333 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Alcontrol SHA	6. Data e hapjes së tenderit: 09.06.2023
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: B.P.OE"A. T. D." shpk dhe "C. & M. A." shpk b) Kualifikuar: B.P.OE"A. T. D." shpk dhe "C. & M. A." shpk	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdher Nr.1002/1 datë 08.05.2023 Z. D. I. Kryetare Z. I. B. Anëtar Z. E. Ll. Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 199.800.000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë shërbimi nr.1002/4 prot., datë 16.06..2023	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 8.533.333 lekë	12. Ankimime S'ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : Urdh. Nr.1002/5 datë 16.06.2023 Z. Gj. B. Kryetar Znj. B. B. Anëtare Z. G. L. Anëtar	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 12 muaj

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Kërkesës nr.882 prot., datë 19.04.2023, Drejtoria e Trajnimit dhe Licencimit i është drejtuar sektorit të prokurimeve për të filluar procedura e prokurimit.

Me anë të Urdhrit të brendshëm nr.882/1 prot., datë 19.04.2023 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e specifikimeve teknike. Me anë të urdhit nr.882/3 prot., datë 25.04.2023 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit. Grupi i punës i përbërë nga znj. H. P. kryetare , znj.V. I. anëtare dhe znj. T. F. anëtare me anë të proces verbalit nr.882/4 prot., datë 04.05.2023 ka vendosur fond limit **208.333.333** (dyqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre lekë) pa TVSH.

Ky fond limit është përllogaritur duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

1.“N.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 213.000.000 lekë pa TVSH.
2.“A. T. D.” shpk paraqiti ofertën e tij me vlerë 208.500.000 lekë pa TVSH.
3.“I.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 203.500.000 lekë pa TVSH.

Në datë 08.05.2023, me anë të Urdhri i Prokurimit nr.1002 prot. me objekt **“Shpenzime për Flight Check”** u caktuan anëtarët e NJP.

Në datë 08.05.2023 me anë të urdhit nr. 1002/1 prot., u ngrit KVO.

Në date 03.05.2023 Njësia e Prokurimit Publik ka mbajtur proces verbalin për *argumentimin e mos ndarjes së procedurës në lote.*

Në datë 09.05.2023 Njësia e Prokurimit përcaktoi kriteret kualifikuese që u vendosën në DST për procedurën e prokurimit me nr.1002 prot., me fond limit **208.333.333** (dyqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre lekë) pa TVSH, me afat 12 muaj. Data e hapjes së ofertave ishte 09.06.2023.

Në datë 18.05.2023 Autoriteti Kontraktues ka bërë ndryshime në DST tek sektori kriteret të veçanta të kualifikimit, afati për hapjen e ofertave nuk ka ndryshuar.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdher nr.1002/1 datë 08.05.2023, ka mbajtur procesverbalin në datën 09.06.2023, për të dokumentuar hapjen e ofertave.

Në këtë procedurë është paraqitur vetëm një operator ekonomik si mëposhtë:

1.Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik "**A. T. D.**" shpk dhe "**C. & M. A.**" shpk përfaqësuar nga OE "**A. T. D.**" shpk sipas marrëveshjes së bashkëpunimit lidhur në datë 31.05.2023 me ofertë ekonomike **199.800.000** lekë pa TVSH.

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin nr.1002/1 datë 08.05.2023 ka mbajtur procesverbalin në datë 12.06.2023 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin dokumentet e operatorit ekonomik. Pasi përfundoi vlerësimi i ofertës së paraqitur dhe pasi të gjithë anëtarët e KVO përfunduan procesin e vlerësimit të ofertës, sistemi i prokurimit elektronik tregoi renditjen përfundimtare si mëposhtë:

1.Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik "**A. T. D.**" shpk dhe "**C. & M. A.**" shpk me ofertë ekonomike **199.800.000** lekë pa TVSH.

Publikimi i formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 12.06.2023 me anë të shkresës nr.1002/2 prot. Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë formularin e njoftimit të fituesit.

Fitues është shpallur oferta ekonomike e B.P.OE"**A. T. D.**" shpk dhe "**C. & M. A.**" shpk me ofertë ekonomike **199.800.000** lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Në datën 16.06.2023 është lidhur kontrata e shërbimit nr.1002/4 prot., midis Autoriteti Kontraktues dhe B.P.OE"**A. T. D.**" shpk dhe "**C& M A**" shpk me ofertë ekonomike **199.800.000** lekë pa tvsh për një afat kohor 12 muaj.

Për ndjekjen e kësaj kontrate është ngritur grupi i punës me anë të shkresës nr.1002/5 datë 16.06.2023.

Për sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar:

Kohëzgjatja/Plani është

- Jo më pak se 22 (njëzet e dy) javë (Basic – Rating - ELPAC).
- Basic jo më pak se 13 javë, Rating jo më pak se 8 javë, ELPAC 1javë
- Periudha e përshtatshme për fillimin e kursit do të jetë 6-mujori i parë i vitit 2023 në marrëveshje midis palëve si dhe nr. i Pjesëmarrësve është 30 kandidatë për kualifikime, që do të thotë investimi për një kandidatë është në vlerën 6,660,000 lekë.
- Në lidhje me dokumentacionin e dërguar nga B.OE fitues, në lidhje me përmbushjen e kriterit për punë të ngjashme jo më të vogël se 40% të fondit limit, dokumentacioni i sjellë nga OE A T D A. T. D. SHPK, është një faturë e lëshuar me datë 02.06.2023, pa një kontratë të bashkëlidhur, disa ditë përpara dorëzimit të dokumenteve me vlerë 63,000,000 lekë pa tvsh, me objekt: “Trajnim DSE;AED;LOTO;ATEX/EX;COSHH;PMI/PPE;RPE;FTT;BBS; IOSH 6 MUAJ PER STAFIN”. Vlera e faturës prej 63,000,000 lekë pa tvsh nuk e përmbush kriterin e vendosur, pasi vlera është sa 30% e fondit limit.
- Në lidhje me përcaktimin e fondit limit, në lidhje me ofertat e marra në treg, OE N. sh.p.k që është marrë oferta nuk e ka për objekt fushën e trajnimit të personelit, duke e mos kryer një analizë të saktë mbi përcaktimin e fondit limit.

16.Titulli i gjetjes: Përlllogaritja në mënyrë të gabuar e fondit limit

Situata: Gjatë auditimit të procedurës me objekt: “Trajnim për 30 kontrolloret e rinj Bazik, TWR VIA dhe ACC AREA” viti 2023, u konstatua që kohëzgjatja/plani është jo më pak se 22 (njëzet e dy) javë (Basic – Rating - ELPAC Basic jo më pak se 13 javë, Rating jo më pak se 8 javë, ELPAC 1javë). Periudha e përshtatshme për fillimin e kursit do të jetë 6-mujori i parë i vitit 2023 në marrëveshje midis palëve si dhe nr. i Pjesëmarrësve është 30 kandidatë për kualifikime, që do të thotë investimi për një kandidatë është në vlerën 6,660,000 lekë. Në lidhje me dokumentacionin e dërguar nga B.OE fitues, në lidhje me përmbushjen e kriterit për punë të ngjashme jo më të vogël se 40% të fondit limit, dokumentacioni i sjellë nga OE A T D A. T. D. SHPK, është një faturë e lëshuar me datë 02.06.2023, pa një kontratë të bashkëlidhur, disa ditë përpara dorëzimit të dokumenteve me vlerë 63,000,000 lekë pa tvsh, me objekt:

“Trajnim DSE;AED;LOTO;ATEX/EX;COSHH;PMI/PPE;RPE;FTT;BBS; IOSH 6 MUAJ PER STAFIN”. Vlera e faturës prej 63,000,000 lekë pa tvsh nuk e përmbush kriterin e vendosur, pasi vlera është sa 30% e fondit limit. Gjithashtu për përlllogaritjen e fondit limit është bërë studimi i tregut duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si më poshtë:

“N.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 213.000.000 lekë pa TVSH.

“A. T. D.” shpk paraqiti ofertën e tij me vlerë 208.500.000 lekë pa TVSH.

“I.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 203.500.000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me studimin e tregut u konstatua në lidhje me ofertat e marra në treg, një nga tre OE që është marrë oferta nuk e kanë për objekt fushën e trajnimit të personelit, duke e mos kryer një analizë të saktë mbi përcaktimin e fondit limit.

Kriteri: Neni 76 shkronja b dhe Neni 75 i VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik" ,neni 2 i ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 dhe Nenin 2 shkronja b të ligjit nr. 162 , datë 23.12.2020

Ndikimi/Efekti: Përlllogaritje të gabuar të fondit limit dhe kualifikim i padrejtë i OE

Shkaku: Marrja e ofertave në treg nga operatore ekonomik që nuk kanë për objekt fushën e procedurës së prokuruar.

Rëndësia: E lartë

16.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës gjatë përlllogaritjes së fondit limit në të ardhmen, në lidhje me procedurat e prokurimit që kanë të bëjnë me trajnimet për punonjësit e Albcontrol SHA, në rastin kur përdoret studimi i tregut për përcaktimin e fondit limit, të përzgjidhen OE të cilët e kanë për objekt fushën e trajnimit të personelit sipas objektit të caktuar nga Albcontrol SHA si dhe gjatë vlerësimi të ofertave të kryejë analizë të plotë të dokumentacionit justifikues të sjellë nga O.E. pjesëmarrës.

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: Grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit i përbërë nga znj. H. P. kryetare , znj.V. I. anëtare dhe znj. T. F. në mospërputhje me Nenin 13 “Studimi paraprak i tregut”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. D. I., z. I. B. dhe z. E. Ll. për veprimet dhe mosveprimet jo në përputhje me Nenin 75 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Ritheksojmë se ALBCONTROL SHA, operon në një fushë që është shumë specifike dhe në funksion të objektit të veprimtarisë saj që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror ATS, CNS, AIS dhe MET, duhet të sigurojë trajnimin dhe kualifikimin e personelit përkatës për këto shërbime në përputhje me kërkesat rregullative. Në këtë kuadër, në bazë të Rregullores së Komisionit Evropian (EU) Nr.340/2015 transpozuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr.91 datë 21.02.2019, kërkohet që stafi i cili do të kryejë detyrat dhe funksionet e Kontrollorit të Trafikut Ajror, të ketë përfunduar me sukses Trajnimin Fillestar, Trajnimin e Rangut, Nivelin e Mjaftueshëm të Aftësisë Gjuhësore dhe Trajnimin në Vendin e Punës.....

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit,, qëndron me të njëjtin rekomandim.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

“Sigurimi i kullës së kontrollit mobile në Aeroportin e Kukesit me gjithë pajisjet e nevojshme”

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Sigurimi i kullës së kontrollit mobile në Aeroportin e Kukesit me gjithë pajisjet e nevojshme ” 2022		
Urdhër Prokurimi : Nr.545, datë 22.02.2022		
5. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Urdh.Nr.545 prot., datë 22.02.2022 Znj. S. P. Znj. K. V. Z. K. N.	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Z. I. B. Kryetare Z. A. K. Anëtare Z. E. X. Anëtare
4. Fondi limit (pa TVSH): 61.666.666 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Albcontrol SHA	6. Data e hapjes së tenderit: 28 .03.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: O.E “R.” sh.p.k J.....G b) Kualifikuar: OE “R.” sh.p.k J.....G	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdher Nr.545/1 datë 22.02.2022 Z. D. G. Kryetar Z. D. B. Anëtar Z. E. Ll. Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 61.666.000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë furnizimi nr.545/4 prot., datë 07.04.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 666 lekë	12. Ankimime ska
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : Z. I. B. Kryetare Z. A. K. Anëtare Z. E. X. Anëtare	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 12 muaj

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Kërkesës nr.434 prot., datë 10.02.2022, Drejtoria e Divizionit Teknik i është drejtuar sektorit të prokurimeve për të filluar procedura e prokurimit me objekt **“Sigurimi i kullës se kontrollit mobile ne Aeroportin e Kukësit me gjithë pajisjet e nevojshme”**

Me anë të Urdhrit të brendshëm nr.434 prot., datë 14.02.2022 është ngritur grupi i punës për përlogaritjen e specifikimeve teknike.

Me anë të urdhrin nr.434/3 prot., datë 16.02.2022 është ngritur grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit i përberë nga znj.H. P. Kryetare, znj.T. F., z. R. M. . Grupi i punës me anë të proces verablit nr.434/4 prot., datë 18.02.2022 ka vendosur fond limit **61.666.666** (gjashtëdhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashte mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashte lekë) pa TVSH.

Ky fond limit është përlogaritur duke marrë oferta ekonomike nga 3 O.E si mëposhtë:

“R.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 61.700.000 lekë pa TVSH.
“C. & M. A. ” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 63.800.000 lekë pa TVSH.
“D.” sh.p.k paraqiti ofertën e tij me vlerë 59.500.000 lekë pa TVSH.

Në datë 22.02.2022, me anë të Urdhri i Prokurimit nr.545 prot. me objekt **“Sigurimi i kullës se kontrollit mobile ne Aeroportin e Kukesit me gjithë pajisjet e nevojshme”** u caktuan anëtarët e NJP.

Në datë 22.02.2022 me anë të urdhrin nr. 545/1 prot., u ngrit KVO.

Në datën 04.03.2022, me iniciativën e Autoriteti Kontraktor, si dhe të ligjit nr.162/2020, AK vendosi të bëjë modifikimin e DST për procedurën e prokurimit nr.545 prot. me objekt **“Sigurimi i kullës se kontrollit mobile ne Aeroportin e Kukësit me gjithë pajisjet e nevojshme”**. Afati i ri për hapjen e ofertave ishte data 28.03.2022.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Urdhër nr.545/1 datë 22.02.2022, ka mbajtur procesverbalin në datën 28.03.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave.

Në këtë procedurë është paraqitur vetëm një operator si mëposhtë:

“R.” sh.p.k me NIPT **J.....G** Oferta ekonomike: **61.666.000** lekë pa TVSH.

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Urdhër nr.545/1 datë 22.02.2022 ka mbajtur procesverbalin në datë 29.03.2022 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatoreve ekonomik. Pasi përfundoi vlerësimi i ofertave të paraqitura dhe pasi të gjithë anëtarët e KVO përfunduan procesin e vlerësimit të ofertave, sistemi i prokurimit elektronik tregoi renditjen përfundimtare si mëposhtë:

Vendi i parë :Operatori Ekonomik **“R.” sh.p.k**

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 26.11.2022 Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Për sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar se për përlllogaritjen e fondit limit kanë marrë pjesë 3 kompani konkretisht:

1. “ R.” sh.p.k me oferte 61.700.000 lekë pa TVSH.

2. “C. & M. A. ” sh.p.k me oferte 63.800.000 lekë pa TVSH.

3. “D.” sh.p.k me oferte 59.500.000 lekë pa TVSH.

Nga këto kompani ka marrë pjesë në tender vetëm kompania “ **R.**” sh.p.k me ofertë më të ulët se oferta për përlllogaritjen e fondit limit.

Gjithashtu në datën 04.03.2022, me iniciativën e Autoriteti Kontraktor, janë bërë modifikime në DST për procedurën e prokurimit nr.545 prot. me objekt: “**Sigurimi i kullës se kontrollit mobile ne Aeroportin e Kukësit me gjithë pajisjet e nevojshme**”,

Konkretisht:

Në pikën 2.3.2. të kapacitetit teknik, bëhet ndryshimi si vijon:

Ishte:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqesë certifikatat qe vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO 27001-2013**, Sistemi i Menaxhimit e Sigurisë së informacionit ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO 20000-1:2011**, Sistemi për Menaxhimin e Shërbimeve ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalentë me to.

Behet:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqesë certifikatat qe vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO 27001-2013**, Sistemi i Menaxhimit e Sigurisë së informacionit ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO 20000-1:2018**, Sistemi për Menaxhimin e Shërbimeve ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalentë me to.

Në pikën 2.3.4. të kapacitetit teknik, bëhet ndryshimi si vijon:

Ishte:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te vërtetojë pronësinë ose të drejtën për përdorimin e pajisjes për ofrimin e këtij shërbimi.

Behet:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë pronësinë ose të drejtën për përdorimin e pajisjes (Kullë e kontrollit mobile) për ofrimin e këtij shërbimi. Dokumentet provuese për disponimin e kullës së kontrollit mobile janë fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontrate dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Në pikën 2.3.6. të kapacitetit teknik, bëhet ndryshimi si vijon:

Ishte:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka në dispozicion një Help Desk të dedikuar, të kontaktueshëm 24/7/365, e vërtetuar me anë të një vetëdeklarimi.

Behet:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka në dispozicion një Help Desk të dedikuar, të kontaktueshëm 24/7/365, e vërtetuar me anë të një vetëdeklarimi.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Në pikën 2.3.5. të kapacitetit teknik, bëhet ndryshimi si vijon:

Ishte:

2.3.5. Operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar jo me pak se 10 (dhjetë) punonjës (prej të cilëve të jenë inxhinierët e mëposhtëm) për 3 tre muajt e fundit, kjo e vërtetuar nga Administrata Tatimore dhe shoqëruar me listpagesat për periudhën e mësipërme:

- a) Të paktën 1 (një) inxhinier informatik
- b) Të paktën 1 (një) inxhinier elektronike;
- c) Të paktën 1 (një) inxhinier teknologji informacioni
- d) Të paktën 1 (një) inxhinier mekanik
- e) Të paktën 1 (një) inxhinier elektrik

Kërkesat e mësipërme duhen të vërtetohen me:

- Kontratë punë përkatëse
- Diplomat përkatëse
- Listëpagesat sipas formatit E-Sig 25, të konfirmuara nga Administrata Tatimore që vërtetojnë se punonjësi ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik 3 (tre) muajt e fundit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Behet:

2.3.5. Operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar jo me pak se 8 (tetë) punonjës (prej të cilëve të jenë inxhinierët e mëposhtëm) për 3 tre muajt e fundit, kjo e vërtetuar nga Administrata Tatimore dhe shoqëruar me listpagesat për periudhën e mësipërme:

- a) Të paktën 1 (një) inxhinier informatik
- b) Të paktën 1 (një) inxhinier elektronike;
- c) Të paktën 1 (një) inxhinier teknologji informacioni
- d) Të paktën 1 (një) inxhinier mekanik
- e) Të paktën 1 (një) inxhinier elektrik

Kërkesat e mësipërme duhen të vërtetohen me:

- Kontratë punë përkatëse
- Diplomat përkatëse
- Listëpagesat sipas formatit E-Sig 25, të konfirmuara nga Administrata Tatimore që vërtetojnë se punonjësi ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik 3 (tre) muajt e fundit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Ndryshimet e kritereve të cituara nga audituesit, janë bërë nga rekomandimi dhe asistencë që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) jep për autoritetet kontraktore, në mbështetje të nenit 23 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika ç), ku parashikohet se: “Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione:.....

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit, merr në konsideratë observacionin.

Për sa më sipër observacioni merret në konsideratë.

17. Titulli i gjetjes: Nuk është kryer një analizë kosto përfitim nga ana e Albcontrol SHA

Situata: Me shkresën nr.9996/1 datë 07.06.2021 Vendimit të asamblesë së aksionarit nr.38 datë 07.06.2021, Për miratimin e vendimit nr.3 datë 03.06.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Albcontrol” SH.A “Mbi shembjen e objektit kullë në aeroportin e Kukësit”, aksionari vendosi shembjen e objektit të vlerësuar në shumën 2,432,000 lekë, për ti hapur rrugë investimeve infrastrukturore në aeroportin e Kukësit. Kulla nuk ka qenë e pajisur me pajisje elektronike si dhe vlera e mësipërme prej 2,432,000 lekë, përfaqëson vetëm strukturën e kullës, pa elementët përbërë të funksionimit të saj (pajisjet elektronike).

Objektit kullë është përjashtuar nga zmadhimi i kapitalit. Si pasojë e këtij vendimi, në mungesë të objektit kullë e pa lëvizshme, për periudhën 2022-2023 janë zhvilluar dy procedura prokurimi (nga një për secilin vit), për marrjen me qira të një kulle të lëvizshme, me objekt “Sigurimi i kullës së kontrollit mobile në Aeroportin e Kukësit me gjithë pajisjet e nevojshme”, në vlerën totale **117,164,333** lekë pa TVSH. Grupi i auditimit konstatoi që para zhvillimi të dy procedurave të prokurimit nga ana e Autoriteti Kontraktual nuk është kryer një analizë kosto përfitim për të vendosur në lidhje me ndërtimin apo dhe me përdorimin e praktikave të ndryshme të marrjes me qera financiare që të paktën në fund produkti të mbetet aset i institucionit. Gjithashtu nuk është marrë në konsideratë që dhe numri i fluturimeve dhe të ardhurave në aeroportin e Kukësit është i ulët ku të ardhurat e gjeneruara nuk mbulojnë shpenzimet e qerasë së objektit.

Kriteri: Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

Ndikimi/Efekti: Kosto shtesë për shoqërinë në lidhje me marrjen me qera të një shërbimi i cili është i domosdoshëm dhe i përhershëm për aeroportin

Shkaku: Mos analizimi i të gjithë faktorëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit

Rëndësia: E lartë

17.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë dhe të zgjidhë situatën në lidhje me sigurimin e kullës së kontrollit duke kryer një analizë të plotë bazuar në efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet mbi mënyrën e përfitimit të këtij shërbimi.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Albcontrol SHA, protokolluar në institucion me nr. 1045/6, datë 19.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Në zbatim të kontratës koncesionare të nënshkruar në datën 20.03.2019 midis MIE dhe “Kukës International Airport” SHPK (KFZ), ALBCONTROL detyruar nga vendimi i qeverisë shqiptare, filloi përgatitjet për sigurimin e shërbimit të trafikut ajror në këtë aerodrom. Me qëllim realizimin e objektivit për dhënien e “Shërbimit të Informacionit të Fluturimit Aeronautik”, për të cilin tashmë ALBCONTROL zotëron certifikatën përkatëse nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AL-ATM/ANS-004), ishte e nevojshme të përgatitej infrastruktura e duhur në njerëz dhe procedura fluturimi por edhe ajo teknike, për të bërë të mundur këtë shërbim. Me përfundimin e punimeve nga koncesionari për përshtatjen e aerodromit ekzistues për shërbimin që kërkohej sipas

kontratës koncesionare, rezultoi se kulla ekzistuese në këtë aerodrom ishte një pengesë për operimet në aerodrom, pasi penetronte në sipërfaqet e zonave të kufizuara të pengesave në aerodrome, (referuar shkresës së KFZ nr. 192, datë 11.05.2021 të protokolluar në institucionin tonë me nr. prot 696, datë 20.05.2021 e cila përfshinte edhe studimin përkatës).

Sipas raportit, bazuar në kërkesat e Aneksit 14 të ICAO-s, Vëllimi I, Kapitulli 4, në Urdhrin e Ministrit të MPPT Nr.130 Datë 09.11.2012 “Për Miratimin e Rregullores për Certifikimin dhe Regjistrimin e Aerodromeve Civile në Republikën e Shqipërisë si dhe Detyrimet dhe Përgjegjësitë e Operatorëve të Aerodromeve”, një pjesë e këtyre pengesave që penetrojnë Sipërfaqet e Kufizuara të Pengesave të Aerodromit (Obstacle Limitation Surface), A1-7 KAPITULLI 7-FRENIMI DHE KUFIZIMI I PENGESAVE, duhet të hiqeshin për të lejuar operimin e sigurtë të avionëve gjatë uljes apo ngritjes nga ky aeroport. Në listën e këtyre pengesave përfshihej edhe godina e kullës së kontrollit, që ndodhej në një largësi të afërt nga aksi i lëvizjes së avionëve në rrugën lidhëse (Taxiway Bravo). Sa më sipër prishja e kësaj kulle ishte detyrim pasi pengonte hapjen e këtij aerodromi (bazuar në relacionin nr. 751, datë 01.06.2021) dhe cënonte operimin e sigurtë në aerodrom. Në figurën më poshtë janë paraqitur pengesat aeronautike të Aeroportit të Kukësit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit dhe pas zhvillimit të takimit të mirëkuptimit, qëndron me të njëjtin rekomandim.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

▪ **Pika 7: Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit, i Menaxhimit të riskut, i Aktivitetit të Kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi**

Në zbatim të Pikës 8 të Programit të Auditimit nr.1045/1 Prot. datë 29.12.2023, i ndryshuar, “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit, i Menaxhimit të riskut, i Aktivitetit të Kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi”, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Albcontrol SHA.

Baza ligjore ku mbështetet auditimi mbi MFK është:

- ✓ Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar
- ✓ “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016;
- ✓ Ligji nr. 114/2015 “për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- ✓ Manualin “Mbi auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- ✓ VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- ✓ Ligji 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- ✓ Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”;
- ✓ VKM nr. 117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;
- ✓ Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;
- ✓ Udhëzimit nr.21, date 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Baza rregullatorë mbi të cilën ushtron funksionet e saj “*Albcontrol SHA*” Tiranë: Rregullorja e Brendshme e miratuar, Manuali i Proceseve të Punës/Harta e proceseve, Kodi i Etikës, Manuali i Parandalimit të Konfliktit të Interesit etj
- Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitin objekt auditimi; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a janë reflektuar edhe në rregullore;
- Shkresat e miratuara nga NA dhe ato të NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Manualin e MFK;
- Shkresat për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik [GMS] dhe ekipeve të menaxhimit të programeve [EMP];
- Plani vjetor i trajnimeve të stafit si dhe realizimi i tyre për vitet 2021, 2022 dhe 2023
- Regjistrin e riskut, Gjurmët e Auditimit;
- Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe Deklarata e cilësisë dhe Pyetëtori i vetëvlerësimit;
- Plotësimi i pyetësorëve të KLSH për “*Albcontrol SHA*” Tiranë, dërguar me emalin e datës 12/03/2024.

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit nga “*Albcontrol SHA*”, në përgjigje të kërkesave të përshkruara më lart lidhur me MFK-në, grupi i auditimit rezultoi me këto konstatime:

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në “*Albcontrol sh.a*”, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i kontrollit*”, “*Menaxhimi i riskut*”, “*Aktivitetet e kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “*Për disa shtesa dhe ndryshime*”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Mjedisi i kontrollit

Në lidhje me parimin 1 “*A ka hartuar dhe miratuar Deklaratën e Misionit dhe Strategjisë shoqëria Albcontrol SHA*”

- Albcontrol sh.a, ka shprehur misionin e shoqërisë në statutin e shoqërisë neni 3 dhe në rregulloren e brendshme të shoqërisë të miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.8 datë 20.10.2023.

Në lidhje me strategjitë e shoqërisë Albcontrol sh.a, shoqëria ka miratuar Plan Biznesin Strategjik për periudhën 2018-2023 miratuar me nr.721 prot., datë 19.03.2019.

Albcontrol sh.a, ka një plan aktivitetesh , të cilin e miraton çdo fillim viti, i cili përmban plan-veprimet vjetore operationale dhe teknike.

Të gjithë menaxherët/drejtuesit/punonjësit e njësisë informohen nëpërmjet postës elektronike zyrtare dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit si dhe folderin e përbashkët, ku mund të informohen punonjësit e një sektori rreth misionit/objektivave, strategjive dhe planit të veprimit.

Në lidhje me parimin 2 “Etika personale dhe profesionale”

Albcontrol sh.a, për “Etikën personale dhe profesionale” operon me Rregulloren e Brendshme miratuar me Vendimin nr. 8 datë 20.10.2023 të Këshillit Mbikëqyrës dhe Kodi i Sjelljes dhe Etikës te ALBCONTROL SHA miratuar me Vendimin nr. 4 datë 30.06.2015 të Këshillit Mbikëqyrës (Kreu 2, Neni 6). Rregullorja e parandalimit të interesave në ushtrimin e detyrës funksionale UB 593 dt.16.09.2014.

Procedura që shoqëria Albcontrol ndjek në rastin e shkeljes së rregullave të Kodit të Sjelljes dhe të Etikës nga punonjësit është e sqaruar edhe në Manualin e Burimeve Njerëzore miratuar me nr.635prot., datë 06.03.2019 (Kreu 5.8).

Në lidhje me parimin 3 “Struktura organizative duhet te jete ne funksion te objektivave te njesisë”

Albcontrol ka një organigramë e cila ka hyrë në fuqi në datën 10.07.2023, sipas UB 1336 datë 16.06.2023.

Struktura e shoqërisë është në funksion të ndarjes së përgjegjësive dhe nevojave të punës (specifikuar këto dhe në rregulloren e brendshme të shoqërisë të miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 8 datë 20.10.2023).

Sipas organigramës së shoqërisë dhe rregullores së brendshme për përcaktimin e roleve dhe detyrave të çdo punonjësi, merret dhe informacioni i nevojshëm për vendimmarrje. Çdo punonjës duhet të kryejë detyrat e veta sipas rregullores së brendshme, proceseve të punës, përshkrimit individual të punës. Drejtuesit e drejtorive raportojnë te titullari lidhur me ecurinë e aktiviteve mbi baza mujore, vjetore apo siç kërkohet rast pas rasti.

Rregullorja e Brendshme është në përputhje me ndryshimet strukturore dhe çdo Drejtori/Sektor/Njësi ka të përshkruara qartë përgjegjësitë dhe detyrat të përcaktuara dhe nuk ka mbivendosje. Kjo Rregullore është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr.8 datë 20.10.2023. Çdo sektor/drejtori ka manualet/procedurat e veta të punës.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune por nuk janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale,

Në lidhje me parimin 5 “A ka rregulla të brendshme te miratuara, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre”.

Albcontrol sh.a ka urdhra të brendshëm për delegimin e detyrave nga titullari gjatë kryerjes së lejes së zakonshme, autorizimet e dhëna nga Titullari për Drejtorin e Divizionit Administrativ me nr.2578 prot., dhe nr.2577 prot., datë 24.11.2023.

Delegimi i detyrave në shoqërinë Albcontrol SHA realizohet nëpërmjet autorizimeve/urdrave të brendshëm.

Urdhrat/autorizimet përkatëse detyrat specifike që delegohen janë të dokumentuara sipas kërkesave të Ligjit 10296 për MFK (nenet 9/12/15).

Në lidhje me parimin 6 *“Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore”*

Vlerësimet e Përformancën të punonjësve të Albcontrol SHA ,bëhen 2 herë në vit, në të cilin punonjësit vlerësohen nga e gjithë linja e menaxherëve në lidhje me arritjen e objektivave si dhe respektimin e kodit të sjelljes dhe etikës. Përveç formularëve të vlerësimit që duhet të plotësohen janë edhe instruksionet për procesin e vlerësimit të stafit. Formularët ne folderin 2-4.4.2-0.1

Sipas Procedurës së Trajnimit, hartohet Plani vjetor i Trajnimit mbështetur në nevojat për trajnim të stafit, për personelin e certifikuar dhe administratën, të dala nga vlerësimi i përformancën, në përputhje me objektivat e përcaktuara për vendin e punës që mbulon çdo punonjës. Ky plan vjetor trajnimi miratohet nga titullari nr. Prot 787 date 04.04.2023 për miratimin e planit te trajnimit për 2023. Nevojat për trajnim identifikohen duke përdorur formën "Proposal for Training", nga Drejtuesit përkatës të divizioneve dhe drejtuesit e drejtorive në fund të çdo viti.

Menaxhimi i Riskut

Në lidhje me parimin 7 *“Caktimi i koordinatorit të riskut dhe strategjia e risqeve sipas Ligjit 10296 të MFK”*

Albcontrol sh.a ka caktuar koordinator risku Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik. Emërimi i koordinatorit të riskut është bërë në bazë të UB nr.2511 prot., datë 17.11.2023. Gjithashtu është miratuar edhe strategjia e risqeve sipas nenit 21 të Ligjit 10296 të MFK. Strategjia ndodhet e publikuar në intranetin e shoqërisë dokumenti “Risk Management procedure” në folderin 2-4.3.1-04 .

Në lidhje me parimin 8 *“Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”*

Frekuenca e raportimit të analizave të riskut është 2 herë në vit.

Albcontrol sh.a gjithashtu ka nxjerrë procedurën 2-4.3.1-04 “Procedure for Financial and Risk Analysis”. Kjo procedurë shërben për menaxhimin e riskut për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të përcaktuara gjatë planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe vjetor.

Në lidhje me parimin 9 *“Ndërgjegjësimi i punonjësve për përgjegjësitë e tyre në menaxhimin e riskut”*

Spektori Analiza Financiare dhe Risku në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me drejtuesit e drejtorive dhe sektorëve, duke marrë në konsideratë Procedurën e Analizës Financiare & Riskut, rishikon dhe përditëson Risqet për Divizionin Administrativ. Gjithashtu materialet mbi portofolin e riskut si dhe materiale të tjera lidhur riskun hidhen në intranetin e shoqërisë duke e bërë të aksesueshëm nga të gjithë (Folderi 2-4.3.1-01 Risk Management). Albcontrol ka krijuar dhe Drejtorinë e Safety & Quality e cila një ndër funksionet e saj ka dhe analizën dhe menaxhimin e riskut në aspektin teknik.

Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: *“Procedura të punës të shkruara për proceset kryesore operationale dhe financiare, përfshirë dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe të informacionit”*

Çdo drejtori/sector i Albcontrol sh.a i ka të renditura aktivitetet e tij në formën e hartës së proceseve të punës te cilët ndodhen te vendosur respektivisht ne folderin përkatës te drejtorisë/sectorit dhe

ky folder ndodhet në faqen e intranetit të shoqërisë dhe përshkrimet e Proceseve të Punës të miratuara nga Titullari, si dhe manualet përkatëse.

Detyrat janë të ndara për personelin, evidentuar në përshkrimet e punës dhe në rregulloren e shoqërisë dhe në procedurat e punës të çdo sektori/drejtorie.

Në lidhje me parimin 11: *“Veprime të përshtatshme kontrolli për sistemet e TI-së (teknologjisë së informacionit)”*

Siguria në sisteme bazohet në procedurat e IT brenda shoqërisë duke u bazuar në standardet ISO 27001 Information Security Management System, duke konsistuar në politika të ruajtjes së informacionit dhe dokumenteve, proceseve backup, sigurimin e infrastrukturës së netëork të Albcontrol sh.a me aplikacione të certifikuar.

Në lidhje me parimin 12: *“Zbatimin e sistemit të firmës së dyfishtë”.*

Sistemi i firmës së dyfishtë funksionin sipas përcaktimeve të ligjit përkatës për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Pasqyruar kjo dhe në UB nr. Prot 1516 date 18.07.2014 “Për miratimin dhe vënien në zbatim të proceduarave të Sektorit të Financë Kontabilitetit në Albcontrol sh.a”.

Të gjitha angazhimet financiare janë të miratuara nga NA dhe NZ (janë firmosur të gjitha urdhër xhirimet me dy firma njëkohësisht).

Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: *“Sistemi i TI-së në shoqërinë tuaj ofron informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të njësisë suaj në tërësi dhe të strukturave të veçanta të saj”.*

Drejtoria e IT nuk posedon një proces monitorimi apo ruajtje informacioni rreth progresit të objektivave tërësore të njësisë. Drejtoria e IT monitoron vetëm objektivat e strukturës së saj. Progresi matet në baze projektsh specifikë, me treguesit e realizimit të performancës ku shikohet dhe koha e zbatimit.

Në lidhje me parimin 14: *“Udhëzim/rregullore të shkruar mbi mënyrën e komunikimit brenda dhe jashtë institucionit”*

Albcontrol sh.a ka të përcaktuar në rregulloren e brendshme të shoqërisë mënyrën e komunikimit të brendshëm. Linja e komunikimit dhe çdo informacion u përcillet menaxherëve dhe punonjësve të tjerë nëpërmjet share folder i përbashkët – intranetit apo komunikimeve elektronike. Në intranet ndodhen procedurat e mirë përcaktuara për secilin sektor. Çdo punonjës e ka pjesë të përshkrimet të punës raportimin të eprori përkatës të problematikave/parregullsive të konstatuara lidhur me proceset e veta të punës.

Komunikimet me subjektet e jashtme bëhen nëpërmjet shkresave, emaileve.

Në lidhje me parimin 15: *“Sistem rezervë (back-up)”*

Albcontrol sh.a ka një sistem rezervë (back-up). Procedurat e brendshme e kompanisë: ref 3-4.4.2-01 BUA Back Up & Archive Policy. Është bërë investim për krijimin e një platforme të re Back-up.

Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: *“Raportet javore/mujore/tremujore në lidhje me aktivitetin e strukturave”.*

Albcontrol SHA në rregulloren e Brendshme të institucionit ka përcaktuar procedurat e raportimit. Raportimi për realizimin e objektivave kryhet nëpërmjet analizave të punës mujore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe raportet vjetore të veprimtarisë së institucionit. Në hartat e

proceseve të punës dhe përshkrimet e punës të punonjësve janë përcaktuar hapat që ndiqen për monitorimin e objektivave dhe afatet e raportimit.

Objektivat e miratuara në fillim të vitit monitorohen rregullisht (çdo muaj, çdo 3 muaj, vjetore) dhe përgatitet analiza e realizimit për periudhën e caktuar.

Për sa më sipër u konstatua:

- Në përgjithësi organizimi dhe funksionimi e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm) është i plotësuar dhe në koordinim me njëra tjetrën.
- Grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.
- Gjithashtu në organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK mungojnë të dhënat mbi menaxhimin e njësisë së auditimit të brendshëm, mbi funksionimin e tij.

▪ **Pika 8: Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm të Njesisë**

Në zbatim të pikës 8 “Mbi vlerësimin mbi Auditimin e Brendshëm të Njesisë” të Programit të Auditimit “*Mbi Auditimin e Përputhshmërisë në Albcontrol Sh.a*”, konsiderohet i nevojshëm përpilimi dhe dorëzimi i këtij Akt Konstatimi.

Spektori i Auditit të Brendshëm për subjektin Albcontrol SHA është në varësi të Këshillit Mbikëqyrës dhe ka në përbërje ,Shefin e Sektorit të Auditit të Brendshëm dhe në varësinë e tij një Specialist. Organizimi i sektorit të auditit të brendshëm është përcaktuar në organigramën dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

Njësia e auditimit të brendshëm për periudhën e auditimit 2021-2023 ka qenë e përbërë nga këta punonjës:

E.P: Periudha e punësimit si Shef, Sektori i Auditit të Brendshëm 01.03.2018-30.09.2022

F. D. Periudha e punësimit si Specialist, Sektori i Auditit të Brendshëm- 05.07.2013-31.10.2021

E.B: Periudha e punësimit si Specialist, Sektori i Auditit të Brendshëm- 21.11.2022-01.11.2023

Nga auditimi u konstatua se:

Njësia e Auditimit të Brendshëm në organigramën e shoqërisë , rregulloren e brendshme dhe në kartën e auditit të shoqërisë Albcontrol SHA ka përcaktuar se NjAB funksionon vetëm me 2 punonjës.

Organigrama e shoqërisë për NjAB ka vendosur për numrin e punonjësve 1+1.

Rregullores e brendshme e Albcontrol SHA konkretisht neni 12 pika 1 citon;

Spektori i Auditit të Brendshëm është në varësi të Këshillit Mbikëqyrës dhe ka në përbërje Shefin e Sektorit të Auditit të Brendshëm dhe në varësinë e tij një Specialist.

Karta e auditit të shoqërisë Albcontrol SHA seksioni *Statusi Organizativ i Njesisë së Auditit të Brendshëm ;*

Njësia e Auditit të Brendshëm të Albcontrol SHA është pjesë e strukturës së Albcontrol SHA që varet direkt nga Këshilli Mbikëqyrës.

Organizimi i saj është në nivel sektori, struktura e të cilit ka në përbërje të tij një drejtues(shef sektori) dhe një specialist.

Të gjitha këto dokumente (Organigrama, Rregullorja e Brendshme dhe Karta e Auditit të shoqërisë Albcontrol SHA janë në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, konkretisht pika 3;

Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë edhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.

Për vitin 2021

NjAB ka bërë programet strategjike për periudhën e auditimit 2021-2023 dhe Kartën e Auditimit të cilat i ka dërguar për miratim pranë Këshillit Mbikëqyrës.

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.9 , datë 21/12/2020 ka miratuar programin strategjik të auditimit të shoqërisë “Albcontrol SHA” për periudhën 2021-2023.

Me vendimin nr.10, datë 14.07.2021 Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar Kartën e Auditimit të shoqërisë “Albcontrol” SHA

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka bërë planin strategjik të auditime për periudhën 2021-2023. të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Për vitin 2021 njësia e auditimit të brendshëm përbëhej nga znj. E. P. me detyrën e Shefit të Sektorit dhe znj. F. D., me detyrën e Specialistit (të pajisura me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik” nga Ministria e Financës). Në muajin Nëntor 2021 NjAB ka ngelur vetëm me një punonjës konkretisht vetëm me shefin, e sektorit të auditimit znj. E. P. pasi znj. F. D. ne 31 Tetor 2021 është larguar nga detyra si Specialist i sektorit të auditimit të brendshëm. NjAB ka planifikuar 5 auditime për vitin 2021.

Nga auditimi për vitin 2021 u konstatua se:

Njësia e Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 ka funksionuar më 2 punonjës deri në 31.10.2021 kur është larguar znj. F. D. me detyrë Specialist, në Sektorin e Auditit të Brendshëm. Nga 31 Tetor 2021 deri në fund të vitit NjAB ka funksionuar vetëm me znj. E.P e cila mbante detyrën e Shef, në Sektorin e Auditit të Brendshëm.

Nga plani vjetor i auditimit për vitin 2021 nuk është vendosur asnjë dokument që vërteton zbatimin e planit të auditimeve.

Në këto kushtet NjAB nuk ka patur kapacitet e duhura për të realizuar planin vjetor të auditimeve duke mos realizuar objektivin dhe misionin e Auditimit të Brendshëm konkretisht nenin 6 pika a të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”

Roli i auditimit të brendshëm është t’i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë:
a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar;

Për vitin 2022

Për vitin 2022 NjAB ka funksionuar vetëm me znj. E.P si Shef, Sektori i Auditit të Brendshëm deri në datë 30.09.2022 kur znj. E.P është larguar nga ky funksion. Në 21 Nëntor 2022 është punësuar z. E.B me detyrë si Specialist i sektorit të auditimit të brendshëm. Z. E. B. nuk ka qenë i pajisur me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik” të lëshuar nga Ministria e Financës.

Në vitin 2021 NjAB ka bërë planin strategjik 2022-2024 të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.15, datë 19.10.2021.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka bërë planin strategjik të auditime për periudhën 2022-2024. të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Nga 5 auditime të planifikuara NjAB ka kryer vetëm 2 auditime;

- Blerje me vlera të vogla në shoqërinë Albcontrol SHA, për periudhën ushtrimore 01.01.2021-31.10.2021.
- Marrëdhëniet e punës në shoqërinë Albcontrol SHA për periudhën ushtrimore 01.01.2021-31.12.2021

Nga auditimi për vitin 2022 u konstatua se:

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka pasur kapacitet e duhura njerëzore për të realizuar detyrat e ngarkuara dhe realizuar planin e auditimit për vitin 2022. NjAB ka funksionuar vetëm me znj. E.P si Shef, Sektori i Auditit të Brendshëm deri në datë 30.09.2022 kur znj. E.P është larguar nga ky funksion. Në 21 Nëntor 2022 është punësuar z. E.B me detyrë si Specialist i sektorit të auditimit të brendshëm. Z. E. B. nuk ka qenë i pajisur me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik” të lëshuar nga Ministria e Financës.

Për vitin 2023

Për vitin 2023 NjAB ka funksionuar vetëm me z. E.B me detyrë si Specialist i sektorit të auditimit të brendshëm deri në datën 1 Nëntor 2023. Nga data 1 Nëntor e në vazhdim NjAB nuk ka asnjë punonjës dhe nuk është funksionale.

Në vitin 2022 NjAB ka bërë përsëri planin strategjik 2023-2025 të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.19, datë 13.10.2022.

Ky plan për auditime është bërë nga specialisti i cili nuk ka certifikatë si auditues i brendshëm dhe eksperience pune.

Për vitin 2023 janë realizuar auditimet e mëposhtme:

- Prokurimet në Albcontrol SHA
- Programi ekonomik i shoqërisë Albcontrol sha., për periudhën ushtrimore 01.01.2022 deri në 31.12.2022.
- Administrimi material në shoqërinë Albcontrol sha., për vitin 2022.
- Detyrimet e prapambetura në shoqëri për vitin 2022.

Nga auditimi për vitin 2023 u konstatua se:

NjAB ka funksionuar vetëm me z. E.B me detyrë si Specialist i sektorit të auditimit të brendshëm deri në datën 1 Nëntor 2023. Nga data 1 Nëntor e në vazhdim NjAB nuk ka asnjë punonjës dhe nuk është funksionale.

Në vitin 2022 NjAB ka bërë përsëri planin strategjik 2023-2025 të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.19, datë 13.10.2022. Ky plan Strategjik nuk është bërë nga Shefi i Sektorit të NjAB por është bërë nga specialisti z. E.B i cili nuk është i pajisur me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik” të lëshuar nga Ministria e Financës. Ky veprim është në kundërshtim me Nenin 14 pika c e ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”

Neni 14

Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për:

c) hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike;

18. Titulli i gjetjes: Mos funksionimi i NjAB pranë subjektit Albcontrol SHA

Situata: Gjatë auditimit të NjAB grupi i auditimit ka konstatuar se: NjAB për vitin 2021 ka funksionuar më 2 punonjës deri në 31.10.2021. Nga 31 Tetor 2021 deri në fund të vitit NjAB ka funksionuar vetëm me një auditues.

Për vitin 2022 NjAB ka funksionuar vetëm me znj. E.P si Shef, Sektori i Auditit te Brendshëm deri në datë 30.09.2022 kur znj. E.P është larguar nga ky funksion. Në periudhën nga data 30.09.2022-21.11.2022 nuk ka pasur asnjë punonjës në strukturën e NjAB. Në 21 Nëntor 2022 është punësuar z. E.B me detyrë si Specialist i sektorit të auditimit të brendshëm. Z. E. B. nuk ka qenë i pajisur me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik” të lëshuar nga Ministria e Financës.

NjAB për vitin 2023 ka funksionuar vetëm me z. E.B me detyrë si Specialist i sektorit të auditimit të brendshëm deri në datën 1 Nëntor 2023. E njëjta situatë paraqitet dhe për përdhën nga data 1 Nëntor e në vazhdim ku në strukturën e NjAB nuk ka asnjë punonjës dhe nuk është funksionale.

Kriteri: VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, konkretisht pika 3;

Ndikimi/Efekti: Mos funksionimi i NjAB sjell pasojë mbi arritjen e objektivave të njësisë ku një ndër qëllimet kryesorë të NjAB është vlerësimi i riskut të institucionit dhe marrja e masave për parandalimin dhe minimizimin e tyre.

Shkaku: Vakancat e krijuara në strukturën e NjAB dhe specialistët përkatës të pa certifikuar.

Rëndësia: E lartë

18.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, Këshilli Drejtues të marrin masat e duhura për plotësimin e strukturës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm me 3 punonjës, duke respektuar kriteret e duhura lidhur me formimin e tyre profesional dhe përvojën e mëparshme në punë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lënë në auditimin e mëparshëm të kryer në Albcontrol SHA, konstatohet se KLSH në përfundim të auditimit ka dërguar në subjekt raportin përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes në të cilin janë dhënë 2 masa organizative të cilat janë pranuar por nuk janë zbatuar. Subjekti Albcontrol SHA nuk ka raportuar pranë KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, detyrë që duhet ta kryente brenda afatit 6 mujor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 11, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Bazuar në nenin 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si më poshtë:

1.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës sipas objektit të prokurimit për të hartuar një raport për domosdoshmërinë e çdo kriteri të veçantë të përcaktuar në këtë procedurë. Në varësi të rezultateve të raportit të hartuar nga specialistët e fushës, sipas përgjegjësive përkatëse të merren masa administrative përkatëse nga ana e shoqërisë;

2.1.Rekomandimi:Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për ushtrimin e kompetencave të tij për miratimin e propozimeve të ndryshimeve të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, vetëm pasi të jetë paraqitur nga shoqëria i gjithë dokumentacioni shpjegues për nevojën e këtyre ndryshimeve, duke marrë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe njohur relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm e duke shmangur vendimmarrjen e përshpejtuar. Titullari i Albcontrol SHA dhe Departamentet e shoqërisë të marrin masa të hartojnë dhe administrojnë propozimet për ndryshimet e mundshme të ardhmen të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, shoqëruar me relacione të hollësishme teknike dhe financiare.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë zbatuar si duhet procedurat për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, pasi në një rast, për z. B. K., rezultoi se është emëruar anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën nga data 25.11.2020 deri në datën 25.11.2024, pra me një mandat 4 vjeçar, nga 3 që parashikojnë dispozitat ligjore. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 155, pika 2 e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albcontrol, të respektojë afatin 3 vjeçar, si kohë të qëndrimit në detyrë për këta punonjës, si dhe këto ndryshime të paraqiten edhe në ekstraktin historik të Shoqërisë ne QKB.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: Gjatë vitit 2022, ashtu si edhe gjatë vitit 2021, shoqëria nuk ka arkëtuar asnjë të ardhur nga shërbimi en route dhe terminal charge si pasojë e një vendimi të gjykatës së shkallës së parë të Brukselit, për ngrirjen e llogarive të Albcontrol SHA pranë organizatës Eurocontrol. Për përballimin e situatës së krijuar mbi mos arkëtimin e të ardhurave, Albcontrol SHA ka lidhur 3 marrëveshje për hua financiare si më poshtë:

1-Vlera prej 5 milion Euro, nga Autoriteti Portual i Durrësit, nëpërmjet vendimit nr.5, datë 23.02.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 686 Prot., datë 03.03.2022.

2-Vlera prej 936,000,000 lekë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet vendimit nr.16 datë 17.08.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 2178 Prot., datë 24.08.2022.

3-Vlera prej 2,000,000,000 lekë, nga Autoriteti i Aviacionit Civil, nëpërmjet vendimit nr. 24, datë 22.12.2022 dhe me Kontratë Huaje nr. 3078 Prot., datë 27.12.2022.

4-Vlera prej 2,000,000,000 lekë, nga Korporata Shqiptare e Investimeve, nëpërmjet vendimit nr. 24, datë 21.11.2023 dhe me Kontratë Huaje nr. 2570 Prot., datë 24.11.2023.

5- Vlera prej 3,000,000,000 lekë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Kontratë Huaje nr. 2857 Prot., datë 27.12.2023.

Në kontratat e mësipërme janë përcaktuar dhe detyrimet e huamarrësit dhe huadhënësve si dhe normat përkatëse të interesit të huave.

Grupi i auditimit konstatoi që vendimi i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës i kalon kompetencat që ka ky këshill, për shkak se shoqëria aksionare përcakton tarifën e saj ose të ardhurat në bazë të kostos së institucionit. Në këtë rast që llogaria vijon të mbetet e bllokuar ose në rastin më të keq që llogaria në fjalë të mos arkëtohet, do të ishte e pamundur shlyerja e huave dhe regjistrimi i veprimeve kontabël duke e sjellë që shoqëria të vijojë operimin me humbje dhe drejt falimentimit të saj. Sa më sipër është në mospërputhje me “Parimet për përcaktimin e kostos bazë për tarifën e

mbikalimeve dhe llogaritjen e tarifave për njësi” dhe Ligji Nr.96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”

(Më hollësisht trajtuar në faqen 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës, duke u nisur nga natyra dhe lloji i institucionit që përfaqësojnë, institucion i cili nuk është fitimprurës, ku të ardhurat që përfiton ky institucion përcaktohen në bazë të kostove vjetore (TR=TC), të ndërpresë praktikën e marrjes së huave e cila shoqërohet me kosto shtesë (interesi), të cilat Albcontrol nuk ka mundësi ti shlyej nga buxheti i vet. Shoqëria, burimin e financimit ta kërkojnë nëpërmjet aksionarit duke qenë se dhe bllokimi i llogarive ka ndodhur për llogari të Shtetit Shqiptar.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: Më datë 09.06.2023 drejtori i përgjithshëm znj. L. O., me anë të relacionit nr. 1261 i është drejtuar Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA, me përmbajtje si më poshtë:

Propozim për shkallatoren e re të pagave në Albcontrol sha

Rikthimi i pagave në nivelin e para pandemisë, marrja në konsideratë e inflacionit të lartë gjatë kësaj periudhe, si dhe rishikimi i tyre duke i aktualizuar ato me iniciativat e qeverisë për rritjen e pagave aktuale në tërësi. Rritja me 30% e pagave bazë sipas shkallatores në fuqi është e domosdoshme për të motivuar të gjithë punonjësit sidomos në kushtet e trafikut të rritur në vazhdimësi përgjatë periudhës 2022-2023 dhe parashikimeve në vijim, për të evituar largime të tjera të stafit të kualifikuar dhe certifikuar si edhe për të tërhequr specialistë me ekspertizën më të mirë në treg.

Nisur nga pozicioni jo i mirë financiar i shoqërisë Albcontrol SHA, ku llogaritë e të ardhurave të shoqërisë vijnë të mbeten të bllokuara si dhe janë nënshkruar 5 kontrata huamarrje nga subjektet e tjera, kërkesa për rritje të pagave në nivelin 30% duket e pa arsyetuar, duke marrë në konsideratë edhe nivelin e pagave në rang vendi dhe të pagës mesatare. Sa më sipër në mospërputhje me Neni 8 Ligji Nr.10 296, Datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, Këshilli Drejtues, në lidhje me vendimmarrjen e tyre për arritjen e objektivave të institucionit, të marrë në konsideratë pozicionin jo të mirë financiarë të shoqërisë. Gjithashtu kjo nismë, në përmbushje të arsyes mbi evitimin e largimeve të stafit të kualifikuar dhe të tërheqjes së specialistëve me ekspertizë, të merret për pozicione të caktuara ku nevojitet stafi i kualifikuar dhe i certifikuar.

Në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi Nga realizimi i treguesve kryesorë për vitin 2021 konstatohet se për këtë vit shoqëria nuk ka realizuar asnjë nga treguesit kryesorë, si të ardhurat ashtu dhe shpenzimet. Të ardhurat janë realizuar në masën 92%, shpenzimet në masën 71% dhe investimet në masën 21%.

Nga realizimi i treguesve kryesorë për vitin 2022 konstatohet se për vitin 2022 nga treguesit kryesorë, shoqëria ka realizuar vetëm të ardhurat ndërsa treguesit e tjerë mbeten të pa realizuar. Të ardhurat janë realizuar në masën 112%, shpenzimet në masën 65% dhe investimet në masën 6%.

Nga realizimi i treguesve kryesorë për vitin 2023 konstatohet se për këtë vit nga treguesit kryesorë, shoqëria ka realizuar zërin e të ardhurave në masën 106% dhe numrin e punonjësve në masën 109%, ndërsa treguesit e tjerë mbeten të pa realizuar. Kështu shpenzimet janë realizuar në masën 65% dhe investimet në masën 19%. Realizimi i investimeve për të tre vitet me vlera të ulëta, është një tregues negativ në realizimin e atyre objektivave të cilat lidhen me investimet e pa realizuara, si dhe tregues që evidenton mangësi në planifikim dhe realizim të buxhetit për shpenzimet.

Sa më sipër në mospërputhje Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Titullari i shoqërisë të marrë masa që gjatë procesit të hartimit të programit ekonomik, të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme, të kryejë një planifikim të saktë dhe të detajuar, duke u bazuar dhe në realizimin e zërave të buxhetit në vitet paraardhëse dhe në planifikimet e marra nga Eurocontrol.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Gjatë viteve 2021-2023, shoqëria ka marrë hua nga Autoriteti Portual Durrës, DPSHTRR, Autoriteti i Aviacionit Civil, Korporata e Investimeve Shqiptare SHA dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për arsye të mungesës së likuiditetit si pasojë e bllokimit të fondeve nga një Urdhër Ekzekutimi i Gjykatës Belge.

Albcontrol sh.a nuk ka përfshirë në Programin e Zhvillimit Ekonomik 2021-2023 asnjë zë për këto hua, por ka bërë ndryshime në zërat përkatës gjatë vitit sipas relacioneve nga Drejtori i Përgjithshëm, në mospërputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Titullari i shoqërisë të marrë masa që gjatë procesit të hartimit të programit ekonomik, të të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme, të analizojë me kujdes situatën e institucionit, duke marrë në konsideratë bllokimin e llogarive të të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi:

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme që vijnë prej aktiveve dhe detyrimeve financiare:

- Risku i kreditimit
- Risku i tregut
- Risku i likuiditetit

Funksioni i menaxhimit të riskut brenda shoqërisë kryhet duke marrë në konsideratë risqet financiare (të kredisë, tregut, monedhës, likuiditetit dhe normës së interesit), risqet operacionale dhe risqet ligjore. Shoqëria operon në kushtet e një bashkëpunimi global dhe situatë ekonomike me zhvillime dinamike. Pështjellimi i mëtejshëm i saj mund të ketë impakt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë. Drejtimi kryen monitorime të rregullta mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe zhvillimeve të tregjeve ndërkombëtare. Bazuar në këtë, drejtimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe kërkon të implementojë masat e duhura në lidhje me riskun e kreditimit, riskun e tregut (kryesisht të normës së interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke limituar kështu efektet e mundshme negative. Për më tepër, Albcontrol SHA është financiar nga nën-huazime nga Qeveria ose palët e lidhura (si DPSHTRR, AAC, APD dhe KISH). Në këtë mënyrë, Albcontrol SHA i përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut duke ruajtur pozicione të qëndrueshme kapitali. Sa më sipër në mospërputhje me Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligj Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin Dhe Pasqyrat Financiare”

(Më hollësisht trajtuar në faqen 41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, gjatë menaxhimit të tij të ketë në konsideratë që objektivi kryesor i funksionit të menaxhimit të riskut financiar është të vendosë limite risku, dhe më tej të sigurohet se ekspozimi ndaj risqeve mbahet brenda këtyre limiteve. Funksionet e riskut operacional dhe ligjor janë parashikuar të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar risqet operationale dhe ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e programit ArcGIS” zhvilluar në vitin 2022 me vlerë të fondit limit 6,183,333 lekë, në përbushje të kriterëve të veçanta, pikës 4 të dokumenteve standarde të Tenderit “*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me autorizim prodhuesi Esri i programit ArcGIS. Autorizimi duhet të jetë i lëshuar nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar, apo të tjerë lejuar/certifikuar/autorizuar nga prodhuesi në Republikën e Shqipërisë. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, gjithashtu AK ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit të Prodhuesit apo të lejeve të prodhuesit.*”, OE fitues i procedurës së prokurimit “A. B. P.s” shpk. ka sjellë deklaratë që OE G. SHPK i cili i vetëshpallur si distributor zyrtar i ESRI, autorizon OE A. B. P.” sh.p.k si përfaqësues të ESRI për procedurën e prokurimit. OE G. SHPK nuk ka bashkëlidhur asnjë deklaratë të ESRI ku e deklaroi si distributor zyrtar i tij për Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu në faqen zyrtare të ESRI, ky operator nuk gjendet si distributor zyrtar për Republikën e Shqipërisë. Për sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk duhej të kishte kualifikuar OE A. B. P.” sh.p.k për procedurën e prokurimit në kushtet e mos plotësimit të kriterëve nga ana e OE.

Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt: “*Rishikimi i procedurave instrumentale afrimit e uljes me VOR e ILS, aeroportit të Tiranës, përfshirë rrugët standarde afrimit (STAR) e ngritjes (SID)*” B.OE fitues “R. F. & A. E.” shpk dhe OE “E.” S.P.A në dokumentacionin e sjellë, ka dorëzuar një kontratë për përcaktimin e punëve/shërbimeve që secili OE do të kryej për kontratën me objekt “Rishikimi i procedurave instrumentale afrimit e uljes me VOR e ILS, aeroportit të Tiranës, përfshirë rrugët standarde afrimit (STAR) e ngritjes (SID)”. Sipas kësaj marrëveshje OE “R. F. & A. E.” shpk do angazhohet vetëm për Menaxhimin e Projektit. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga B.OE fitues rezultoi se OE “R. F. & A. E.” shpk që ishte i angazhuar vetëm për rolin e menaxherit të projektit nuk ka dorëzuar dokumentacion mbështetës që përmbush rolin e tij në këtë bashkëpunim, por ky dokumentet që përkon me certifikatën për “Menaxhim Projektit” është paraqitur nga OE E. S.P.A dhe jo nga OE R. F. & A. E.” shpk që është angazhuar për ta realizuar. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk duhej të kishte kualifikuar BOE “R. F. & A. E.” shpk dhe O.E. “E.” S.P.A për procedurën e prokurimit në kushtet e mos plotësimit të kriterëve nga ana e OE. Sa më sipër në mospërputhje me Neni 88, pika 3 VKM nr. 285 19.05.2019 Dokumentet Standarde të Tenderit për Procedurën e Hapur Punë Publike.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave, për garantimin e një procesi të drejtë dhe transparent për përzgjedhjen e OE të duhur, të marrë në shqyrtim dhe të kryej verifikimin e të gjithë dokumentacionit të dorëzuar nga OE pjesëmarrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Shpenzime mirëmbajtje sistem finance, prokurimi, buxheti dhe e-ticket” për vitin 2022, për përbushjen e qëllimit të procedurës së prokurimit, nevojitet dhe autorizimi nga ana e Oracle për OE pjesëmarrës

në garë, i cili nga analizimi i dokumentacionit të sjellë, rezulton që ka autorizim të vlefshëm deri më datë 15 Janar 2024, si dhe nga hulumtimet e grupit të auditimit në faqen zyrtare të Oracle, nuk rezulton që OE D. L. SHPK të ketë autorizim aktiv. Kjo situatë sjell që shërbimi të mbulohej pa një licenca aktive nga OE D. L. SHPK

Në lidhje me përcaktimin e fondit limit dhe ofertave të dhëna, mungojnë detaje thelbësore mbi përcaktimin e saktë të vlerës së shërbimit, si numri i licencave (userave), pasi dhe në faqe zyrtare të oracle, tarifat e shërbimit përcaktohen nga numri i kërkuar i licencave (userave) që do të përdorin shërbimin. Sa më sipër në mospërputhje Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe përlogaritjes së fondit limit, të përfshijnë detaje të cilat janë të rëndësishme dhe themelore për përcaktimin e drejtë të kostos dhe vlerës së procedurës së prokurimit. Gjithashtu titullari i institucionit të ngrejë një grup pune për verifikimin e afateve të licencave të OE fitues i cili mbulon këtë shërbim, dhe në rast të mos ekzistencës së tyre të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e situatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës me objekt: “Trajnimi për ATCO AFIS Kukës” për vitin 2022, u konstatua që kohëzgjatja/plani është jo më shumë se 9 javë (teori dhe SIM) si dhe nr. i Pjesëmarrësve është 5 kandidatë për kualifikime AFISO, që do të thotë investimi për një kandidatë është në vlerën 5,280,000 lekë për 9 javë.

